

Reforma dhe transformimi i mbrojtjes  
në  
Shqipëri, Maqedoni  
dhe Kroaci

Tobias Pietz  
me Marc Remillard

Përkthimi në shqip i këtij studimi u mundësua nga ndihma bujare e Qeverisë së Norvegjisë.

<b>LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE .....</b>	<b>4</b>
<b>FALËNDERIMET .....</b>	<b>7</b>
<b>PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>8</b>
<b>1. HYRJA .....</b>	<b>11</b>
<b>2. SHQIPËRIA .....</b>	<b>16</b>
REFORMA E MBROJTJES .....	16
TRANSFORMIMI I MBROJTJES .....	28
PËRFUNDIMET .....	39
<b>3. MAQEDONIA .....</b>	<b>43</b>
REFORMA E MBROJTJES .....	43
TRANSFORMIMI I MBROJTJES .....	58
PËRFUNDIMET .....	68
<b>4. KROACIA .....</b>	<b>72</b>
REFORMA E MBROJTJES .....	72
TRANSFORMIMI I MBROJTJES .....	79
PËRFUNDIMET .....	96
<b>6. LISTA E PERSONAVE TË INTERVISTUAR.....</b>	<b>104</b>
<b>7. SHTOJCA.....</b>	<b>110</b>
<b>8. REFERENCAT .....</b>	<b>135</b>

**Per autorin:**

**TOBIAS PIETZ**

**Kërkues, Qendra Ndërkombëtare për Shkëmbime e Bonit (BICC), Gjermani**

**Pegjegjes të DCAF:**

**MARC REMILLARD, Menaxher Programi për Çmobilizim dhe Ritrajnim**

**Redaktor:**

**ELVAN IZOKOZLU**

**Kopertina:**

**Fotot e NATO-s.**

**Ushtarë maqedonas duke patrulluar përgjatë kufirit me Kosovën.**

**KOKA**

**PERMBLEDHJA**

**HYRJA**

**SHQIPERIA**

**MAQEDONIA**

**KROACIA**

**PERFUNDIMET**

**PERSONA TË INTERVISTUAR**

**SHTOJCAT**

**REFERENCAT**

## Lista e akronimeve dhe shkurtesave

APJ	Armata Popullore e Jugosllavisë
BA&H	Booz, Allen dhe Hamilton
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
BE	Bashkimi Evropian
CARDS	Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
DEP	Drejtoria për Ekonomi dhe Privatizim
EAPC	Këshilli i Partneritetit Euroatlantik
ESDP	Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes
FAK	Forcat e Armatosura Kroate
FAM	Forcat e Armatosura të Maqedonisë
FASH	Forcat e Armatosura Shqiptare
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KDS	Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes
KMSHS	Këshilli për Mbikëqyrje të Shërbimeve të Sigurisë
KPSK	Komiteti i Përbashkët për Siguri Kombëtare
KPU	Kompanitë Private Ushtarake
LEPEZA	(spectra) Projekti Maqedonas për Risistemim
MAP	Plani i Veprimit për Anëtarësim
MAPE	Forca Policore Shumëkombëshe e Këshilldhënies
MPRI	Kompania Shërbimet Profesionale Ushtarake
MRP	Ministria e Rendit Publik
NACC	Këshilli i Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut
NAMRA	Shoqata Kombëtare për Forcat Rezervë të Ushtrisë
NO	Nënoficerët
PARP	Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit
PCC	Përkushtimi i Pragës për Aftësitë
PD	Partia Demokratike e Shqipërisë
PDSH	Partia Demokratike Shqiptare
PG	Qëllimet e Partneritetit
PPD	Partia për Prosperitet Demokratik

PS	Partia Socialiste e Shqipërisë
PSEJ	Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore
PVK	Programi Vjetor Kombëtar
PZHA	Plani i Zhvillimit Afatgjatë
QKD	Qendra Kombëtare për Demilitarizim
RASDP	Ndihma për Ri-integrim të Personelit të Ndarë të Mbrojtjes
RSM	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes
SAA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
SAIC	Bashkëpunimi Ndërkombëtar për Zbatime Shkencore
SAP	Procesi i Stabilizim Asocimit
SDSM	Bashkimi Social Demokrat i Maqedonisë
SHSHA	Shoqata Shqiptare e Atlantikut
SPECTRA	Programi për Përkujdesin dhe Tranzicionin e Personelit të Ndarë
TDF	Forcat Mbrojtëse Territoriale
TNPKJ	Tribunali Ndërkombëtar Penal për Krime të Kryera në ish-Jugosllavi
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedis
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare
WEU	Bashkimi i Evropës Perëndimore

**Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) është themeluar në tetor të vitit 2000 me iniciativën e qeverisë zvicerane.** Qendra nxit dhe përkrah institucionet qeveritare dhe joqeveritare në përpjekjet e tyre për të fuqizuar kontrollin demokratik dhe civil të forcave të armatosura dhe të sigurisë, dhe përkrah bashkëpunimin në këtë fushë, duke synuar në rend të parë rajonet euroatlantike. Për të zbatuar këto objektiva, qendra:

- Mbledh informata, bënë hulumtime dhe përfshihet në aktivitete grupore në mënyrë që të identifikohen problemet, të konstatoj mësimet e nxëna dhe të përkrah praktikat më të mira në fushën e kontrollit demokratik të forcave të armatosura dhe marrëdhënieve civile-ushtarake;
- Ofron ekspertizën dhe përkrahjen e saj për të gjitha palët e interesuara, në veçanti qeveritë, kuvendet, autoritetet ushtarake, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare, qarqet akademike.

Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF)  
Rue de Chantepoulet 11  
P. O. Box 1360  
CH-1211 Geneva 1, Switzerland  
Tel: +41 (0)22 741 77 00  
Fax: +41 (0)22 741 77 05

E-mail:  
URL: [www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)

[info@dcaf.ch](mailto:info@dcaf.ch)

## FALËNDERIMET

Autorët dëshirojnë të falënderojnë kolegët e tyre në Qendrën e Bonit mbi Konvertimin Ushtarak (BICC) për përkrahjen e dhënë, në veçanti Andreas Heinemann-Grüder për kontributin e tij thelbësor dhe të vazhdueshëm në këtë studim; Elvan Isikozlu për redaktimin gjuhësor dhe korrektim Michael Brzoska për dhënie të komenteve të dobishme; Svenja Bends dhe Kaska Moraht për përgatitje për shtyp dhe botim të këtij studimi.

Në organizatën tonë partnere—Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF)—autorët do të dëshironin të falënderonin Marc Remillard për komentet dhe bashkëpunimin e tij. Për më tepër, Frédérique Jaquemin nga Drejtoria Ekonomike e NATO-s ka qenë shumë përkrahës dhe na ka mundësuar takime me personelin e NATO-s të përfshirë në reformën ushtarake në Ballkanin Perëndimor. Një falënderim i veçantë shkon për Ekipin e ekspertëve të NATO-s për transformime në lëminë e mbrojtjes për sigurimin e një atmosfere bashkëpunuese në misionin tonë në Kroaci në pranverë të vitit 2005.

Shumë persona na kanë përkrahur dhe kanë dhënë informata në tri vendet e mbuluara në këtë studim. Në Kroaci, falënderimi kryesor shkon të Zvonko Popović dhe ekipin e tij SPECTRA, në veçanti për gatishmërinë dhe energjinë e tyre të përhershme për të ndihmuar, sikurse edhe Gregoire Goodstein dhe ekipin i tij nga projekti RASDP i IOM-it. Në Shqipëri, Arben Gjata ishte vendimtar në verifikimin e të dhënave dhe në ofrimin e shpjegimeve të veçanta në lidhje me çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë në vendin e tij. Në Maqedoni, Dane Taleski ishte një burim mjaft i rëndësishëm në çështjet politike dhe ushtarake.

Sidoqoftë, vetëm autori është përgjegjës për pikëpamjet e shprehura në këtë studim.

## PËRMBLEDHJE

Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia janë duke hyrë në një fazë të ristrukturimit të mbrojtjes, të cilën shumica e vendeve të Evropës Lindore e kanë tejkaluar. Një shkallë e kënaqshme e stabilitetit është arritur në Ballkanin Perëndimor pas luftërave dhe konflikteve të brendshme të viteve '90-ta, në të cilat procesi i reformave të çarmatosja potenciale ishte ndaluar. Kjo *analizë* e BICC-së trajton reformën ushtarake dhe procesin e transformimit të mbrojtjes në vendet e përmendura më lartë. Ndër çështjet e trajtuara janë miratimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike-doktrinale, si dhe modernizimi dhe zvogëlimi i forcave të armatosura, duke përfshirë masat ri-integruese për personelin e pushuar nga puna dhe përgatitjet për shitje dhe transformim të bazave ushtarake.

Qëllimi i tanishëm i reformës së mbrojtjes në Shqipëri, Maqedoni dhe Kroaci kryesisht ka të bëjë me krijimin ushtrive të vogla, moderne, efektive, zbarkuese, profesionale dhe interoperuese. Me miratimin e dokumenteve strategjike, kornizave ligjore, dhe me zvogëlimin e personelit që pothuajse është në një fazë të avancuar, janë arritur standarde të rëndësishme të mbrojtjes. *Analiza* tregon që reformat në rend të parë kryesisht kanë qenë të udhëhequra nga faktorë të jashtëm, si NATO, Kompanitë Private Ushtarake (KPU) të jashtme dhe përkrahja bilaterale nga SHBA-ja dhe vende të ndryshme të BE-së. Ndikimi i NATO-s ka luajtur një rol të veçantë formues, duke pasur parasysh që reformat janë çështje e prioriteteve të saja, të zbatuara përmes programeve dhe aktiviteteve të ndryshme. Të tri vendet i konsiderojnë këto reforma si test për aftësinë dhe vullnetin e tyre për të zbatuar rregullat dhe standardet e NATO-s, sikurse edhe hap për anëtarësim potencial në të ardhmen në BE.

Teorikisht, reforma në mbrojtje, ndër të tjera, do të duhej të ndihmoj përshtatjen e institucioneve kombëtare me standardet e NATO-s edhe në marrëdhëniet civile-ushtarake. Kjo *analizë* argumenton që roli i institucioneve kombëtare në udhëheqjen e reformave mbetet dytësor. Marrëdhëniet ndërmjet akterëve kryesorë të sigurisë, si kuvendi, kryetari, kryeministri, dhe ministri i mbrojtjes paraqesin kundërthënie ndërmjet ligjeve dhe praktikave të përditshme. Një numër i vogël i OJQ-ve janë të përfshira në çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, që në shumicën e rasteve nxiten me qëllimin stereotip të integritimit në NATO, por pa dhënë ndonjë kontribut civil



të duhur. Përveç kësaj, trashëgimia e së kaluarës komuniste vazhdon të ndikojë kulturën e fshehtësisë dhe të ndikojë marrëdhëniet civile-ushtarake në Shqipëri, Maqedoni dhe Kroaci.

Gjetjet e *analizës* tregojnë që procesi i reformës në Ballkanin Perëndimor është mjaft i vështirë. Kjo ndodh sepse një gjë e tillë nuk përfshinë vetëm përmirësimin e mbikëqyrjes civile dhe demokratike, modernizimin e forcave të armatosura dhe ministrive të mbrojtjes, por po ashtu edhe përshtatjen e forcave të armatosura në mjedisin e ri strategjik global, rajonal dhe lokal. Opinioni publik në Shqipëri, Maqedoni dhe Kroaci koma i lidhë reformat e mbrojtjes me mbyllje të bazave ushtarake, humbje të vendeve të punës dhe rënie të standardit për ish-personelin ushtarak. Përveç arritjeve në procesin e reformës së mbrojtjes, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë arritur shkallë të ndryshme të suksesit sa i përket ristrukturimit të forcave të tyre të armatosura, ri-integrimit të pensionuar dhe transformim të bazave ushtarake për qëllime civile. Ri-integrimi i ish-ushtarakëve në jetën civile mbetet një problem dytësor, pasi që nuk është pjesë përbërëse e reformës së mbrojtjes. Çështja nuk duket të jetë prioritet as për NATO-n e as për KPU-të, duke e lënë atë tek institucionet e dobëta kombëtare që veprojnë nën kufizime të mëdha financiare dhe me mundësi të kufizuara integruese të ekonomive dhe tregjeve të punës. Një përjashtim nga kjo është përfshirja e fortë, financiare dhe strukturore e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në procesin e ri-integrimit në Kroaci.

Sa i përket programeve konkrete që aktualisht janë duke u zbatuar për ri-integrimit të pensionuar, vetëm programi SPECTRA i Kroacisë mund të vlerësohet si i suksesshëm nga autorët, ndërsa të gjitha programet tjera ose kanë mangësi ose vetëm sa kanë hyrë në fazën e zbatimit me rezultate modeste. Mungesa e fondeve dhe ekspertizës profesionale për përgatitjen dhe zbatimin e programeve ri-integruese kanë shtyrë fillimin e programit LEPEZA në Maqedoni. Në të njëjtën kohë, paaftësia e Ministrisë së Mbrojtjes për të ofruar një program realist për ri-integrimit ka detyruar atë që të fokusohet në përmirësimin e përfitimit nga pensionet për ish-ushtarakët, pa marrë parasysh faktin që mundësitë financiare për të zbatuar ligjin e pensioneve për ish-oficerët janë pothuajse minimale.

Transformimi i objekteve ushtarake mbetet i paqartë në të tri vendet. Zyrtarët shtetëror shpesh e barazojnë termin me transferin, shitjen e pronës dhe pajisjeve ushtarake, apo me modernizimin dhe gjenerimin e të ardhurave, por jo domosdoshmërisht me përfitimet nga individët, komunitetet lokale apo rajonet. Kohë pas kohe modernizimi i bazave ushtarake për detyra të reja operationale

po ashtu referohet si transformim Përgjithësisht, ministritë e mbrojtjes janë institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin dhe kontrollimin e transformim të pronës ushtarake. Si rrjedhojë, shitja apo dhënia me qira përdoret si “model kryesor i transformimit” me qëllimin kryesor për të gjeneruar mjete financiare. Një qasje e tillë e gjenerimit të parave pjesërisht mund të shpjegojë mungesën e transparencës në proces dhe pse ministritë e mbrojtjes nuk mund të shihen si komisionar të paanshëm në këtë proces.

Për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të aktiviteteve të transformimit në të tri vendet, ky studim rekomandon:

- Rritje të transparencës në të gjitha aktivitetet transformuese të planifikuara dhe që janë duke u zhvilluar momentalisht, por veçanërisht në procesin e transferimit dhe shitjes së bazave ushtarake, objekteve dhe pasurive. Modeli i një agjencie të pavarur për transformim do të garantonte më shumë transparencë në ristrukturimin e procedurave burokratike.
- Shmangie e strukturave dhe përpjekjeve të dyfishta, por përdorim të sinergjive siç është integrimi i IOM-it në krijimin e programit të SPECTRA-s, që mund të përdoret edhe për aktivitete tjera në transformimin e mbrojtjes. Për më tepër, OJQ-të duhet të përfshihen në mënyrë që të bëhet procesi më pak i kushtueshëm, dhe, në rast të ri-trajnitimit apo ri-sistemimit, të ketë partnerë civil në ri-integrimin e ish-ushtarakëve në shoqëri dhe ekonomi.
- Zvogëlim të pritjeve të mëdha për përfitime nga transferimet dhe shitjet. Ato nuk kanë të ngjarë të materializohen. Në veçanti, çështjet mjedisore mund të dështojnë në shitjet e planifikuara. Një mundësi për të tërhequr fonde të reja në kohëra kur interesi i donatorëve për të investuar në reformën ushtarake është i ulët, është kërkesa për përkrahje financiare për pastrimin e bazave ushtarake të ndotura. Ndonëse kjo nuk paraqet fitim financiar në buxhetin e mbrojtjes, ajo paraqet një përfitim pozitiv tek komunitetet.
- Rritje dhe institucionalizim në shkëmbimin e përvojave në rajon në reformën e mbrojtjes dhe në projekte konkrete të transformimit. Struktura të reja si Njësia e transformimit të mbrojtjes në RACVIAC (Qendra Rajonale të Verifikimit e të Kontrollit të Armatimeve në Zagreb) mund të ofrojnë përkrahje të rëndësishme për këtë qëllim.
- Dhënie të mesazhit që asnjë përfitim social nuk vjen automatikisht si rezultat i karrierës ushtarake, përkundrazi çdo ushtarë ka një identitet civil dhe përgjegjësi personale ndaj shoqërisë.

## 1. HYRJA

Reforma e mbrojtjes, ri-strukturimi i forcave të armatosura, integrimi në NATO dhe transformimi i mbrojtjes janë çështje të përbashkëta për vendet e Ballkanit Perëndimor. Organizatat ndërkombëtare si Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (PS) dhe NATO, institutet kërkimore, OJQ-të, dhe kompanitë private janë duke u përpjekur të përgjigjen ndaj kërkesës në rritje nga qeveritë kombëtare për ndihmë financiare dhe ekspertizë për t'ia dalë mbanë me ndërlikimet dhe pasojat në reformat ushtarake dhe transformimit të mbrojtjes.<sup>1</sup> Ngjashëm me vendet tjera të tranzicionit post-socialist dhe transformimit, shtetet e Ballkanit Perëndimor janë futur në një fazë të cilën shumica e vendeve të Evropës Lindore e kanë kaluar me shkallë të ndryshme të suksesit. Një nivel i kënaqshëm i stabilitetit është krijuar në këtë rajon pas luftërave dhe konflikteve të brendshme të viteve '90, gjatë të cilave procesi i reformave dhe çarmatimi potencial ishte ndalur. Integrimi euroatlantik është duke u shndërruar në një të ardhme të dëshiruar për një numër në rritje të shteteve në rajon përderisa perceptimet e vjetra kërcënuese janë duke ndryshuar ngadalë. Duke gjykuar nga strategjitë mbrojtëse dhe punimet mbi sigurinë të botuara kohëve të fundit në rajon, reformat ushtarake dhe nevojat pasuese të transformimit janë duke fituar rëndësi në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ky punim merret me reformën ushtarake dhe me procesin e transformimit të mbrojtjes në përgjithësi. Në mes çështjeve të mbuluara janë miratimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike-doktrinale, si dhe modernizimi dhe zvogëlimi i forcave të armatosura.<sup>2</sup> Pjesë e zbatimit të këtyre qëllimeve është krijimi i një sistemi përkatës të planifikimit të mbrojtjes, një shpërndarje adekuate dhe e arsyeshme e burimeve, një sistem përkatës dhe efikas i sistemit të buxhetit, një proces i qartë, transparent dhe efikas i prokurimit, sisteme të menaxhimit njerëzor, programe sociale përkatëse që merren me anët negative të reformës, strategji të komunikimit publik, si dhe një sistem efikas të vendim-marrjes. Qëllimi përfundimtar i këtyre reformave ka të bëjë me krijimin ushtrive të vogla, moderne, efektive, të zbarkueshme, profesionale dhe interoperuese, për dallim nga forcat e rekrutuara.

Më në veçanti, ky studim analizon zhvillimet, të arriturat, mangësitë e reformës dhe transformimit të mbrojtjes në Shqipëri, Kroaci dhe Maqedoni. Studimi përpiket të dalloj faktorët kryesorë që ndikojnë reformën ushtarake dhe transformimin e mbrojtjes. Studimi bazohet në

informatat e mbledhura gjatë vizitave në terren nga autorët në të tri vendet në mars dhe prill 2005. Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia ishin përzgjedhur për të bërë një seri studimesh të bëra së bashku nga Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Qendra e Bonit mbi Konvertimin Ushtarak (BICC) duke mbuluar pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.<sup>3</sup>

Teksti i studimit në vazhdim ka pjesë për të tri vendet dhe një përmbledhje gjithëpërfshirëse me rekomandime. Pjesa e secilit vend fillon me një përshkrim të përgjithshëm të gjendjes së reformës ushtarake, statusin e integritit euroatlantik dhe shkallën e progresit në themelimin e marrëdhënieve funksionale civile-ushtarake. Nën-pjesët kryesore janë analiza të politikave, planeve dhe aktiviteteve në fushën e reformave ushtarake dhe në dy fushat më relevante të transformimit të mbrojtjes: ri-trajnimin dhe risistemimin e personelit të shkarkuar dhe transformimin e bazave ushtarake.

Kriteret e zgjedhura për të matur arritjet dhe mangësitë përqipen t'i përgjigjen pyetjeve në vijim: sa realist është procesi i planifikimit të reformës (realizmi)? Sa efikase është korniza institucionale e reformës (efikasiteti)? Sa janë të mjaftueshme burimet financiar dhe njerëzore (mjaftueshmëria e burimeve)? Çfarë është roli i përkrahjes së jashtme për reformat (përkrahja e jashtme)? Duke zbatuar këta indikator, autorët mëtojnë të ofrojnë kritikë në të arriturat dhe të metat e reformave ushtarake dhe transformimin e mbrojtjes, si dhe të bëjnë rekomandime në menaxhimin e procesit të reformave ushtarake. Kjo kritikë pastaj mund të përdoret për të formuluar mësimet e nxëna për të përmirësuar procesin kombëtar në të gjitha vendet e analizuar.

Duke diskutuar elemente të ndryshme të reformës së mbrojtjes në fokusohemi në prezantimin e katër aspekteve: së pari, planifikimi strategjik, p.sh. ato dokumente të nevojshme për të zhvilluar një orientim teorik në krejt procesin e reformës së mbrojtjes; së dyti, procesi zbatues; së treti karakteristikat e forcave të armatosura që duhen të arrihen me reformë; dhe, së katërti, parimet themelore për ekzekutimin e procesit. Kjo do të përfshijë strategjinë e sigurisë dhe të mbrojtjes, aspektet financiare të procesit sikurse edhe shqyrtimin strategjik të mbrojtjes.

Transformimi i mbrojtjes është parë nga akterët kombëtarë dhe ndërkombëtarë si pjesë përbërëse e procesit gjithëpërfshirës të reformës së mbrojtjes dhe sektorit të sigurisë në Ballkanin

Perëndimor<sup>4</sup>. Transformimi është përshkruar si transformim dhe ri-përdorim i llojeve të ndryshme të pasurive ushtarake për qëllime civile<sup>5</sup>. Prandaj, aktivitetet si ri-trajnimi dhe ri-sistemimi i personelit ushtarak të pensionuar, ri-zhvillimi, pastrimi i mjedisit të kontaminuar dhe rehabilitimi i bazave ushtarake, të gjitha këto bien në sferën e transformimit. Sidoqoftë, sa i përket transformimit të mbrojtjes në shtetet e Ballkanit Perëndimor – përkatësisht në Kroaci, Shqipëri dhe Maqedoni – akterët kombëtarë dhe ndërkombëtarë të përfshirë janë duke përdorur definicione dhe qasje të ndryshme për këtë koncept të transformimit, shpeshherë duke u udhëhequr nga agjenda që ndryshojnë lehtë ndërmjet vetës. Vetë koncepti i transformimit të mbrojtjes mbetet i paqartë, por shpesh kuptohet si zvogëlim, ri-dislokim dhe ri-integrim i personelit ushtarak, transformim i bazave dhe pronës ushtarake, sikundër edhe i industrive të mbrojtjes. Zyrtarët shtetëror shpesh e barazojnë termin me transferin apo shitjen e pronës dhe pajisjeve ushtarake; me modernizim apo gjenerim të të ardhurave; por jo domosdoshmërisht me përfitime për individët, komunitetet lokale dh rajonet. Nganjëherë modernizimi i bazave ushtarake për detyra të reja operationale po ashtu konsiderohet si transformim. Ministrinë e mbrojtjes të tri vendeve nën studim tregojnë pritje dhe vizione të ngjashme të transformimit të mbrojtjes të vendeve të tjera të Ballkanit siç janë Serbia dhe Mali i Zi<sup>6</sup>. Për këto vende, transformimi i mbrojtjes pritet të siguroj fonde për modernizimin e bazave ushtarake apo reformës së përgjithshme ushtarake.

Sidoqoftë, përvoja tregon që është jo realiste që transformimi i mbrojtjes të shihet si mjet për gjenerimin e fondeve të mëdha për reformën e mbrojtjes<sup>7</sup>. Kursimet nga zvogëlimi i forcave ushtarake janë mesatare dhe të hyrat e drejtpërdrejta nga shitja e pasurive përgjysmohet nga çmimi për pastrimin e ambientit. Si të tilla, përfitimet e transformimit për shoqërinë shpesh janë jo drejtpërsëdrejti të matshme në terma financiar, por më tepër të një natyre të përgjithshme: një mjedis më të pasur, infrastrukturë shtesë dhe e avancuar për komunitetet lokale, më shumë vendbanime, etj. Ngjashëm me mos-materializimin e “dividendave të paqes” siç ishte shpresuar, përfitimet nga transformimi i mbrojtjes në vendet e Ballkanit Perëndimor ka pak gjasa të plotësoj pritjet optimiste nëpër ministrinë e mbrojtjes në rajon<sup>8</sup>.

Reformat e mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor në rend të parë kanë qenë të udhëhequra nga përfshirja e NATO-s. Aktivitetet ndihmëse të NATO-s kanë luajtur një rol të padiskutueshëm në rajon dhe reformat janë ndër çështjet me prioritet të saj, të zbatuara përmes programeve të

ndryshme siç është Këshilli i Partneritetit Euroatlantik (EAPC), Partneriteti për Paqe (PP), Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP) dhe Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit (PARP). Këto programe janë konsideruar si “një mjet për të promovuar para se gjithash të njëjtin vizion të reformës së mbrojtjes, varësisht nga nevojat e secilit partner”<sup>9</sup>. NATO përmes Partneritetit për Paqe dhe MAP-it është ndër përkrahësit kryesorë të reformës së mbrojtjes në zonën euroatlantike<sup>10</sup>. Në veçanti, reforma e mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor paraqet një sfidë të madhe për të gjitha vendet e preokupuara dhe është një test për aftësitë dhe mundësitë për të miratuar dhe zbatuar rregullat dhe standardet e NATO-s. Sidoqoftë, është e kuptueshme që forcat e armatosura të Ballkanit Perëndimor janë psikologjikisht dhe gjuhësisht të papërgatitura të fillojnë bashkëpunimin me NATO-n.

Edhe pse nevojat e reformës janë perceptuar ndryshe në secilin vend, “anëtarët e NATO-s zakonisht u referohen “tri grupeve” të ideve për reformën e mbrojtjes”:<sup>11</sup>

- 1) Ristrukturimi i mbrojtjes dhe reforma e praktikave dhe institucioneve udhëheqëse;
- 2) Zhvillimi i aftësive mbrojtëse të kërkuara për të përballur si sfidat e reja ashtu edhe ato tradicionale që kanë të bëjnë me mbrojtjen; dhe
- 3) Veprimet që rrisin aftësinë e vendeve për të kontribuar në operacionet e krizave të udhëhequra nga NATO.

Vendet e përfshira në PP dhe aktivitete gjegjëse me vendet anëtare në Ballkanin Perëndimor kanë bashkëpunimin me forcat e NATO-s si objektiv të tyre parësor. Prandaj, transformimi i mbrojtjes është një funksion i qëllimit të përgjithshëm të modernizimit të mbrojtjes dhe strategjive ushtarake, strukturave dhe pajisjeve<sup>12</sup>. Interoperabiliteti në operacionet e mundshme të përbashkëta është objektiv i primar për NATO-n dhe ka gjasa të mbetet i tillë edhe në të ardhmen e afërt.

Çfarëdo që të jetë koncepti themelor i “transformimit”, procesi i reformës duhet të udhëhiqet nga parimet themelore. Çdo reformë duhet të shoqërohet nga përkrahje e fortë politike dhe duhet të jetë e planifikuar me kujdes dhe e përshtatshme gjatë rrjedhës së zbatimit. Reforma e mbrojtjes kërkon një kuptim të qartë të mjedisit të sigurisë, aftësisë për të parashikuar dhe shndërruar kërcënimet dhe sfidat në planet për forcë adekuate si pjesë e një vlerësimi strategjik të përgjithshëm, sikurse edhe aftësinë për të siguruar përkrahje qeverisëse dhe parlamentare për

resurse të mjaftueshme. Duke pasur parasysh rëndësinë e një qasjeje bashkërenduese ndër-institucionale, procesi i reformës duhet të përcaktohet si projekt kombëtar.

Procesi i reformës së mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor është i ndërlikuar. Ky proces përfshin përmirësimin e mbikëqyrjes civile dhe demokratike, modernizimin e forcave të armatosura dhe ministrive të mbrojtjes, përshtatjen e forcave të armatosura në mjedisin e ri global, rajonal, dhe lokal — për kujdesin që forcat e armatosura të jenë të afta të përballen me llojet e reja të kërcënimeve dhe konflikteve të sigurisë — dhe aftësinë për bashkëpunim ndërkombëtar për të zgjidhur krizat dhe t'ia dalin me kërcënimet terroriste<sup>13</sup>. Një gjë e tillë paraqet një ngarkesë jo vetëm për sektorin e mbrojtjes, por edhe për mjedisin dhe shoqërinë si tërësi.

## 2. Shqipëria<sup>14</sup>

### *Reforma e mbrojtjes*

Gjatë dekadave të fundit Shqipëria nuk ka përjetuar konflikt të hapur brenda-shtetëror apo ndryshim të kufijve, por më 1997 ajo ka përjetuar një periudhë të çrregullimit të rendit të brendshëm, që kërkoj një intervenim të shkurtër ushtarak të NATO-s (“Operacioni Alba”). Kjo ishte nxitur nga falimentimi i skemave investuese piramidale që ishin iniciuar në fillim të 1990-tave, dhe si rezultat shumë njerëz humbën kursimet jetësore të tyre. Kjo situatë shpiu në trazira të gjera publike në mars të vitit 1997, gjatë të cilave 1.300 depo ushtarake ishin plaçkitur. Gjatë kësaj trazire, është raportuar se mbi 550.000 armë të vogla dhe të lehta dhe rreth 900 milion rrrathë municioni ishin marrë nga depot ushtarake. Qeveria humbi kontrollin mbi shumicën e vendit dhe mjedisi u bë shumë i pasigurt.

Gjatë trazirave civile ushtria ishte po ashtu e shpërbërë. Sidoqoftë, procesi i ristrukturimit të mbrojtjes nuk ishte aq shumë i ndikuar nga mjedisi i sigurisë sa nga “...ndryshimi i shpeshtë i politikës së mbrojtjes, mungesa e ndonjë burimi realist të sistemit të menaxhimit dhe tendencat për të zhvilluar plane për strukturat e forcës që përpiqen të ruajnë vendet e punës të personelit ushtarak ekzistues”<sup>15</sup>. Dokumentet themelor strategjike, si Strategjia e sigurisë kombëtare dhe politika e mbrojtjes ishin miratuar në Shqipëri vetëm në shkurt të vitit 2000, Strategjia ushtarake në gusht të vitit 2002, ndërsa Libri i bardhë akoma është duke pritur që të miratohet nga parlamenti<sup>16</sup>. Krahasuar me planet e mëparshme, këto dokumente në një mënyrë më realiste përshkruajnë plane për zbatimin e procesit të reformave deri në vitin 2010,. Strategjia ushtarake vë tri qëllime kryesore për reformën e mbrojtjes, përkatësisht “...të zhvilloj një ushtri profesionale, reduktoj numrin e rekrutëve dhe rris buxhetin e mbrojtjes për 0,1% të BPK-së kombëtare deri me 2010<sup>17</sup>.

Që nga “Operacioni Alba”, ka pasur përkrahje ndërkombëtare për rritje të sigurisë dhe ka përkrahje të gjerë publike dhe politike për bashkëpunim të ngushtë me NATO-n. Rrjedhimisht, qeveria shqiptare ka mendimin që Forcat e Armatosura Shqiptare (FASH) duhet të jetë më e vogël në numër, profesionalizohet dhe modernizohet në mënyrë që të jetë në përputhje me ushtritë e tjera në NATO. Prandaj, pothuajse të gjitha ndryshimet brenda në FASH-it janë rezultat i qëllimit për anëtarësim në NATO, përfshirë edhe draftin e rishikuar të Strategjisë ushtarake



(2004) të emërtuar si “Strategjia e integritit në NATO”. Ky fakt ka nxjerr pak kritikë në Shqipëri që misioni i vërtetë i FASH-së është të arrij standardet ushtarake të NATO-s sa më shpejt që të jetë e mundur<sup>18</sup>. Sidoqoftë, Strategjia ushtarake e sheh si mision kryesor të FASH-it garantimin e gatishmërisë luftarake për mbrojtje, për të; vëzhguar dhe mbikëqyrur hapësirën detare , ajrore dhe tokësore të Shqipërisë; pjesëmarrjen në operacionet humanitare dhe të fatkeqësive natyrore, luftimin e terrorizmit, dhe pjesëmarrjen në operacionet paqësore<sup>19</sup>.

FASH-i i është nënshtruar transformimit që nga viti 1992. Struktura e forcave të armatosura shqiptare deri në vitin 2000 përfshinte 5 divizione/ 32 brigada pa inxhinierë, logjistikë apo struktura mbrojtëse. Qëllimi kryesor i ristrukturimit të FASH-it, që planifikohet të komplotohet në vitin 2010, është që të arrij forcë më të vogël, por më të aftë dhe me burime financiare përkatëse<sup>20</sup>. Në vitin 2000, qeveria shqiptare vendosi një plan me dy faza: së pari të transformoj FASH-in në një forcë më të vogël dhe me efektive gjatë vitit 2000-2004, pastaj të modernizoj atë gjatë 2005-2009. FASH-i duhej të zvogëlohej nga 43.000 në 31.000 trupa<sup>21</sup>. Në vitin 2002, Shqipëria nisi një strategji të reformës së mbrojtjes të financuar nga Departamenti i mbrojtjes së SHBA-së në mënyrë që t’a zvogëlojë në numër dhe t’a modernizoj FASH-in<sup>22</sup>. Strategjia ushtarake e vitit 2002 e ka përcaktuar madhësinë e FASH-së në 18.000 trupa<sup>23</sup>, 70% e të cilëve duhet të jenë ushtarë profesional dhe 30% rekrutë. Rekrutët që kanë mbaruar shërbimin ushtarak por kanë zgjedhur që të mbesin në FASH do të duhej të përbënin ushtrinë e ardhshme profesionale. Planet kanë paraparë një personel aktiv prej 14.500 forcash në kohë të paqes, me 2.000 civil shtesë. Ato po ashtu kanë autorizuar formacione rezervë prej 20.000 ushtarësh<sup>24</sup>.

Sidoqoftë, në mesin e vitit 2004, për shkak të rivlerësimit të kërcënimeve të sigurisë dhe burimeve të lejuara, Kuvendi i Shqipërisë autorizoj një zvogëlim të mëtutjeshëm nga 31.000 në 16.500 trupa deri në vitin 2010. Në fakt, Strategjia e rishikuar e vitit 2004 nuk e përmend me forcën rezervë, por thekson se: “Pjesa aktive e FASH-it do të përkrahet nga një Forcë rezervë e përshtatshme dhe e arsyeshme”<sup>25</sup>. Ky vendim ishte bazuar jo vetëm në realitetin fiskal dhe në analizë të misionit, por po ashtu edhe nga dëshira për të plotësuar kriteret e NATO-s për anëtarësim. Një ish zyrtar i lartë i mbrojtjes ka pretenduar që forca aktuale e FASH-it ishte e diskutueshme, duke vlerësuar ato të jenë rreth 12.000—13.000 në mars të vitit 2005<sup>26</sup>. Zyrtarët e NATO-s kanë zbuluar faktin interesant që FASH-i ka arritur numrin e 16.500 trupave në këtë vit, pothuajse 5 vite më herët sesa është planifikuar<sup>27</sup>.

Sipas Strategjisë ushtarake, FASH-i është ristrukturuar në 5 komanda: Forcat Tokësore, Forcat Ajrore, Forcat Detare, Doktrinë dhe stërvitje, dhe Komanda logjistike. Sipas Strategjisë Ushtarake të rishikuar, Forcat tokësore kryesisht janë të vendosura në Zall Herr, Vau i Dejes, Poshnje dhe Yzberisht. Ato përbëhen nga Brigada e Reagimit të Shpejtë, Brigada e Inxhinierisë, një Regjiment Komando dhe një Batalion për Komunikim. Pesë Brigada rezervë të Këmbësisë i nënshtrohen Komandës së Forcave Tokësore. Forcat e Armatosura janë kryesisht të vendosura në Tiranë (Rinas) dhe Farka, sikurse edhe në dy baza rezervë (Kuçovë, Gjadër). Ato përbëhen nga një Regjiment i Helikopterëve, Batalioni i Vëzhgimit Ajror dhe Shkolla e Trupës. Forcat Detare përbëhen nga dy Distrikte Detare (Durrës dhe Vlorë), një Batalion Logjistik (mirëmbajtje dhe riparim), një Kantier i Riparimit dhe elemente tjera përkatëse.

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) është kryesisht e koncentruar në Tiranë dhe Vlorë. KTD-ja përbëhet nga Akademia e Mbrojtjes, Universiteti Ushtarak “Skenderbej”, Akademia e Nënoficerëve, Brigada e Stërvitjes Bazë, Batalioni i Mbështetjes Logjistike dhe Qendra Ushtarake për Studime Shkencore Ushtarake.

Komanda e Mbështetjes Logjistike ofron përkrahje për Forcat e Armatosura përgjatë territorit të Shqipërisë. Ajo përbëhet nga Brigada e Furnizimit, Brigada e Transportit, Baza Logjistike e Mirëmbajtjes, Qendra e Mirëmbajtjes në nivel depoje, Depo Eksport-Importi, Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura dhe Shkolla Logjistike e Trupës. Përveç 5 komandave, Shtabi i Përgjithshëm, ka njësitë e veta autonome siç është Qendra e Operacioneve të Përbashkëta, Batalioni i Komunikimit, Batalioni i Përkrahjes, Batalioni i Policisë Ushtarake, Qendra e Radios së Shërbimit Inteligjent, Baza për Mbrojtje Civile, si dhe Spitali Ushtarak Qendror Universitar. Vetë Shtabi i Përgjithshëm është modifikuar sipas standardeve të NATO-s në nëntë “J-drejtori” që merren me personel, inteligjencë, trajnim, logjistikë, planifikim, komunikim, menaxhim të burimeve, shëndet publik dhe marrëdhënie civile-ushtarake<sup>28</sup>.

Transformimi i sistemit arsimor ushtarak të Shqipërisë është pothuajse i përfunduar dhe nga pikëvështrimi NATO-s është arritja më e madhe e Shqipërisë në reformën e mbrojtjes<sup>29</sup>. Akademia Ushtarake “Skenderbej” ka marrë statusin e universiteti të mbrojtjes dhe mbetet institucioni kryesor për trajnimin e oficerëve për ushtrinë shqiptare, forcën ajrore dhe marinën.

Zhvillimi i një karriere për nënoficerë duket të jetë si qëllimi kryesor profesionalizimit të FASH-it. Reforma në arsimin ushtarak—në zbatim që nga viti 1992—përqendrohet në rritjen e personelit të nënoficerëve që veç kanë një titull universitar<sup>30</sup>. Shkollat e specializuara për trajnim të lëmive të ndryshme ushtarake janë duke përgatitur këmbësorinë, skuadrat tankiste, komunikuesit, artiljerët, pilotët dhe të tjerët për një periudhe një vjeçare, ndërsa Qendra për Stërvitje Bazë është përgjegjëse për stërvitjen bazë të ushtarëve. Përveç sistemit të brendshëm, me qindra pjesëtarë të personelit ushtarak janë trajnuar në vendet perëndimore. Që nga viti 1993, SHBA-ja ka shpenzuar 1 milion dollarë amerikan për të trajnuar ushtrinë shqiptare. Pesëdhjetë njerëz marrin pjesë çdo vit në programin e trajnimit; sidoqoftë, jo të gjithë nga ta kanë dëshirë të kthehen në FASH pas trajnimit jashtë vendit, dhe për ata që kthehen, nuk është e lehtë që të gjejnë një pozitë përkatëse për ta<sup>31</sup>. Në mesin e atyre të pezulluar në vitin 1997, 400 oficerë janë trajnuar në perëndim<sup>32</sup>. Shpresa e Ministrisë së Mbrojtjes është që këta oficerë akoma do të nevojiten për detyrat e parapara për FASH-in në të ardhmen. Sidoqoftë, nuk ka logjikë që të kemi oficerë të trajnuar në perëndim, dhe ti lëmë ata të shkojnë.

Prioritetet e Programit të modernizimit të pajisjeve të FASH-it përfshijnë komplete individuale kryesisht për njësitë e angazhuara jashtë vendit<sup>33</sup>; Sisteme të komandës dhe kontrollit për të cilat investimi është në proces; pajisjen e Regjimentit të helikopterëve me helikopter për kërkim dhe shpëtim dhe transportim të trupave; pajisjen e rojave bregdetare me barka të shpejta të patrullimit dhe me helikopterë për kërkim dhe shpëtim; si dhe forcimin e strukturave të mirëmbajtjes dhe të përkrahjes në transport<sup>34</sup>. Sidoqoftë, i vetmi burim i sigurt për modernizimin e pajisjeve janë donacionet dhe ndihmat, e fundit një donacion italian me 6 anije<sup>35</sup>. Përveç kësaj, në gusht të vitit 2005, Shqipërisë i është dhënë një ndihmë financiare prej 8 milion dollarësh amerikan për rolin e saj në ruajtjen e paqes ndërkombëtare dhe luftën globale kundër terrorizmit<sup>36</sup>. Sidoqoftë, sa i përket mirëmbajtjes dhe problemeve tjera të ngjashme, Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë është më përzgjedhëse në pranimin e llojeve të ndryshme të pajisjeve ushtarake si donacione dhe në vend të kësaj kërkon ndihmë konkrete për qëllime të caktuara të partneritetit<sup>37</sup>.

Buxheti i mbrojtjes për vitin 2005 ishte 12.963 milion lekë (rreth 129.63 milion dollarë amerikan) apo 1,5% e BPK-së. Kjo shënon një ngritje reale prej 20% krahasuar me 2004, me një rritje vjetore të planifikuar të BPK-së prej 0,1% deri me 2010<sup>38</sup> (BPK-ja shqiptare për vitin 2004 ishte 17,46 miliard amerikan<sup>39</sup>). Pas vitit 2010, qeveria pretendon të ruaj këto mundësi mbrojtëse me

mjete financiare që sillen rreth 2% të BPK-së. Sidoqoftë, pritjet që zvogëlimi dhe modernizimi do të zvogëlojë buxhetin për mbrojtje nuk janë të bazuara mirë. NATO po ashtu skeptike sa i përket asaj se a do të jetë e arritshme rritja vjetore prej 0,1% e BPK-së, pasi që reforma e mbrojtjes nuk është prioritet i Ministrisë së Financave<sup>40</sup>.

### ***Integrimi euroatlantik***

Shqipëria ishte ndër vendet e para ish-socialiste që iu bashkua Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC) në qershor të vitit 1992 dhe në Partneritetin për Paqe (PP) në shkurt të vitit 1994. Programi i PP-së bazuar në Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit (PARP) ka kontribuar në ristrukturimin e institucioneve ushtarake shqiptare sipas standardeve të NATO-s. Në prill të vitit 2002, Shqipëria pranoi pakon e Qëllimit të Partneritetit, zbatimin e së cilës pritet të jetë pjesë e FASH-it dhe Planit Zbatues për periudhën 2002-2010. Mekanizmi i NATO-s Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP) ka paraparë një program asistence që është përqendruar në rindërtimin e forcave të armatosura, që ka përfshirë ndihmën në a) krijimin e kornizës konceptuale për forcat e armatosura<sup>41</sup>, b) fillimin e riorganizimit strukturor të ushtrisë dhe c) menaxhimin e problemeve të veçanta, si ruajtja e municionit dhe deponimi i mbeturinave. Fakti që Shqipëria nuk ishte përfshirë në valën e dytë të zgjerimit të NATO-s ka shtuar presionin ndaj qeverisë që të përmirësojë sektorin e saj të mbrojtjes. Samiti i vitit 2008 ka të ngjarë që të merret me një valë tjetër të zgjerimit, kështu që viti 2006 do të mund t'i sjellë Shqipërisë një ftesë të re<sup>42</sup>. Ushtria shqiptare dhe të dy anët e spektrit politik shpresojnë që futja në NATO do të nënkuptonte më pak shpenzime për ushtrinë dhe me shumë siguri për vendin<sup>43</sup>; sidoqoftë, përvoja e vendeve të Evropës Lindore tregon që një ushtri profesionale në fakt kërkon më shumë shpenzime.

Ushtria shqiptare mendon që NATO pret nga ajo kapacitet për interoperabiliteti, stabilitet dhe bashkëpunim, përfshirë edhe një kontribut në operacionet paqeruajtëse të NATO-s. Tirana e sheh rritjen e pjesëmarrësve në misione jashtë vendit të vendeve që aspirojnë NATO-n si lehtësim nga ngarkesa për personelin ushtarak të vendeve perëndimore anëtare të NATO-s<sup>44</sup>. Të punosh me NATO-n për Shqipërinë nënkupton të punosh me vendet anëtare të NATO-s, veçanërisht me SHBA-në, Italinë, Greqinë dhe Turqinë. Një bashkëpunim i tillë përfshin ndihmën në pajisjet ushtarake, trajnim, si dhe prokurimin e pjesëve rezervë<sup>45</sup>. Për shembull, kompania private amerikane “Bashkëpunimi Ndërkombëtarë për Zbatimin e Shkencës ” (SAIC në origjinal),

financuar nga Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-së është duke mbikëqyrur reformën e mbrojtjes shqiptare<sup>46</sup>. Edhe pse dihet që SAIC-ja është përgjegjëse për të gjitha trajnimet e menaxhmentit për Shërbimin e financave dhe administratës së mbrojtjes, nuk ka qenë e mundur që të merren më shumë informata rreth aktiviteteve të kompanisë në Shqipëri. Madje edhe faqja e internetit të SAIC-së nuk e përmend praninë e saj në Shqipëri<sup>47</sup>.

Misioni i përhershëm i NATO-s në Tiranë, i vendosur brenda Ministrisë së Mbrojtjes, është duke monitoruar përmbushjen e marrëveshjeve bilaterale të Shqipërisë dhe i ofron qeverisë këshilla politike dhe teknike. MAP i NATO-s ndihmon Shqipërisë që të përqendrohet në përgatitjet e saja në arritjen qëllimeve dhe prioriteteve përkatëse<sup>48</sup>. Programi Vjetor Kombëtar (PVK) mbulon çështjet politike, ekonomike, të mbrojtjes, resurseve, sigurisë së dhe çështjeve ligjore<sup>49</sup>. Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit (PARP) është iniciuar në kuadër të Partneritetit për paqe, mbështetur në ciklin dyvjeçar të planifikimit, dhe është disenjuar për të ngritur interoperabilitetin dhe për të rritur transparencën ndërmjet aleatëve dhe partnerëve<sup>50</sup> Plani i Veprimit për Partneritet mbi Ndërtimin e Institucioneve të Mbrojtjes (PAP-DIB) ka për qëllim të përforcojë reformat dhe merr parasysh Kodin e Mirësjelljes të OSBE-së mbi Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë<sup>51</sup>. PAP-DIB përfshin masat e reja të mundshme për të ndihmuar dhe harmonizuar bashkëpunimin operacional ndërmjet strukturave të sigurisë të shteteve anëtare, përfshirë edhe ato jashtë përgjegjësisë së MM-së.

Praktikisht të gjitha ndryshimet në FASH bëhen me qëllimin në mendje për anëtarësim në NATO. Sidoqoftë, për shkak të natyrës sekrete të shumë dokumenteve strategjike, nuk është e mundur që të përcaktohen madhësia aktuale dhe ndikimi i aktiviteteve të NATO-s në transformimin e FASH-it<sup>52</sup>. Kriteret për pranim formal në NATO janë përvijuar në Studimin mbi Zgjerimin e NATO-s të bërë në vitin 1995<sup>53</sup>. Kjo përfshin kryesisht kritere jo-ushtarake si funksionimi demokratik i sistemit politik dhe tregut të ekonomisë; trajtimi i pakicave kombëtare në pajtim me parimet e BE-së; zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve me fqinjët dhe një përkushtim për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve; dhe aftësia dhe dëshira për të bërë një kontribut ushtarak ndaj aleancës dhe të arrijë interoperabiliteti me forcat tjera anëtare. Megjithatë, këto kritere janë vetëm kërkesa fleksibile dhe jo domosdoshmërisht parakushte; ndonëse ato mund të bëhen të tilla me kandidimin potencial të Shqipërisë për të hyrë në BE.

Edhe pse BE-ja nuk është e përfshirë në reformën e mbrojtjes së Shqipërisë, sundimi i ligjit është aktualisht një objektivi që vendi duhet të arrihet në mënyrë që të arrihet statusi i kandidatit për BE dhe NATO. Marrëdhëniet e BE-së me Shqipërinë janë pjesë e Procesit të Stabilizim Asocimit (në origjinal SAP). Me anë të SAP-it, Shqipëria mund të negociojë Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (në origjinal SAA) dhe të ketë qasje në treg dhe lidhje tjera me BE-në me kusht që të arrijë kritere të tjera politike dhe ekonomike. Në këtë mënyrë BE-ja e përdorë thirrjen për ftesë eventuale të Shqipërisë që t'i bashkohet Bashkimit si ndikim për përmbushje të një serie reformash për të sjellë sistemin ekonomik dhe politik të shtetit kandidat në vijë me standardet evropiane<sup>54</sup>. Shqipëria formalisht ka aplikuar për anëtarësim dhe një Marrëveshje e Stabilizim Asocimit ka qenë nën negociatë që nga janari i vitit 2003. Raporti i nëntorit të vitit 2005 për progresin e arritur në Shqipëri në kontekst të Procesit të Stabilizim Asocimit ka regjistruar përparim në një numër fushash, por ka bërë thirrje për përmirësim të rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, rritje të lirisë së medieve, reformë zgjedhore të mëtutjeshme dhe kthim më të shpejtë të pronës. Koncepti i Strategjisë së zgjerimit i bërë nga Komisioni në nëntor të vitit 2005 erdhi në përfundim që përparimi i Shqipërisë në reforma ka hapur rrugën për përmbyllje të negociatave për Stabilizim Asocim. Nënshkrimi i marrëveshjes mund të ndodhë në gjysmën e parë të vitit 2006. Në dhjetor të vitit 2005 Këshilli i Evropës miratoi të korigjuar Partneritetin Evropian për Shqipërinë, që identifikon prioritetet afatgjata dhe afatshkurtra që duhet t'i adresoj Shqipëria që të shërbejnë si listë e plotë për matje të përparimit, dhe të ofroj udhëheqje për ndihmë nën Këshillin e Evropës. Në dhjetor të vitit 2005 Këshilli i Evropës miratoi versionin e plotësuar të Partneritetit Evropian për Shqipërinë, që identifikon prioritetet afatgjata dhe afatshkurtra që duhet t'i adresoj Shqipëria dhe të shërbej si udhërrëfyes për ndihmën në kuadër të BE-së. Këto prioritete pasqyrojnë shkallën e veçantë të zhvillimit në të cilën gjendet Shqipëria dhe janë të disenjuara për t'iu përgjigjur nevojave të saj specifike.<sup>55</sup>

Objektivi i përgjithshëm i ndihmës së BE-së është që të sjellë Shqipërinë me afër standardeve dhe parimeve të BE-së dhe të përgatisë vendin për integrim gradual në strukturat e BE-së. Kjo do të ketë një ndikim edhe në sektorin e sigurisë në Shqipëri, përfshirë edhe Shqipërinë. Megjithatë, pa e nënshkruar akoma Marrëveshjen e Asocimit me BE-në, Shqipëria nuk ka bashkëpunim formal me Bashkimin e Evropës Perëndimore (WEU). Sidoqoftë, WEU është e pranishme në Shqipëri. Në mars të vitit 1997 një mision faktmbledhës nga Njësia e Planifikimit të WEU-së ishte dërguar në Shqipëri për të monitoruar situatën pas trazirave publike. Në maj të vitit 1997, Këshilli i WEU

vendosi të krijojë një Forca Policore Shumëkombëshe e Këshilldhënies (MAPE) në Shqipëri, në mënyrë që të ofrojë këshilla dhe trajnim për policinë shqiptare. Për më tepër, WEU është duke shikuar nëse kontribute të mëtutjeshme mund të bëhen në pajtim me programet ndihmëse të NATO-s në fushën e trajnimit ushtarak dhe për ristrukturimin e forcave të armatosura shqiptare<sup>56</sup>.

Integrimi i Shqipërisë në strukturat euroatlantike konsiderohet po ashtu si një element i rëndësishëm në kontekst të Paktit të Stabilitetit (PS) për Evropën Juglindore. Ideja e Paktit të Stabilitetit ishte të forcojë vendet e Evropës Juglindore “në përpjekjet e tyre për të zhvilluar paqen, demokracinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe mirëqenien ekonomike në mënyrë që të arrihet stabilitet në tërë rajonin”. Integrimi euroatlantik ishte premtuar te të gjitha vendet e rajonit<sup>57</sup>. Shqipëria dhe vende të tjera në rajon keqkuptuan Paktin e Stabilitetit si një burim shtesë për përkrahje financiare, gjë që nuk qëndron. Këto pritje të larta janë braktisur sepse aktivitetet e Paktit të Stabilitetit deri me tani nuk kanë gjeneruar ndonjë projekt konkret në Shqipëri.

Shumë indikator të efikasitetit tregojnë që është bërë përparim në marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n dhe BE-në, por, në tërësi, vendi akoma nuk ka arrit të përmbush standardet e tyre dhe akoma është shumë prapa në renditjet zyrtare sa i përket korrupsionit, lirisë dhe konsolidimit demokratik<sup>58</sup>. Sidoqoftë, një ftesë për anëtarësim në NATO konsiderohet nga ushtria shqiptare dhe popullata në përgjithësi si një hap drejt anëtarësimit në BE. Të gjitha partitë politike në Shqipëri kanë si prioritet politik anëtarësimin në NATO dhe BE, por asnjëra nga këto organizata ende nuk ka marrë ndonjë vendim formal për këtë.

### *Bashkëpunimi rajonal*

Çështja e anëtarësimit në NATO ka ndikuar bashkëpunimin rajonal në mes Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor partnere të NATO-s. Platforma themelore për një bashkëpunim të tillë është Marrëveshja e Kartës së Adriatikut ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë (2003). Marrëveshja konsiderohet si një mjet për stabilizimin rajonal, nxitjen e zhvillimit potencial më të shpejt, reformat demokratike dhe ekonomike në vend. Marrëveshja është dokumenti kryesor në bazë të të cilit SHBA-ja dhe anëtarët tjerë të NATO-s mund të ndihmojnë rajonin që të arrijë standardet për anëtarësim në NATO dhe BE. “Procesi i Adriatikut” konsiderohet si mjet përmes të cilit shtetet me lehtësi do të kalojnë nëpër procesin e MAP-it drejt qëllimit strategjik për anëtarësim në NATO<sup>59</sup>. Sa i përket mundësive për konflikt regjional,

Shqipëria gjithmonë është përpjekur që të jetë sa më neutrale në konfliktet etnike në Kosovë dhe Maqedoni, dhe kërkon marrëdhënie normale me shtetet fqinje sllave. Gjatë intervistave të ndryshme të bëra nga autorët, nuk është shprehur asnjë perceptim kërcënues kundrejt Serbisë, edhe pse ka pasur përkrahje të fort për pavarësi të Kosovës.

### ***Udhëheqja politike e reformës së mbrojtjes***

Arritja e standardeve të NATO-s për aftësi mbrojtëse është potencialisht një forcë për reformën demokratike dhe modernizimin e ushtrisë në Shqipëri. Sidoqoftë, reforma aktuale e mbrojtjes kërkon një përshtatje të institucioneve kombëtare për të arritur standardet e NATO-s veçanërisht në marrëdhëniet civile-ushtarake, të cilat akoma nuk janë arrit.

Sipas kushtetutës së saj, Shqipëria është një republikë parlamentare, ku Kuvendi mendohet të jetë institucioni më i lartë shtetëror. Kuvendi duhet të aprovoj të gjitha dokumentet strategjike mbi sigurinë kombëtare dhe politikën e mbrojtjes dhe ushtron kontroll mbi forcat e armatosura. Sidoqoftë, sipas shumë ekspertëve lokal dhe ndërkombëtar, kuvendi është vetëm duke pretenduar të ushtrojë mbikëqyrje mbi sektorin e sigurisë dhe është duke i kryer funksionet e veta shumë dobët. Veçanërisht sa i përket sigurisë kombëtare dhe politikës së mbrojtjes, parlamenti ka luajtur një rol shumë anësor. Për shembull, parlamentarët duhet të mbështetën në informatat e lëshuara nga qeveria dhe ushtria, që janë institucionet që pikërisht ata duhet t'i mbikëqyrin<sup>60</sup>. Mungesa e një debati të duhur është e dukshme madje edhe kur miratohen dokumente që kanë të bëjnë me mbrojtjen. Kjo kryesisht i atribuohet njohurive të kufizuara të shumë deputetëve për çështjet e mbrojtjes, sikurse edhe mungesës së interesit. Çështjet ushtarake janë po ashtu rrallë në agjendën e OJQ-ve lokale.

Për më tepër, kuvendarët nuk kanë burimet, njohuritë përkatëse dhe kohën për të hedhur një shikim më nga afër mbi aktivitetet e tërësishme të qeverisë. Kontrolli i buxhetit supozohet të jetë në brendi të kontrollit parlamentar, megjithëse kjo është një fushë ku ka një zbrazëtim në mes dispozitave kushtetuese dhe praktikës parlamentare. Në Shqipëri, draft ligji mbi buxhetin aprovohet nga kuvendi, i cili më pas duhet të filloj të veproj sipas tij brenda tre muajve nga fundi i vitit buxhetor paraprak. Nëse kuvendi dështon të bëjë një gjë të tillë, Qeveria mund të shpenzojë shumën e njëjtë mujore si mesatarja e shpenzimeve mujore të vitit paraprak<sup>61</sup>. I zgjedhur nga kuvendi, kryetari i vendit ka një rol më tepër ceremonial si Komandant e Përgjithshëm i Forcave



të Armatosura dhe drejtues i Këshillit Kombëtar të Sigurisë (KKS). Sipas Kushtetutës, KKS-ja është një organ këshillues për kryetarin, që diskuton dhe ofron opinione për çështjet e politikës së mbrojtjes, kontrollin e armëve dhe çështjet e sigurisë<sup>62</sup>. Në praktikë, takimet e KKS-së janë mbajtur vetëm për qëllime të marrëdhënieve me publikun dhe rrallë kanë një ndikim në sigurinë kombëtare dhe politikën e mbrojtjes<sup>63</sup>. Kryeministri aprovon strukturën organizative të ushtrisë dhe koordinon punën e institucioneve të përfshira në politikën e mbrojtjes. Kur jemi të kjo çështje duhet thënë që ish-kryeministri, Fatos Nano, krijoj një tjetër institucion këshillues—Komitetin për Siguri Kombëtare— që nuk ka ndonjë bazë ligjore apo kushtetuese. Ky komitet përbëhet nga të njëjtit ministra që marrin pjesë në KKS dhe ka për detyrë aprovimin e instrumenteve kryesore të sigurisë dhe programeve afatgjatë<sup>64</sup>. Komiteti për Siguri Kombëtare i udhëhequr nga kryeministri është një shembull i mirë i mospajtimeve dhe zbrazësive që ekzistojnë ndërmjet dispozitave kushtetuese dhe praktikës së përditshme politike në Shqipëri.

#### *Vendimmarrja në mbrojtje*

Ministri i Mbrojtjes është një post civil. Ministri ka autoritet të plotë mbi të gjithë personelin ushtarak dhe civil brenda departamentit dhe forcave të armatosura në kohë paqe, dhe mbi menaxhmentin e përgjithshëm të forcave të armatosura. Ai është përgjegjës para kuvendit, kryetarit dhe kryeministrit për zbatimin e politikës së mbrojtjes. Ministri i mbrojtjes po ashtu ka autoritetin të propozojë ndryshime në politikën e mbrojtjes dhe në buxhet, dhe merr shumicën e vendimeve në lidhje me procesin e reformës së mbrojtjes në Shqipëri. Ndërmjet viteve 1997 dhe 2005, qeveria shqiptare ka pasur tetë ministra të mbrojtjes, duke qar në zbatim jo konsistent dhe jo efikas të zbatimit të agjendës së mbrojtjes<sup>65</sup>. Përderisa shefi i shtabit të përgjithshëm<sup>66</sup> është përgjegjës para kryetarit, kryeministrit dhe ministrit të mbrojtjes, vartësia e tij tek këto autoritete nuk është gjithmonë e qartë. Për shembull, në punën e tij të përditshme, shefi i shtabit të përgjithshëm bashkëpunon me ministrin e mbrojtjes, por në kohë lufte ai mund të zgjedhet komandant i forcave të armatosura<sup>67</sup>.

Sipas ekspertëve shqiptar, procesi i vendimmarrjes në reformën e mbrojtjes shkon si në vijim: idetë e politikave epen nga Këshilli i Ministrave, përkatësisht nga ministri i mbrojtjes. Shumë ide dalin nga kontaktet politike ndërmjet ministrit (dhe zyrtarëve të lartë ushtarak) me zyrtarët e lartë dhe ekspertët e NATO-s. Pasi që këto ide të formalizohen në koncepte, është detyrë e ekspertëve ushtarak të udhëhequr nga shefi i shtabit të përgjithshëm për t'i shndërruar ato në programe dhe

plane afatgjata dhe afatmesme. Ministri i mbrojtjes pastaj i propozon këto plane për miratim nga Kuvendi<sup>68</sup>. Sidoqoftë, zbatimi i këtyre programeve dhe planeve është problematik dhe përngjan me lëvizjen e trafikut në rrugët e Tiranës, ku shumica e shoferëve nuk i zbatojnë rregullat. Më konkretisht nëse “shoferët” e institucioneve nuk e ndiejnë se ato do të ndëshkohen për shkelje të rregullave, ka pak të ngjarë që ata të kenë ndonjë respekt për ligjin<sup>69</sup>

Koordinimi institucional njihet si thembra e Akilit të Qeverisë. Me pak përvojë në zbatimin e rregullave ligjore dhe administrative, zyrtarët e lartë dhe ekspertët relevant e kanë të vështirë të koordinojnë përpjekjet e tyre. Përveç kësaj, statusi kushtetues i kryetarit dhe kryeministrit është një çështje që sjell tensione në mes dy institucioneve, pasi që të dy shpesh kanë pikëpamje të ndryshme mbi politikën e mbrojtjes dhe atë të jashtme<sup>70</sup>. Është interesante që një marrëdhënie kaq e komplikuar në mes të kryetarit dhe kryeministrit nuk shihet nga NATO si problem i madh, por më tepër si diçka tipike për rajonin<sup>71</sup>.

Për më tepër është e rëndësishme që të mbahet në mend trashëgimia e epokës komuniste, kur ekzistonte një lidhje e ngushtë ndërmjet shoqërisë dhe ushtrisë, por jo domosdoshmërisht një lidhje pozitive. Ushtria ishte e tjetërsuar nga autoritetet komuniste që kanë përdorur retorikën nacionaliste për të arsyetuar policinë represive të tyre<sup>72</sup>. Përsëri në vitin 1997, një nga pasojat e ristrukturimit të FASH-it pas ndryshimit të qeverisë ishte shkarkimi i 1.500 oficerëve të niveleve të ndryshme nga FASH-i, akademitë ushtarake, shefi i shtabit të përgjithshëm dhe ministria e mbrojtjes<sup>73</sup>. Arsyeja e shkarkimit ishte se këta oficerë ishin emëruar nga Partia Demokratike dhe ishin zëvendësuar kështu nga oficerë “besnik” të partisë në pushtet, Partisë Socialiste. Sidoqoftë, në opinionin e përgjithshëm publik ushtria gëzon respekt, por për shumë njerëz ajo duhet t’a luajë vetëm një rol modest në shoqërinë e sotme<sup>74</sup>.

### *OJQ-të dhe Media*

Spektori i OJQ-së në Shqipëri mbështetet në donacionet e jashtme dhe përqendrohet më shumë në çështjet që kanë të bëjnë me demokratizimin, të drejtat e njeriut dhe çështjet ekonomike sesa në ato ushtarake. Shumë pak OJQ janë të përfshira në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes, asnjëra prej të cilave akoma nuk ka bërë një vlerësim serioz të për sfidat e sigurisë të Shqipërisë<sup>75</sup>. Për

shkak të mungesës së ekspertizës ndër anëtarët e partive politike mbi çështjet e sigurisë, qëllimet klasike për anëtarësim në NATO janë marrë si shembull i nevojave të Shqipërisë në aspektin e sigurisë<sup>76</sup>. Në pyetjen: “Çfarë është ndikimi i shoqërisë civile mbi politikën e mbrojtjes dhe të sigurisë?”, një zyrtar i lartë i Ministrisë së mbrojtjes i është përgjigjur me “Nuk ka ndikim”<sup>77</sup>. Vetëdija publike për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes është mjaft e rrallë dhe ekziston një qëndrim se çështje të tilla janë sekrete pavarësisht faktit se dokumentet politike mbi çështjet politike dhe të mbrojtjes e sigurisë nuk janë sekrete. Sidoqoftë, në praktikë, qasja në një dokument ushtarak themelor shpesh paraqet një sfidë.

Sipas kornizës së NATO-s për integrim, institucionet shtetërore u ofrojnë medieve shumë informata, duke lënë përshtypjen që anëtarësimi është e vetmja çështje për transformimin e FASH-it<sup>78</sup>. Gazeta ushtarake “Ushtria” dhe revista “Mbrojtja” ofrojnë informata për FASH-in dhe nuk janë shumë të njohura jashtë FASH-it. Madje edhe për ushtarakët këto publikime janë më tepër propagandë sesa burime të mira të informatave analitike<sup>79</sup>. Kohë pas kohe, gazetat jo-ushtarake publikojnë disa artikuj me interes të ulët mbi çështjet e mbrojtjes, por pasi media supozohet të jetë e orientuar drejt interesit publik, çështjet ushtarake janë jo domosdoshmërisht temë fitimprurëse<sup>80</sup>. Përderisa nuk ka mosmarrëveshje në politikat e mbrojtjes dhe sigurisë ndërmjet qeverisë dhe opozitës, nuk ka skandale, mosmarrëveshje apo ndonjë “lajm të nxehtë” për të raportuar në këtë çështje. Sidoqoftë, gazetarët shpesh akuzohen nga oficerët ushtarakë si të pakualifikuar për të mbuluar çështjet ushtarake dhe të mbrojtjes. Por ndoshta kjo ndodh për shkak të faktit që ata shpesh bëjnë pyetje kontroverse si p.sh. “Çfarë është duke bërë sot ushtria?”, “Pse kemi nevojë për një ushtri kaq të madhe në një mjedis krejt ndryshe të sigurisë së brendshme dhe të jashtme?”, “Çfarë nënkupton reforma e mbrojtjes? Ne nuk e dimë! Ne nuk shohim ndonjë ushtrim!”, dhe “Kah po shkojnë parat e taksapaguesve?”<sup>81</sup>.

Të thuash që reforma e mbrojtjes në Shqipëri ka nevojë për transparencë më të madhe është të konstatosh një fakt të qartë. Trashëgimia komuniste në Shqipëri vazhdon të përjetësoj një mentalitet sipas të cilit të gjitha çështjet janë sekrete. Qasja e kufizuar në informatat mbi çështjet e sigurisë kombëtare ka të ngjarë të vazhdojë të mbetet realitet në Shqipëri në të ardhmen e afërt. Sidoqoftë, Strategjia e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun e reformës së mbrojtjes së Shqipërisë mund të ndryshohet. Një fushatë informative e ministrisë së mbrojtjes duhet të ketë për qëllim jo vetëm fitimin e përkrahjes publike për anëtarësim në NATO, por po ashtu të

shërbejë si burim i informatave në lidhje me atë se çka përmban kjo reformë, pse ajo duhet të bëhet dhe çfarë përfitime do të sjellë ajo për Shqipërinë në veçanti dhe stabilitetin e rajonit në tërësi. Ministria e mbrojtjes ka burimet e duhura për të iniciuar një politikë të tillë duke përditësuar faqen e internetit në baza të rregullta dhe duke përdorur mediet si mjet për komunikimin e tregimeve të suksesshme e jo për përhapje të propagandës.

Perspektiva euroatlantike duhet të jetë një nxitje e fuqishme për zhvillimin e një burokracie ushtarake të mirëfilltë në përputhje me standardet e vendeve të NATO-s. Faktorët ndërkombëtar, që vazhdojnë të përdorin presionin mbi procesin e reformës, gradualisht do të zvogëlojnë rolin e tyre udhëheqës në aspektin e përkrahjes financiare, kështu që Shqipëria duhet të përballoj sfidën e përfshirjes dhe pronësisë ndaj reformës së mbrojtjes. Përveç kësaj, ka një shikëputje në mes të elitës politike dhe oficerëve të demobilizuar, ku këta të fundit janë të frustruar nga pasojat e këtij procesi, duke përfshirë edhe mbylljen e bazave dhe humbjen e vendeve të punës. Ky frustrim, sidoqoftë, mund të zvogëlohet nga një strategji e re për marrëdhëniet me publikun dhe komunikimet e të gjitha institucioneve të përfshira në procesin e reformës, të cilët po ashtu do të gjenerojnë përfshirje dhe përkrahje lokale.

### ***Transformimi i mbrojtjes***

#### **Zvogëlimi në Shqipëri: Përfitime në vend të risistemimit**

Ristrukturimi i FASH-it parasheh mbyllje të tërësishme ose të pjesshme të garnizoneve dhe zhvendosje të njësive. Si pasojë, më tepër se 17.000 oficerë dhe nënoficerë ishin liruar nga shërbimi ushtarak gjatë periudhës 1992-2004 (13.000 oficerë dhe 4.000 nënoficerë). Në mes të tyre, 9.530 të pensionuar gjatë viteve 1992–1995; 5.400 të tjerë në periudhën 1996-2000; dhe 1.140 gjatë viteve 2001–2002. Vetëm 930 oficerë dhe nënoficerë kanë lanë FASH-in gjatë periudhës 2003–2004<sup>82</sup>. Një numër i përgjithshëm prej 211 oficerëve do të demobilizohen gjatë viteve 2005–2006, shumica e të cilëve janë të moshës ndërmjet moshës 40-55 vjeçare. Numri i oficerëve dhe nënoficerëve tepriçë është i lartë. Prandaj është e çuditshme se si për një kohë të gjatë nuk është zbatuar apo përgatitur asnjë program për ri-integrim të ish-ushtarakëve. Opinioni i shumë zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes është ligji i tanishëm për pension mbulon të gjitha nevojat e ish-ushtarakëve<sup>83</sup>.

### *Pensionet dhe përfitimet*

Oficerët tepricë marrin një rrogë të përkohshme për dy vjet (3 vjet për femra), që kap vlerën e 50% të mesatares së rrogës së tyre gjatë viteve të fundit të shërbimit. Nëse ushtari është 47 vjeçar (42 për femra) dhe ka kryer së paku 15 vjet shërbim (12 për femra), ai/ajo ka të drejtën për pension të parakohshëm duke filluar me 50% të rrogës së tij/saj të fundit. Draft ligji i ri, “Mbi sigurimin social suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura të republikës së Shqipërisë” ishte aprovuar nga kuvendi i Shqipërisë me 20 maj 2005<sup>84</sup>. Ky ligj përcakton ndryshime të rëndësishme në marrjen e rrogës së përkohshme, sikurse edhe për pensionin e parakohshëm dhe suplementar. Sipas ligjit të ri, një rrogë e përkohshme do t’u ofrohet ish-ushtarakëve që kanë shërbyer më shumë se pesë vite në FASH. Ata kanë të drejtë për dy rroga shtesë që janë në përpjesëtim me gradat e tyre dhe me 50% të rrogës së tyre mujore të dy viteve të fundit. Një pension i parakohshëm i jepet ish-ushtarakëve me 15 vite shërbim (12 për femra) dhe që janë në moshën 47 vjeçare (44 për femra). Ky pension jepet deri sa personi arrin moshën për pension të rregullt<sup>85</sup>. Pensioni i parakohshëm ka vlerën e 50% të rrogës, me një shtesë prej 2% për çdo vit të shërbimit. Një pension suplementar ka vlerën e 40% të pensionit të plotë, plus 2% për çdo vit shërbimi, pavarësisht moshës dhe nëse një individ ka kaluar 15 vite në shërbim ushtarak (12 vite për femra). Çmimi vjetor i zbatimit të ligjit të ri kapë vlerën e 75 milion lekësh (720.000 dollarë amerikan). Ligji i ri ishte miratuar në janar të vitit 2006, duke lënë dyshime nëse do të ketë fonde të mjaftueshme për zbatimin e tyre të plotë.

Numri i ish-oficerëve ushtarak aktualisht të përfshirë në skemën e sigurimit social është 12.124; 4.876 oficerë tjerë tepricë do të mbesin pa përkrahje së paku deri në vitin 2006 për shkak të mungesës së përvojës punuese<sup>86</sup>.

Figura 1: Përfitimet për ish-ushtarakët

Përfitimet e pensionit	Numri i personelit
Me rrogë të përkohshme	1.595
Me pension të parakohshëm	8.566
Me pension suplementar	1.963

Pa përkrahje për shkak të mungesës së përvojës së punës.	4.876
--	-------

Burimi: Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, maj 2005

Përfitimet shtesë të ligjit të ri përfshijnë mundësinë për të aplikuar për kredi me kamatë të ultë (3%) për të blerë apo ndërtuar shtëpi<sup>87</sup>. Kjo është një pikë që ja vlen të përmendet sepse strehimi nuk u sigurohet oficerëve në FASH; oficerët aktiv duhet të marrin me qira banesa dhe shtëpi. Vetëm një numër i vogël i oficerëve të ri jetojnë në hotelet dhe barakat ushtarake—objekte këto që shpesh kanë mungesë të kushteve më elementare për banim<sup>88</sup>. Sidoqoftë, në realitet, vetëm oficerët e lartë në shërbim aktiv kanë mundësinë për të pasur një nder të tillë pasi që të aplikojnë në një komision të veçantë në ministrinë e mbrojtjes.<sup>89</sup> Shumica e oficerëve tjerë të demobilizuar nuk kanë një përkrahje të tillë ri-integruese.

Veçmas rregullimeve kushtetuese, ministria e mbrojtjes mendon që shumica e oficerëve të pensionuar janë pothuajse të integruar në jetën civile<sup>90</sup>. Sidoqoftë, vetëm 1.862 persona nga personeli i pensionuar kanë gjetur punësim me apo pa ndihmën e ministrisë së mbrojtjes. Një pjesë e madhe e këtyre individëve ishin të “ri-integruar” në sektorin e sigurisë shqiptare, 270 prej të cilëve ishin pozita civile brenda Forcave të Armatosura, 103 brenda shërbimit të inteligjencës, 563 brenda njësive të policisë së ministrisë së rendit publik (MRP) dhe 97 në organet shtetërore të drejtësisë. 839 personat e mbetur janë punësuar në qeveritë lokale, sikurse edhe në strukturat financiare, arsimore dhe private<sup>91</sup>.

Figura 2: Statistikat e punësimit të ish-ushtarakëve (1992-2005)

Agjencia	Numri i personelit
Pozita civile të FA/MM	270
Ministria e rendit publik	563
Shërbimi informativ kombëtar	103
Departamenti i burgut	80
Institucione gjyqësore	10
Policia ndërtimore	7
Të tjera	839

Numri i përgjithshëm	1.872 personel ushtarak
----------------------	-------------------------

Burimi: Ministria e Mbrojtjes shqiptare dhe llogaritje të autorëve, mars 2005

### *Draft Programi i Risistemimit*

Më tepër se 17.000 oficerë dhe nënoficerë janë liruar nga shërbimi ushtarak gjatë periudhës 1992-2004, por deri se voni nuk ka pasur përpjekje nga ministria e mbrojtjes për të zhvilluar ndonjë program ri-integrues për ta. Përpjekja e parë në këtë drejtim nuk ishte bërë nga MM-ja por nga një OJQ, Shoqata Shqiptare e Atlantikut(SHSHA). Draft programi për Risistemim (2003) i SHSHA-së ka pasur për qëllim të ndihmoj përpjekjet shtetërore në krijimin e një sistemi për ri-integrim shoqëror për ushtarakët tepricë. Pikënisja e programit ishte paraparë të jetë krijimi i të ashtuquajturave “Qendra të Risistemimit ”, që do të kishin për qëllim të ofrojnë kurse për orientim profesional në pesë zona të ndryshme: Tiranë, Shkodër, Korçë, Gjirokastër dhe Vlorë<sup>92</sup>. Financimi i programit, i vlerësuar të jetë rreth 2,8 milionë euro për një periudhë pesë vjeçare ishte parashikuar të bëhej nga burime të jashtme. Programi ishte planifikuar të filloj me një pilot projekt në vitin 2004 por ishte shtyrë dhe përfundimisht anuluar për shkak të mungesës së marrëveshjes me MB-në<sup>93</sup>. Sipas MB-së, çmimi i lartë i personelit menaxhues ishte arsyeja për mospajtimin e tyre, sikurse edhe “numri i vogël i ish-ushtarakëve” brenda organizatës së SHSHA, që më sa duket i ka bërë ata më pak të besueshëm në përfaqësimin e interesave të ushtarëve të demobilizuar.

Edhe pse Draft Programi për Risistemim ishte përqendruar më tepër në orientimin post-ushtarak dhe ka kërkuar një amendament në pjesët e saja ri-integruese, ishte plani i vetëm që ka pasur vëmendjen dhe përkrahjen drejtorja e NATO-s për ekonomi<sup>94</sup>. Sipas kryetarit të SHSHA-së, së paku 40% e financimit ishte e nevojshme nga MM-ja në mënyrë që të tërhiqen investitorë të huaj për program, por në realitet nuk ka pasur as edhe një donator të vetëm që aktualisht do të kishte dëshirë të ofronte një financim të tillë. Përderisa NATO e ka përkrahur programin, ajo ka qenë pak e interesuar që ta financoj atë. Përveç kësaj, SHSHA-ja politikisht ishte e afërt me partinë opozitare të asaj kohe, Partinë Demokratike, kështu që dukej të ketë pak arsye për partinë në pushtet të asaj kohe, Partinë Socialiste që ta përkrah programin<sup>95</sup>.

### *Draft Programi mbi trajnimin dhe integrimin e ushtarakëve në jetën civile*

Përfundimi i bashkëpunimit ndërmjet MM-së dhe SHSHA-s ka pasur pak pasoja. Në kohën kur është shkruar ky raport, aktivitetet e MM-së në këtë fushë kanë qenë shumë modeste. Programi i draftuar kohëve të fundit “Programi për trajnimin dhe integrimin e ushtarakëve në jetën civile” planifikohet të jetë një projekt i përbashkët i MM-së dhe ministrisë së punës, dhe përpiqet të mbush zbrazëtirat e programit për risistemim të SHSHA-së<sup>96</sup>. Kjo do të thotë që qasja ka ndryshuar: bashkëpunimi në mes MM-së dhe ministrisë së punës parashihet në formë të përdorimit dhe të mbajtjes së 36 zyrave rajonale për punësim të cilat pothuajse ekzistojnë. Draft programi është një përparim sepse e pranon që masat trajnuese dhe ri-trajnuese duhet të marrin parasysh nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Sidoqoftë, është e domosdoshme të krijohet një strategji afatgjate për të luftuar papunësinë, një prej të cilave është një program ri-integruës për ish-ushtarakët. Qëllimi i draftit është që të promovoj vetëpunësimin e ushtarëve të demobilizuar përmes kurseve të bizneseve të vogla se si të merren kredi, po ashtu ajo promovon transparencë më të madhe dhe përfshirje të OJQ-ve, që janë hapa në drejtim të duhur. Sipas draftit, bordi dhe personeli drejtues do të ndajnë përgjegjësinë me OJQ-të dhe ekspertët e jashtëm në krijimin dhe hartimin e programeve ri-integruese. Mjetet financiare të nevojshme përafërsisht kapin vlerën prej 100.000 euro, që është pak krahasuar me tre milionë euro të kërkuar për draft programin e SHSHA-së.

Hapat praktikë e projektit të bërë përbëhen nga dy faza. Sipas MM-së, faza e parë është duke u zhvilluar dhe përfshinë kurse afatshkurta të ofruara ekskluzivisht nga MM-ja.

Figura 3: Faza e parë

Kursi	Numri i pjesëmarrësve	Periudha (2005)
Kurse 3 mujore të anglishtes (2)	30 (15 + 15)	mars-maj shtator-nëntor
Kurse për kompjuter (2)	20 (10+10)	prill dhe qershor
Kurse për asistencë laboratorike	15	maj-qershor
Kurse për shoferë	8	mars-maj
Kurse për mekanik	12	shtator-tetor
Kurse për kontroll të trafikut ajror	10	prill-maj



Kurse për Meteorologji	10	prill-maj
------------------------	----	-----------

Burimi: Ministria e Mbrojtjes shqiptare<sup>97</sup>

Numri i njerëzve të trajnuar në një mënyrë të tillë është planifikuar të arrijë në 130. Kjo do të kushtojë 1.975.000 lekë (rreth 20.000 dollarë amerikan) të financave të brendshme. Faza e dytë parashihet të ofrojë kurse në administrim biznesi, gjuhë italiane, topografi, financim të bizneseve të vogla, riparim elektrik, servisim makinash, rrobaqepësi, shkathtësi sekretarie dhe të kozmetikës. Faza e dytë planifikohet të sigurohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe duhen fonde shtesë nga qeveria dhe donatorë tjerë. Sidoqoftë, ka pak shpresa për punësim për pjesëmarrësit e të dyja kurseve<sup>98</sup>. Prandaj këto dy faza mund të shihen si kontribute të vogla nga MM-ja për të tërhequr fonde të jashtme në fazat mëvonshme.

Drafti nuk përfshin një përshkrim të kostos së aktiviteteve të planifikuara dhe produktit; në fakt, shumë aktivitete janë planifikuar pa përshkrim konkret të periudhave kohore. Nuk ka të dhëna se sa do të zgjasë periudha përgatitore dhe sa do të zgjasë trajnimi i personelit. Po ashtu nuk ka indikator të qartë të arritshmërisë. Sidoqoftë, që nga qershori 2005, një grup punues i përbashkët ishte krijuar nga ministria e mbrojtjes, ministria e çështjeve sociale dhe Shoqata Kombëtare për Forcat Rezervë të Ushtrisë (NAMRA) në mënyrë që të “identifikohen kualifikimet e duhura në pajtim me kategoritë e personelit ushtarak që duhet të reduktohet” dhe të “vlerësohet kostoja për person për secilin kurs”<sup>99</sup>.

#### *Aktivitetet e OJQ-ve*

Aktivitetet e sektorëve joqeveritare për integrimin e ish-ushtarakëve janë modeste, por krahasuar me mundësitë e MM-së ato duken të jenë më të përqendruara<sup>100</sup>. Kur MM-ja pajtohet të bashkëpunoj me OJQ-të dhe asociacionet e ish-ushtarakëve, ajo ka “preferencat” e saja. Bie fjala, Qendra kombëtare për demilitarizim specializon në çështje të armëve të lehta dhe të vogla, deponimit të municionit dhe të ri-trajnimit. Kjo OJQ ka përkrahjen dhe, çka është më e rëndësishme, përkrahjen financiare të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. MM-ja e konsideron QKD-në si përfaqësuesen e “vërtetë” të interesave të ish-ushtarakëve; ajo është asociacioni më i madh i ish-ushtarakëve, me 250 ish-oficerë<sup>101</sup>. QKD-ja ka bërë një “plan arsimor të ngritjes së vetëdijes për armë të vogla dhe të lehta” me anë të të cilit 4 ish-oficerë ishin punësuar. Përveç kësaj QKD-ja është duke ofruar kurse “trajnim për trajnerët” dhe “trajnime për kompjuter” për

projektet e ardhshme në mbledhjen e armëve dhe deponimit të municioneve. Këto kurse janë duke përgatitur 25 deri 29 oficerë që punojnë në trajtimin e sigurt të municionit dhe armëve të zjarrit, dhe legjislacionit për demolimin e armëve të vogla dhe të lehta.

Një tjetër asociacion, që zyrtarisht është i përfshirë në përkrahjen e ish-ushtarakëve është Shoqata Kombëtare për Forcat Rezervë të Ushtrisë (NAMRA)<sup>102</sup>. NAMRA nuk është vetëm një partner i preferuar nga MM-ja por ka edhe zyrat e saj në selitë e MM-së dhe një rrjet prej 70-80 oficerëve rezervë në tërë vendin<sup>103</sup>. NAMRA përpiket të përkrah ish-ushtarakët duke ofruar këshillë ligjore për çështjet e pensionit. Në mungesë të përkrahjes shtetërore, NAMRA po ashtu përpiket të ndihmoj oficerët rezervë me punësim përmes rrjetave personale në sektorin e sigurisë dhe doganave.

Një objektiv madhor i reformës së periudhës 1995-2000 ishte ofrimi i mundësisë për oficerët e rinj që të marrin diplomë universitare. Ishte paraparë që oficerët do të mund të marrin këtë titull pas përfundimit të Akademisë Ushtarake “Skenderbej” si student me orar të plotë apo me korrespondencë. Sidoqoftë, për shkak të kostos së lartë dhe ndërprerjeve të shpeshta të studimeve me korrespondencë, ky objektiv ishte bërë i pamundshëm<sup>104</sup>. Mundësia e marrjes së arsimit të lartë mbetet akoma—ka mundësi për të studiuar për vende të ardhshme të punës civile përmes kurseve të fundjavës në Universitetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës dhe Elbasanit. Oficerët aktiv dhe të pensionuar po ashtu kanë mundësinë që të marrin diploma në ekonomik, gazetari apo drejtësi përmes kurseve të fundjavës për katër vite<sup>105</sup>. Fatkeqësisht, kostoja e këtij edukimi është 700 dollarë amerikan për vit, që jo të gjithë oficerët aktiv ose të pensionuar mund ta paguajnë. Për më tepër, niveli i lartë i papunësisë nuk është shenjë e mirë madje as për ata me tituj universitar. Në një situatë të tillë, është e vështirë të arrihet përkrahje e gjerë publike për trajtim të veçantë të ish-ushtarëve në një vend të varfër me 17% të popullatës së papunë<sup>106</sup>. Si rezultat i këtyre faktorëve, ish-ushtarakët shqiptar përgjithësisht janë të pakënaqur me mungesën e përkrahjes për integrim nga qeveria.

Ushtria shqiptare mbijetoi rënien e socializmit për dallim nga ish-aparati i planifikimit shtetëror i Partisë Komuniste. Ushtritë kombëtare u shndërruan në simbole të shtetësisë, pavarësisë dhe fuqisë kombëtare. Nga kjo pikëpamje, demobilizimi dhe ri-integrimi i oficerëve të pensionuar duhet të përfshijë krijimin e roleve të reja sociale, rrjeteve, identiteteve profesionale, si dhe

ndihmesa për oficerët që të mposhtin stresin psikologjik. Sidoqoftë, ri-integrimi kërkon një ri-konceptim të institucionit ushtarak, që kërkon dialog publik dhe pjesëmarrje të partive politike dhe medias. Një strategji kombëtare për ri-integrimin e ish ushtarakëve duhet të përgatitet duke u nisur nga pyetja: a duhet lejuar ri-integrimin e ish-ushtarakëve në jetën civile dhe që të njëjtit përmes pagesës së tatimeve të kontribuojnë në sistemin e sigurimit social; apo ata do të duhej të jenë të mbrojtur nga ky sistem? Duket që MM-ja shqiptare parapëlqen këtë të dytën duke ngritur pensionet. Deri më tani, draft programi mbetet në fazën përgatitore dhe fokusohet vetëm në orientimet post-ushtarake pa pjesë ri-integruese bindëse. Për të përmirësuar atë, nëse ekziston një vullnet i tillë, është e këshillueshme të studiohen mënyrat e përshtatjes në tregun e punës të ish-ushtarakëve të pezulluar që nga viti 1993 dhe që në përputhje me këtë të ndryshohet drafti përfundimtar. Qëllimet e çdo programi potencial duhet të formulohen qartë, veçanërisht për sa i përket të drejtave individuale dhe premtimet e bëra duhet mbajtur. Kjo është po ashtu e rëndësishme për besueshmërinë e programit dhe kështu tërheq partnerët e jashtëm. Gjithashtu rekomandohet që përkrahja intelektuale nga ana e organizatave ndërkombëtare të cilat ndërmjetësojnë në një varg të takimeve dypalëshe dhe në grupe punuese për çështje të ri-integrimit, të trajtohen si burim i mundshëm i financimit, duke ofruar argumente dhe modele realiste të ri-integrimit.

### **Transformimi i bazave: ripërdorimi dhe modernizmi**

Shqipëria akoma ka një sistem të mbrojtjes të decentralizuar. Para ndryshimit të regjimit, vendi ka pasur rreth 2.000 baza ushtarake të dedikuara për mbrojtje territoriale, shumica e të cilave i kanë takuar ushtrisë<sup>107</sup>. Për momentin, numri i përgjithshëm i bazave ushtarake, pikave të kontrollit dhe reparteve ushtarake është rreth 1.117. Ndërmjet 586 – 600 baza ushtarake janë planifikuar të lirohen dhe të shndërrohen në të ardhmen e afërt<sup>108</sup>. Planifikimi i transformimit për pronën ushtarake ka filluar në vitin 1992, por vetëm me disa hapa konkret. Gjatë tri viteve të fundit, MM-ja ka qenë në proces të regjistrimit të të gjithë pronës ushtarake dhe ka bërë një studim të fizibilitetit për mundësitë e transformimit të bazave. Sipas zyrtarëve të MM-së, Drafti i planit për transformim përfshin një Program për transformimin e pronës ushtarake deri me 2010, por nuk ishte e mundshme që të ketë qasje gjatë kohës kur është shkruar ky raport<sup>109</sup>. Përdorimi i draft plani për transformim ishte bërë që të miratohet nga kuvendi nga fundi i vitit 2005, në prill

të vitit 2006 ai akoma nuk ishte miratuar. Po ashtu nuk ka edhe shumë shpresë për transparencë, pasi që plani është klasifikuar si gjysmë sekret<sup>110</sup>. Sipas MM-së, të gjitha bazat duhet të shndërrohen: bazat ajrore, flota ushtarake detare, bazat e forcave detare dhe tokësore<sup>111</sup>. Krejt së bashku, MM-ja vlerëson se rreth 2.100 ha e pronës ushtarake do të transferohen<sup>112</sup>.

Ngjashëm me shumë vende tjera që janë përballur me nevojën e transformimit të bazave, MM-ja edhe këtu është agjencia udhëheqëse. Ajo ka bërë studime të fizibilitetit, ka hartuar plane dhe do të jetë përgjegjëse për zbatimin e tyre. Në rend të parë, MM-ja është përgjegjëse për ripërdorimin dhe modifikimin e bazave ushtarake<sup>113</sup>. Sidoqoftë, pasi që ministri i mbrojtjes ta marrë një vendim të duhur, përgjegjësia bartet Agjencia Kombëtare për Privatizim që ka të drejtën të organizoj një ankand publik<sup>114</sup>.

Aktivitetet e transformimit përfshijnë: ripërdorimet ushtarake; sigurimin e strehimit për ushtarakë; transferime në organe të pushtetit lokal; transferime në organe të tjera të pushtetit; privatizim; dhënie me qira dhe mbyllje apo shkatërrim<sup>115</sup>. Modernizimi i Forcave të Armatosura Shqiptare është një forcë shtytëse për shitjen apo transferimin e pronës ushtarake. Në Shqipëri, i tërë procesi i riorganizimit të bazave—përfshirë po ashtu edhe rritjen e përdorimit të lokacioneve për qëllime ushtarake—quhet transformim, në kuptim më të gjerë të këtij termi. Një rritje e tillë në përdorimin e lokacioneve për qëllime ushtarake mund të shfaqet nga shtimi i funksioneve të bazës apo ndryshimi i statusit të bazës. Disa baza ushtarake vetëm kanë ndryshuar statusin e tyre nga baza aktive në ato rezervë. Në mesin e tyre janë bazat e marinës në Senin, Sarandë dhe Porto Romano, si dhe bazat ajrore në Legu dhe Kuçovë<sup>116</sup>.

Figura 4: Modeli i ripërdorimit ushtarak

Lloji i bazës dhe lokacioni	Ndryshimi i statusit	Ndryshimi i funksionit
Bazat e Marinës Senin, Sarandë, Porto Romano	Nga aktiv në rezervë	
Bazat Ajrore Legu, Kuçovë	Nga aktiv në rezervë	
Baza ajrore afër Tiranës		Bazë e forcave për reagim të shpejtë

Baza e forcave tokësore Bunavi		Qendër e Trajnimit Themelor

Burimi: zyrtar i MB-së shqiptare, mars 2005.

Sipas MM-së, të gjitha bazat ushtarake së bashku përbëjnë 6.000 objekte të ndryshme (kryesisht ndërtesa)<sup>117</sup>. Të dhëna mbi llojet e ndryshme të objekteve nuk janë publike, megjithëse numri më i madh për transferim për përdorim civil janë të vendosura në zonat rurale. Pasi që ato janë shumë larg nga zonat urbane, ka pak kërkesë për investitor privat<sup>118</sup>. MM-ja ka dorëzuar objektet ushtarake brenda zonave urbane për tu përdorur për banim nga personeli ushtarak aktiv. Sidoqoftë, në kohën kur është shkruar ky raport vetëm një pjesë e vogël e këtyre objekteve (25 ndërtesa) ishin transferuar për këtë qëllim. MM-ja po ashtu zotëron tokë që është e përshtatshme për ndërtimin e banesave. Drejtoria për ekonomi dhe privatizim e MM-së është duke planifikuar ti përdore këto zona për ndërtim të objekteve të strehimit. Disa nga këto objekte do t'i jepen qeverive lokale, që supozohet të jenë përdoruesit e fundit të pronës ish-ushtarake, sidoqoftë ky transferim duhet të deklarohet na kryeministri<sup>119</sup>. Një numër i objekteve ushtarake (31) pothuajse i ishin dorëzuar komunave, po ashtu edhe ministria e emergjencave do të marrë një numër të caktuar të ndërtesave.

Figura 5: Transformime për qëllime civile

Modeli i përdorur	Numri
Transferimi për banim	25 objekte
Transferimi për qeveritë lokale	31 objekte

Burimi: Ministria e Mbrojtjes shqiptare, mars 2005.

Disa prej pronave ushtarake akoma do të privatizohen apo epen me qira<sup>120</sup>. Po ashtu është planifikuar që një numër i pacaktuar i tyre të mbyllen apo shkatërrohen, përfshirë edhe depot ushtarake të municionit<sup>121</sup>. Objektet e vendosura në Adriatik dhe Jon në teori do të mund të tërhiqnin interesin komercial të kompanive brenda dhe jashtë vendit, kështu që politika e MM-së është që të shndërroj disa nga këto zona ushtarake në zona të rekreacionit për personelin ushtarak dhe familjet e tyre<sup>122</sup>.

Edhe pse qeveria shqiptare ka qenë e hapur për propozime të jashtme në lidhje me transformim, MM-ja nuk ka arritur të tërheq vëmendjen e donatorëve apo investitorëve të huaj për transformim civil<sup>123</sup>. Si i tillë, nuk ka gjasa që ndonjë financim i jashtëm të vijë për këtë lloji i transformimit. Në anën tjetër, pritet që privatizimi dhe dhënia me qira e objekteve ushtarake do të sillte financime të reja në buxhetin ushtarak—shitja e pronës ushtarake tek personat privat shihet si proces në vete i bërjes së parave<sup>124</sup>. Sidoqoftë, sfida është se investitorët e huaj nuk janë të interesuar në pronën ushtarake në Shqipëri<sup>125</sup>. Përkrahja e jashtme nga SHBA-ja, Greqia, Turqia dhe Italia është e gatshme vetëm për restaurimin e bazave ushtarake<sup>126</sup>. Shembuj të ndihmës së tillë janë bazat detare afër Vlorës (ndihmë italiane) dhe Durrës (ndihmë greke), sikurse edhe baza ajrore në Kuçovë (ndihmë turke). Forcat e armatosura italiane janë të etshme të përkrahin transformimin e bazës ajrore afër Tiranës për përdorim nga njësitë e saj në Forcat për reagim të shpejtë të NATO-s, përderisa disa baza rezervë tashmë të transformuara janë paraparë të shërbejnë në përkrahje të NATO-s në raste të jashtëzakonshme<sup>127</sup>.

Figura 6: Ndihma e jashtme për ripërdorimin e bazave ushtarake

Lloji i bazës	Lokacioni	Ndihma
Bazë ajrore	Kuçovë	FA turke
Bazë detare	Vlorë	FA italiane
Bazë detare	Durrës	FA greke
Bazë ajrore/ e Forcave për Reagim të Shpejtë	Rinas/ Tiranë	FA italiane

Burimi: Intervistë me zyrtarë të MM-së, mars 2005.

Çuditërisht, MM-ja pretendon që nuk ka probleme mjedisore sa i përket transformimit të pronës ushtarake<sup>128</sup>. Kjo është më se e diskutueshme pasi që siç kanë dëshmuar përvojat me bazat ushtarake të Evropës Lindore shumë nga to kanë qenë zona shumë të ndotura<sup>129</sup>. Për më tepër, disa nga bazat ushtarake kanë qenë të vendosura afër zonave të njohura për probleme mjedisore. Një nga shembujt është baza detare në Porto Romano, në periferi të portit të Durrësit. Zona është aq toksike sa që në vitin 2001 Programi për Mjedis i Kombeve të Bashkuara (UNEP) e ka shpallur atë si “zonë katastrofale”<sup>130</sup>.

Nuk ka përvoja apo plane të MM-së për të kombinuar transformimi e bazave me ri-integrimin e personelit tepriçë. Disa shoqata të ish-oficerëve, si NAMRA, janë përpjekur që të gjejnë ndërtesa të zbrazëta të MM-së në tërë vendin dhe t'i marrin ato për dhënie me qira simbolike në mënyrë që të krijojnë zona punësimi për ish-ushtarakët, apo si qendra zbavitje (siç janë kazinotë apo klubet e natës) për oficerët aktiv dhe ata shtesë. MM-ja ka qenë skeptike kundrejt propozimeve të tilla pavarësisht faktit se, sipas NAMRA-s, “mbi qindra ndërtesa” nga MM-ja u janë dorëzuar shfrytëzuesve të tjerë përmes lidhjeve politike<sup>131</sup>.

MM-ja insiston se transformimi i bazave është një proces në zhvillim e sipër dhe rreth 20% e ndërtesave pothuajse janë shndërruar<sup>132</sup>. Nuk ka mënyrë të pavarur për të vërtetuar këto pohime sepse nuk ka qasje në statistikat në lidhje me atë se çfarë bazash ushtarake, kur dhe si janë shndërruar ato në vitet e fundit. Edhe pse MM-ja insiston se procesi i transformimit është transparent dhe se shoqëria civile është e informuar rreth aktiviteteve të saj, një plan i transformimit akoma nuk është i gatshëm dhe pritet që pritet të jetë i kufizuar në të ardhmen e afërt<sup>133</sup>. Nuk ka informata për zotëruesit e rinj të pronës ushtarake apo të hyrat e MM-së nga privatizimi i bazave ushtarake. Transformimi i bazave në Shqipëri përfundimisht nuk është transparent sa duhet, ngjashëm si procesi i zvogëlimit dhe risistemimit. Për më tepër, kjo është më e ngatërruara, sepse përfaqësuesit e MM-së e përcaktojnë transformimin e bazave në rend të parë si proces i modifikimit apo reformimit të bazave ushtarake të tanishme për përdorim të mëtutjeshëm ushtarak. Transformimi i bazave ushtarake për qëllime civile po ashtu është futur në proces; kështu nuk është e mundur të merren shumë informata për shkak të përfshirjes së fshehtësisë. Prandaj do të ishte e këshillueshme që të ndahen këto dy procese të transformimit ushtarak dhe civil. Përveç kësaj, pasi MM-ja është institucion përgjegjës për zbatimin dhe kontrollimin e transformimit të pronës ushtarake, ajo ka një interes në privatizimin apo dhënie me qira e pronës së tillë për përfitime financiare. Prandaj MM-ja nuk mund të jetë e paanshme apo “komisionar i ndershëm” në këtë proces, dhe do të ishte e dobishme për një agjenci shtetërore apo edhe një OJQ që të siguroj që interesi i saj të mbahet i kontrolluar.

### ***Përfundimet***

Në matjen e arritjeve dhe mangësive të reformës së mbrojtjes në Shqipëri, është e qartë që faza e parë e kësaj reforme është pothuajse e përfunduar me aprovimin e dokumenteve strategjik,

kornizës ligjore, dhe procesin e “gjetjes së madhësisë” së duhur që është në fazë pothuajse përfundimtare. Strategjia e sigurisë kombëtare, politika e mbrojtjes dhe strategjia ushtarake që të gjitha ofrojnë plane për procesin e reformës në një mënyrë më realiste. Sipas pikëpamjes së NATO-s, vetëm viti i parë ishte i vështirë ku ajo duhet të bënte presion mbi Shqipërinë që të lëvizë përpara me transformime ushtarake. Që nga ajo kohë, Tirana ishte mjaft e përkushtuar në reformën e mbrojtjes<sup>134</sup>. Sidoqoftë, edhe nëse korniza ligjore dhe strategjike ishin bërë, reforma ushtarake drejtohet nga akterët e jashtëm dhe përmes mekanizmit të MAP-it. Prandaj kjo është më tepër një projekt ndërkombëtar sesa kombëtar.

Ekziston pak kritikë e arsyetuar ndër ekspertët e sigurisë në Shqipëri se qëllimi i arritjes së standardeve ushtarake të NATO-s është forca shtytëse prapa reformës së mbrojtjes në vend se të jetë mjedisi i sigurisë, kërkesat e mbrojtjes kombëtare apo të ekonomisë. Në mënyrë paradoksale, madje as ekspertët nuk ofrojnë ndonjë alternativ për integrimin euroatlantik apo në arritjen e standardeve të NATO-s në reformën e mbrojtjes. Në realitet, kërkesat e NATO-s nuk i hedhin poshtë nevojat e sigurisë kombëtare të Shqipërisë dhe në fakt ka konsideratë për mundësitë të ekonomisë kombëtare të Shqipërisë. Për më tepër, standardet e NATO-s në mënyrë pozitive ndikojnë sistemin menaxhues të mbrojtjes dhe përmirësojnë profesionalizmin e FASH-it. Megjithatë, pritjet që zvogëlimi në numër do të pakësoj buxhetin ushtarak dhe do të lejoj FASH-in të modernizohet nuk mbështeten në themele të forta. Fatkeqësisht, përfaqësuesit e NATO-s vetëm gojarishtë e pranojnë se procesi i reformës së mbrojtjes ka arritur sukses të mjaftueshëm, pa ndonjë koment të mëtutjeshëm apo indikator të suksesit apo dështimit.

Sidoqoftë, arritja e kriterëve të NATO-s dhe standardeve të aftësisë mbrojtëse e obligon Shqipërinë të pranojë kulturën e NATO-s në menaxhimin e institucioneve politike, marrëdhëniet civile-ushtarake dhe parakushtet për karrierë ushtarake. Në këtë aspekt, ekziston një brengosje e arsyeshme ndër ushtarakët shqiptarë se ndryshimi i qeverisë nënkupton fundin e karrierës profesionale për shumë oficerë të lartë dhe besnik të partisë që ka qenë më parë në pushtet. Pavarësisht garancisë nga kryetari Alfred Moisiu dhe përfshirja e NATO-s, shumë oficerë mendojnë që kjo politikë do të vazhdojë me çdo qeveri vijuese. Një tjetër pikë kritike është mungesa e transparencës, e cila ishte dëshmuar edhe gjatë mbledhjes së të dhënave për këtë shkrim. Shifrat për ristrukturimin e mbrojtjes të paraqitura në dokumentet e qeverisë, nga zyra qendrore e NATO-s dhe të marra gjatë intervistave jo gjithmonë janë të njëjta. Është e qartë se



trashëgimia e së kaluarës komuniste vazhdon të ndikoj në kulturë të fshehtësisë dhe po ashtu të ndikojë në marrëdhëniet civile-ushtarake në Shqipëri.

Teorikisht, reforma e mbrojtjes duhet të ndihmoj përshtatjen e institucioneve kombëtare me standardet e NATO-s në marrëdhëniet civile-ushtarake. Fatkeqësisht, roli i institucioneve të Shqipërisë në udhëheqjen e reformave mbetet më se i vogël dhe i parëndësishëm. Marrëdhëniet ndërmjet akterëve kryesorë të sigurisë, siç është kuvendi, kryetari dhe kryeministri, paraqesin kundërthënie ndërmjet ligjit dhe praktikës së përditshme. Nga pikëpamja e NATO-s, sidoqoftë, në Shqipëri ekzistojnë instrumenta përkatës për planifikim dhe bërje të buxhetit për reformë të mbrojtjes. Qartazi, ekzistojnë dy realitete (apo statistika)—njëra për Brukselin dhe njëra për publicitet në Shqipëri. Pasi që vetëm një numër i vogël i OJQ-ve janë të përfshira në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes, shumë thjeshtë vetëm përsërisin qëllimin retorik për integrimin në NATO. Në veçanti mediet janë viktimat e mjedisit jo-transparent dhe mosinteresimit të popullatës në çështjet që kanë të bëjnë me sektorin e mbrojtjes.

Nën këto kushte, është e vështirë të vlerësohet aftësia e institucioneve të Shqipërisë që në mënyrë të njëtrajtshme të menaxhojnë reformat e saj dhe të marrin përkrahje publike. Në fakt këto funksione janë marrë nga akterë tjerë të jashtëm si NATO dhe SAIC. Madje edhe nëse nuk është transparent, mekanizmi MAP i vendos qëllimet për kuptimin dhe interpretimin e reformës së mbrojtjes në Shqipëri, siç është interoperabiliteti, stabiliteti, bashkëpunimi dhe pjesëmarrja. Por, ne nuk dimë mjaft rreth asaj se si dhe për çfarë qëllimesh në të vërtetë funksionon MAP.

Demobilizimi i personelit ushtarak tepriçë duhet po ashtu të shihet si pjesë e procesit të gjithëmbarshtëm të procesit të ristrukturimit. Sidoqoftë, ri-integrimi i ish-ushtarakëve në jetën civile mbetet vetëm një pasojë e “dhimbshme”, jo pjesë e reformës së mbrojtjes së Shqipërisë. Çështja nuk duket të jetë prioritet për NATO-n dhe SAIC-n, duke e lënë atë që të trajtohet nga institucionet e dobëta kombëtare<sup>135</sup>. Sidoqoftë, pavarësisht arritjeve në aspekt të reformës së mbrojtjes, akterët kryesorë të sigurisë në Shqipëri nuk janë të aftë që në mënyrë efektive të merren me pasojat e ristrukturimit të forcave të armatosura, siç është ri-integrimi i personelit dhe reformimi i bazave ushtarake. Mungesa e fondeve të gatshme dhe ekspertizës së duhur për përgatitjen dhe zbatimin e programeve ri-integruese as nuk i lejon ato që të fillojnë. Fatkeqësisht, as përkrahja intelektuale e organizatave ndërkombëtare nuk mund ta zgjidh problemin, dhe

donatorët akoma nuk janë të bindur që të përkrahin një program potencial për ri-integrim në Shqipëri. Pamundësia, për të ofruar një program realist për ri-integrim detyron MM-në që të punojë në drejtim të përmirësimit të pensioneve për ish-ushtarakët, pavarësisht nga fakti që mundësitë financiare për zbatim real të ligjit për ngritje të pensioneve për ish-officerët janë shumë të vogla.

Përfshirja e zyrave qeveritare për punësim, asociacioneve të biznesit, agjencive private për këshillime të karrierës dhe OJQ-ve të ish-ushtarakëve në procesin e reformës së mbrojtjes është e dëshirueshme. Sidoqoftë, mosgatishmëria e MM-së për të bashkëpunuar me disa OJQ për shkak të përkatësive apo preferencave politike nuk ndihmon në bashkimin e përpjekjeve për ri-integrimin e ish-ushtarakëve. Pa përkrahjen e jashtme, MM-ja nuk mund të orientohet në programet me orientim në biznes dhe në kurse për vetëpunësim për ish-ushtarakët. Për pasojë, biznesmen ish-ushtarak janë shumë të rrallë në Shqipëri. Përveç kësaj, është për të ardhur keq që OJQ-të e ish-officerëve ushtarak nuk ndikojnë MM-në në politikën e saj ri-integruese, dhe vetëm mund të shpresojnë për, por nuk presin përkrahje të gjerë nga publiku për trajtim të veçantë për ish-ushtarët. Mungesa kornizave të mjaftueshme konceptuale dhe ligjore për një ri-integrim të tillë mund të kenë një ndikim negativ në mirëkuptimin e tërë procesit të reformës nga ana e publikut.

Ka vetëm disa arritje konkrete në transformimin e hapësirave ushtarake në Shqipëri. “Drafti i planit të transformimit deri në vitin 2010” edhe pse nuk është publik, qartazi numëron çka duhet të shndërrohet. Sidoqoftë, MM-ja e përdorë termin transformim në rend të parë për modernizimin e bazave ushtarake. Një pjesë shumë e vogël e pronës ushtarake është planifikuar që të transferohet për përdorim civil. Për më tepër, MM-ja është institucion përgjegjës për zbatimin dhe kontrollimin e transformimit të pronës ushtarake. Si rrjedhojë, shitja apo dhënia me qira është përdorur si “model i transformimit” kryesor për gjenerimin e të ardhurave. Sistemi i tillë i gjenerimit të të hollave dhe i përqendrimit në interes të ngushtë mund të shpjegojë mungesën e transparencës në proces. Si e tillë, MM-ja nuk mund të shihet si e paanshme, “komisionar i ndershëm” në proces. Çdo agjenci jo shtetërore (apo bartje e drejtpërdrejt e bazave të dikurshme) tek administratat lokale dhe rajonale do të kishte nevojë për subvencionim, përderisa për këtë qëllim nuk janë paraparë financime. Fatkeqësisht, qeveria shqiptare nuk ka arritur të tërheq mjete financiare nga jashtë për transformim të bazave.

MM-ja po ashtu pretendon që nuk ka probleme mjedisore në lidhje me transformim të pronës ushtarake, gjë që është mjaft e dyshimtë. Në rastet e kazermave dhe depove, problemet mjedisore mund të jenë thjesht nga mbeturinat, materialet tepricë dhe mbeturinat e lëna, ndonëse ato duken të jenë më serioze në rastet e ish-bazave ajrore, bazave raketore, sikurse edhe në objektet e deponimit të karburanteve të naftës dhe të mjeteve kimike. Nuk ka mënyrë të pavarur për të konfirmuar pohimet e MM-së se rreth 20% objekteve ushtarake pothuajse janë shndërruar. Nuk ka qasje në statistikat rreth asaj se çfarë bazash ushtarake, kur dhe si janë shndërruar ato në vitet e fundit. Transformimi i bazave në Shqipëri përfundimisht nuk është transparent sa duhet, ngjashëm si procesi i zvogëlimit dhe risistemimit. Tregime të suksesshme të transformimit të bazave në Shqipëri— për shembull transformimi i objekteve ushtarake në hapësira civile të banimit, për qëllime arsimore, apo në qendra shoqërore e kulturore—ishin vështirë të gjendeshin.

Edhe pse ka pasur vlerësime thelbësore dhe të hollësishme<sup>136</sup> të transformimit të sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes në Shqipëri, të cilat mundësojnë një kuptim të problemeve të përfshira dhe mënyrën se si duhet qasur atyre, aftësia për mësim institucional dhe rregullim të qasjes mbetet shumë e dobët. Prandaj gjendja e marrëdhënieve të ristrukturimit të mbrojtjes në Shqipëri jo vetëm që paraqet mungesën e aftësive të saja, por po ashtu edhe mungesën e transparencës në vlerësimin e akterëve të jashtëm.

### **3. Maqedonia**

#### ***Reforma e mbrojtjes***

Dëshira për të themeluar një sistem të mbrojtjes sipas trendit euroatlantik dhe bërja pjesë e procesit të gjerë të integritimit evropian është paraqitur që nga krijimi i shtetit maqedonas<sup>137</sup>. Qëllimi ishte që Maqedonia të ndërtonte sistemin e saj të mbrojtjes dhe të strategjisë dhe të inkuadrohet përbrenda mbrojtjes dhe sigurisë kolektive<sup>138</sup>. Prosesi i reformimit filloi mjaftë herët në Maqedoni dhe ka qenë mjaftë i ngadalshëm në dekadën e parë. Maqedonia nuk ishte e përfshirë në luftërat e post- jugosllave të 1990-tave; megjithëse u gjend buzë një lufte civile gjithëpërfshirëse gjatë vitit 2001.

Gjatë viteve 1990-ta, Maqedonia ishte parë si një ishull paqësor dhe i bashkëjetesës ndëretnike. Sidoqoftë, kjo paqe ishte ndërtuar mbi ndarjen faktike të dy komuniteteve kryesore brenda shtetit—maqedonasve etnik dhe shqiptarëve etnik—të cilët pak a shumë kanë jetuar në shoqëri të izoluar ar por paralele, mirëpo me një shkallë të lartë të mosbesimit të ndërsjellët. Në shkurt 2001, shpërtheu një konflikt i armatosur në veriperëndim të Maqedonisë në mes të kryengritësve shqiptarë të armatosur dhe forcave të sigurimit maqedonas. Ushtria Kombëtare Çlirimtare (UÇK), duke rekrutuar kryengritës nga komuniteti shqiptar në Kosovë dhe nga Maqedoni, organizonte beteja guerilësh dhe taktika terroriste, gjoja në protestë kundër diskriminimit ndaj shqiptarëve. Ky konflikt gueril zgjati për gjashtë muaj dhe tensionet etnike dolën jashtë kontrollit derisa komuniteti ndërkombëtarë ndërmjetësoi një marrëveshje për armëpushim në gusht 2001- Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Marrëveshja siguroj më shumë të drejta dhe përfaqësim të shqiptarëve dhe amnisti për luftëtarët e UÇK-së në këmbim për çarmatim dhe shpërbërje të UÇK-së<sup>139</sup>. Kriza e vitit 2001 në mes të komuniteteve maqedonase dhe shqiptare në vend, nxori në shesh konfuzion dhe hezitim në zbatimin e autoritetit ligjor nga institucionet kryesore qeveritare të sigurisë. U formua një njësi paramilitare shqiptare dhe maqedonase, sikurse edhe element të radikalizuar të forcës policore kombëtare.

Gjatë viteve të fundit, programi i Partneritetit për Paqe (PP), Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP) dhe Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM) kanë qenë nxitës për transformim dhe reformim. RSM-ja është miratuar nga kuvendi në pranverë të vitit 2004 dhe pasqyron Konceptin e Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare (2003)<sup>140</sup>. Aktualisht ky dokument është në rishikim për t'u siguruar që akoma vazhdon të jetë i përshtatshëm dhe i zbatueshëm. Kuvendi i Maqedonisë deri më tani ka miratuar Ligjin mbi Rregullimin e Shërbimit Ushtarak (2002) dhe Ligjin e Mbrojtjes (2005). Qëllimi kryesor i Ligjit mbi Rregullimin e Shërbimit Ushtarak është të siguroj përkrahje për rekrutimin dhe ruajtjen e ushtrisë duke krijuar një sistem të menaxhimit të personelit të bazuar mbi një strukturë me renditje racionale, zhvillimin e korpuseve të nënoficerëve dhe edukimin ushtarak sistematik. Ligji i Mbrojtjes siguron një bazë për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura Maqedonase në operacionet jashtë Maqedonisë, e jep mbështetjen e shtetit nikoqir përbrenda Maqedonisë dhe ndalon aktivitetet politike përbrenda forcave të armatosura<sup>141</sup>.

Sistemi i Mbrojtjes Kombëtare po e transformon vetveten nga një mbrojtje e bazuar në rekrutim dhe mbrojtje territoriale në një të atillë që do të inkuadrohet në strukturat e sigurisë euroatlantike. Ai përfshin planet për ushtrinë që të jetë plotësisht profesionale deri në vitin 2008, me përfaqësim përkatës nga të gjitha komunitetet etnike, zvogëlim adekuat të numrit dhe modernizim të

pajisjeve të saj<sup>142</sup>. Forcat e Armatosura Maqedonase (FAM) do të ristrukturohen për të krijuar një forcë të vogël, efikase dhe në përputhje me forcat e BE-së dhe NATO-s dhe. RSM-ja po ashtu ripërcakton rolin e FAM-it, e cila në fund të vitit 2005 e ka kompletuar transferimin e detyrave për mbrojtjen e kufirit tek policia kufitare. Një forcë e kufizuar kundër-kryengritëse do të zhvillohet pasi që opozita e shqiptarëve etnik përfundimisht aprovon një mbështetje të kufizuar për policinë në drejtim të operacioneve të sigurisë së brendshme<sup>143</sup>.

Me një përfundim të suksesshëm të “Operacionit Konkordia” të udhëhequr nga BE në fund të vitit 2003, reformat e mbrojtjes janë udhëhequr nga politika e NATO-s “Dera e Hapur”, e cila është rikonfirmuar në Samitin e Stambollit në 2004<sup>144</sup>. Qëllimi strategjik për t’u bërë anëtarë i NATO-s deri më 2008, nxiti shumë ndryshime brenda FAM-it dhe sistemit të mbrojtjes në tërësi<sup>145</sup>. Koncepti i sigurisë dhe i mbrojtjes kombëtare thekson që “Sistemi i mbrojtjes duhet t’i jap rëndësi të madhe dhe të përgatit udhëheqje dhe plane të veçanta për futjen në përdorim të një sistemi për planifikim, financim, programim dhe bërje të buxhetit sipas standardeve të NATO-s”<sup>146</sup>.

Një prej kërkesave për anëtarësim në NATO ishte de-politizimi i ushtrisë maqedonase. Sidoqoftë, procesi formal i de-politizimit nuk mënjanoi të gjitha lidhjet dhe parapëlqimet politike të klasave elite. Ndërrimi i fuqisë politike gjatë zgjedhjeve, zakonisht nënkupton ndërrimin e oficerëve të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes (MM), Shtabin e Përgjithshëm dhe FAM<sup>147</sup>. Përderisa kushtetuta maqedonase nuk e ndalon që anëtarët e ushtrisë të bëhen anëtarë të partive politike, neni 47 i Ligjit të Mbrojtjes e qartëson se “...anëtarësimi në parti politike nuk duhet të ndikoj në emërimet, gradimet, vlerësimin, edukimin, trajnimet shtesë, shpërblimin dhe të drejta të tjera të personelit ushtarak por edhe të nëpunësve tjerë në FAM”<sup>148</sup>. Përbrenda FAM-it, partitë politike apo asociacionet qytetare nuk mund të organizohen apo të jenë funksionale.

Personeli ushtarak përgjatë kryerjes së shërbimit nuk bën të drejtohen nga përkatësitë e tyre politike dhe as nuk mund të shprehin apo përfaqësojnë qëndrimet politike në orar të punës dhe të ndikojnë në personat tjerë.

Ushtarakët nuk guxojnë të ndjekin dhe marrin pjesë në tubime politike dhe publike të veshur në uniforma dhe as nuk guxojnë të përdorin asnjë simbol të partive politike.

Ngjashëm me reformat tjera të mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor, ristrukturimi dhe zvogëlimi në numër është një nga veçoritë kryesore të reformimit të mbrojtjes në Maqedoni. Komponenti aktiv i kohës së paqes në FAM është reduktuar nga 16.000 në vitin 2002 në 12.852 (duke përfshirë 70% profesionistë dhe 30% rekrutë) në vitin 2003<sup>149</sup>. Në mars të vitit 2005, fuqia e përgjithshme e FAM-it— përfshirë këtu edhe nëpunësit e MM-së— ishte 8.869 civil dhe personel ushtarak: prej të cilëve 1.556 janë oficerë, 2.120 nënoficerë, 2.679 ushtarë me kontratë dhe 1,365 civil<sup>150</sup>. Në maj të vitit 2005, numri i rekrutëve ishte llogaritur të jetë rreth 10.000<sup>151</sup>. Forca e planifikuar, që parashihet të arrihet në vitin 2007, është 8.460 individë, përfshirë edhe 919 oficerë, 1.930 nënoficerë dhe 817 civilë. Numri i ushtarëve më kontratë është planifikuar të rritet në 4.794, përderisa rekrutimi është planifikuar të shfuqizohet deri kah fundi i vitit 2006.

Figura 7: Forca e tanishme dhe e planifikuar e FAM-it<sup>152</sup>

	Civilë MM	Civilë FAM	Oficerë të FAM-it	Nënoficerë të FAM-it	Ushtarë me kontratë	Total
2005	1149	1365	1556	2120	2679	8869
2007 (planifikuar)	453	364	919	1930	4794	8460
Ndryshimi	696	1001	637	190	+2115	409

Burimi: Ministria e Mbrojtjes maqedonase, mars 2005

Është shpresuar që zvogëlimi në numër i forcave të armatosura do të përmirësojë numrin e shpërpjesëtuar të oficerëve në të gjitha nivelet përbrenda hierarkisë së korpusit të oficerëve. Sipas Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM), përbërja ideale e radhëve brenda Ministrisë së Mbrojtjes dhe FAM-it parashihet të jetë:

Figura 8: Kategorizimi gradave Brenda Korpusit të Oficerëve të FAM-it

Grada	Planifikuar në vitin 2007	% e numrit total të oficerëve të planifikuar për vitin 2007	Aktual	% e numrit total të oficerëve në vitin 2007	Ndryshimi ndërmjet numrit aktual të oficerëve dhe atij të planifikuar
Gjeneral	7	0,9	8	0,49	1

Kolonel	58	6,3	92	5,59	34
Lt Kolonel	127	14	250	15,19	123
Major	205	22	284	17,25	79
Kapiten i klasit të I-rë	0	0,00	94	5,71	94
Kapiten	223	24	451	27,40	228
Lejtnant	243	26	356	21,63	113
Lejtnant i dytë	56	6,1	111	6,74	55
TOTALI:	919	100,00	1646	100,00	727

Burimi: Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes Maqedonase, Shkup 2004.

Shndërrimi nga një ushtri rekrutuese në një ushtri profesionale, është planifikuar të realizohet kah fundi i vitit 2007. Për këtë qëllim është sistemi i edukimit ushtarak profesional i Maqedonisë, që është një pikë kritike për procesin e reformimit të mbrojtjes së vendit. Akademia e vetme ekzistuese ushtarake është themeluar në vitin 1995 dhe detyra kryesore e saj është të edukoj, trajnoj dhe të siguroj zhvillim profesional për personelin e FAM-it<sup>153</sup>. Sidoqoftë, shumë nga shërbimet trajnuese të Akademisë aktualisht janë në moratorium për shkak të numrit të tepërt të oficerëve në të gjitha nivelet. Klasa e fundit e kadetëve të diplomuar është shpallur tepriçë. Tani ka mbetur edhe një klasë të diplomoj dhe pritet që edhe ajo të deklarohet si e tepërt<sup>154</sup>. Ekzistojnë modele të ndryshme për transformimin e Akademisë Ushtarake të cilat do të përfshinin edhe Akademinë në zhvillimin profesional të oficerëve. Sidoqoftë, duket që vullneti për të transformuar këtë institucion mungon. Nëse Akademia Ushtarake do të duhej të mbijetoj si institucion është më se e qartë se ajo duhet të transformoj vetveten për të arritur standardet trajnuese të NATO-s. Aktualisht Akademia Ushtarake ofron kurse trajnimi afatshkurta (6 muaj) për nënoficerët. Sipas shtegut të ri të karrierës oficerët do të tërhiqen drejtpërsëdrejti nga universiteti. Sidoqoftë, grupet punuese të nënoficerëve planifikojnë që trajnimet për nënoficer të bëhen vetëm përbrenda Komandës Trajnuese së Shtabit të Përgjithshëm. Tani ajo ofron kurse elementare dhe të avancuara për nënoficerë.

Përveç trajnimeve nga institucionet kombëtare, firma amerikane Booz, Allen & Hamilton (BAH)<sup>155</sup> dhe ekipi i ekspertëve të NATO-s (NAT) janë duke ofruar këshillime për ministrinë e mbrojtjes dhe FAM-it. Të dyja entitetet janë të vendosura në MM (shih kapitullin vijues). BAH

ofron këshilla për ministrin, sekretarin e shtetit dhe këshilltarët shtetërorë përbrenda MM-së në fushën e planifikimit, buxhetit, logjistikës, resurseve njerëzore dhe kurseve të gjuhës. BAH punon po ashtu me shtabin e përgjithshëm kryesisht me departamentet e tij si G1 (Personeli), G3 (Trajnime) dhe G4 (Logjistikë). Qëllimet e kontraktuara janë mbarështruar në Planin vjetor të fushatës së Komandës së SHBA-ve për Evropë, ku si qëllim parësor përcaktohen transformimi i MM-së dhe i FAM-it. Qëllimi i NAT është që të ndihmoj MM-në dhe FAM-in që të plotësojnë standardet e NATO-s dhe të verifikoj se standardet janë zbatuar në njësitë e shpallura. Në këtë nivel, NAT-i punon ngushtë me shtabin e përgjithshëm dhe bënë vizita të shpeshta inspektuese tek njësitë e FAM-it përbrenda Maqedonisë.

Ristrukturimi i MM-së dhe FAM-it është pjesë e procesit të ngritjes së numrit të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në pozitave të institucioneve mbrojtëse të Maqedonisë. Kërkesa është që 25% e të gjitha pozitave përbrenda FAM-it të jenë të plotësuara nga shqiptarët etnik. Aktualisht, 2,54 % e personelit ushtarak janë shqiptarë kundrejt 92,79 % të maqedonasve etnik<sup>156</sup>. Numri i komuniteteve tjera pakicë (boshnjakët, romët, serbët, turqit dhe vllahët) të përfaqësuar në FAM po ashtu planifikohet të rritet (Shih Shtojcën, Figura 1).

Aktualisht, 1,227 janë oficerë etnik maqedonas, përderisa janë vetëm 68 shqiptarë etnik në nivel të oficerëve. Përpjesëtimi etnik duhet të ndryshohet deri më 2013 në një përpjesëtim më të baraspeshuar prej 591 në 232. Struktura aktuale e personelit të MM-së është 415 maqedonas dhe vetëm 16 shqiptarë. Sidoqoftë, është një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve etnik në pozitave të larta brenda ministrisë; Drejtuesi i Sektorit të Personelit dhe Zëvendës Ministri i Mbrojtjes janë shqiptarë.

Figura 9: Përbërja etnike e personelit të MM-së

	Totali i tanishëm	Totali i planifikuar për vitin 2013	Ndryshimi
Maqedonas	415	205	-210
Shqiptarë	16	81	+65
Turq	-	12	+12



Romë	-	8	+8
Serbë	10	6	-4
Boshnjak	2	3	+1
Vllehë	9	1	-8

Burimi: Ministria e mbrojtjes së Maqedonisë, mars 2005.

Dy programe për integrimin e pakicave në FAM dhe MM janë miratuar nga MM-ja në mars të vitit 2005<sup>157</sup>. Njëri program ka për objektiv kandidatët me arsimim universitar, përderisa programi tjetër ka për objektiv ata me shkollim të mesëm për plotësimin e pozitave të oficerëve dhe nënoficerëve përbrenda FAM-it dhe MM-së. Sipas Marrëveshjes Kornizë së Ohrit (OFA), e cila kërkon përfaqësim të përpjesëtueshëm të të gjitha komuniteteve etnike në shërbimet shtetërore, programi i integritit për pakica me arsimim universitar duhet të kompletohet deri më 2013.

Figura 10: Integrimi i shqiptarëve me arsimim universitar në njësitë e forcave të armatosura në vitin 2005

Njësitë	Aktual	Parashikuar	Ndryshimi
MM-ja	16	81	+65
Akademia ushtarake	0	4	+4
Inteligjenca ushtarake	4	17	+13
FAM	0	11	+11
Totali	20	113	+93

Burimi: Ministria e Mbrojtjes maqedonase, mars 2005

Prej vitit 2006 e tutje, numri i oficerëve shqiptarë etnik përbrenda FAM-it do të rritet çdo vit, në vitin 2013 numri i përgjithshëm do të jetë 136.

Figura 11: Integrimi i shqiptarëve me arsimim universitar në FAM në periudhën 2006–2013

2006	+50
2007	+52
2008	+6

2009	+6
2010	+6
2011	+6
2012	+5
2013	+5
Totali: 2006–2013	+136

Burimi: Ministria e Mbrojtjes maqedonase, mars 2005.

Për njerëzit me edukim të mesëm, plani i integrimit do të kompletohet deri në vitin 2007 me një rritje të vogël të numrit të shqiptarëve në 77.

Integrimi i pakicave në FAM në përgjithësi është çështje kundërthënëse në Maqedoni, kryesisht sepse ajo përfshin zvogëlimin e përfaqësimit dhe të pozitave për maqedonasit. “Tradicionalistët” në mesin e oficerëve maqedonas fuqimisht e kundërshtojnë integrimin e shqiptarëve, duke pretenduar se ata nuk kanë lidhje patriotike me Maqedoninë. Liderët e partive opozitare po ashtu janë të mendimit që arsyeja e vetme e ri-integrimit të pakicave duhet të jetë kualifikimi profesional dhe aftësitë, dhe jo përkatësia etnike e tyre<sup>158</sup>.

Po ashtu ka edhe çështje të tjera problematike. Për shembull, dy kurse për kandidatët për nënoficerë nga komunitetet pakicë janë mbajtur në vitin 2005 dhe në fillim të vitit 2006. Për shkaqe operationale (gjegjësisht fonde), që të dy këto kurse janë mbajtur në nivel të kurseve standarde për nënoficerë, pa hyrë fare në nivelizime të shkathtësive. Rezultatet e të dyja kurseve ishin të përziera, dhe një pjesë e konsiderueshme e kandidatëve për nënoficerë ishin të paafte të diplomojnë. Është e qartë se FAM-i është duke u përpjekur të plotësoj kërkesat e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, duke pasur për pasojë qoftë numër më të vogël të kandidatëve të diplomuar nga radhët e pakicave apo në individë të pakualifikuar brenda radhëve të nënoficerëve.

Po ashtu ka edhe dallime kulturore në mes të grupeve etnike që mund t’u bëjnë të pamundur arritjen e disa caqeve të përcaktuara nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Për shembull, ligji i tanishëm mbi shërbimin kërkon që për t’iu bashkuar FAM-it duhet që së paku të kesh të përfunduar shkollën e mesme. Sidoqoftë, disa grupe etnike akoma nuk kanë qasje në edukimin e mesëm apo nuk besojnë që arsimimi i lartë është i nevojshëm. Ky është një problem i cili duhet

adresohet në nivel kombëtar, pasi që është jashtë kufijve të kërkesave tradicionale të mbrojtjes. Megjithatë, integrimi i pakicave në FAM është kuptuar si kusht parësor për anëtarësim të vendit në NATO, dhe aleanca shpreson për zbatimin e tij të plotë nga autoritetet maqedonase.

Modernizimi dhe sigurimi i pajisjeve të reja duhet të jetë në pajtim me mundësitë e planifikuara dhe kapacitetet e FAM-it dhe të jetë në pajtim me normat e NATO-s dhe planifikimin buxhetor. Forcat speciale kanë përparësi në marrjen e pajisjeve të reja<sup>159</sup>. Krahas planeve për blerjen e pajisjeve të reja, Maqedonia duhet të zgjidh çështjen e pajisjeve ushtarake të vjetruara dhe të tepërta<sup>160</sup>. Procesi i largimit të këtyre pajisjeve ka filluar me rrënimin e tankeve T-55 në janar të vitit 2004 me vendim të qeverisë. Në pajtim me Planin për Modernizim, 61 tanke tashmë janë shkatërruar dhe 30 tanket e mbetura do të shkatërrohen po ashtu. Katër aeroplan SU-25 janë nxjerrë jashtë përdorimit, MM-ja shpreson që të gjejë një partner serioz për këmbimin e këtyre aeroplanëve me pajisje tjera apo me shërbime të mirëmbajtjes. Heqja e armëve sovjetike është shumë kontradiktore. Sidoqoftë, kjo është kuptuar si proces i modernizimit të FAM-it dhe në pajtueshmëri me standardet e NATO-s. Nga kënd vështrimi i NATO-s, megjithatë, kjo nuk ka të bëjë me pajtueshmërinë, por me faktin se maqedonasit kanë pak para për të mirëmbajtur tanket dhe aeroplanët sovjetik<sup>161</sup>.

E përcaktuar t'i reformojë forcat e armatosura të saj kryesisht duke përdorur mjete buxhetore të brendshme, Maqedonia në vitin 2004 për ushtrinë ka ndarë buxhet prej 6.108 milion denarësh (122 milion dollarë amerikan), që ishte gati 2,3% e BPK-së së planifikuar<sup>162</sup>. Shuma e buxhetit për mbrojtje në vitin 2005 ishte 6.413 milion denarë (122 milion dollarë amerikan) që është rreth 2,4% e BPK-së<sup>163</sup>. Megjithatë, ndihma nga jashtë mbetet burimi kryesor i zhvillimit të ushtrisë në Maqedoni. Për shembull në vitin 2003 SHBA-ja ka ndarë pothuajse 12 milion dollarë amerikan—duke përfshirë përkrahjen për Forcat Speciale—që ta përmirësoj gatishmërinë e njësive, themelimin e një sistemi të TI-së (Teknologji Informative) në pajtueshmëri me standardet e NATO-së, dhe të zhvilloj në Krivolak hapësirën stërvitëse për gjuajtje nga armët e zjarrit si një qendër rajonale e trajnimit në kuadër të “Kartës së Adriatikut”.

Shumë indikatorë të efikasitetit dëshmojnë përparim në reformat e mbrojtjes në Maqedoni. Sidoqoftë, Maqedonia ende ka mangësi në arritjen e disa standardeve të NATO-së. Buxheti i vendit për ushtrinë akoma nuk mund t'i plotësojë kërkesat e NATO-së. Tash së voni, NATO-ja kërkoi zhvillimin e njësive shtesë me shkathtësi të specializuara, më e rëndësishmja, Qendra

Operacionale për Mbikëqyrjen Ajrore (ASOC). Sidoqoftë, këto shtesa nuk janë të realizueshme me buxhetin aktual të Maqedonisë për mbrojtje. Shpenzimet minimale të parashikuara për ASOC-un janë 23 milion dollarë amerikanë. Fillimisht, është menduar se kërkesa për ASOC-un më së miri do të mund të rregullohej përmes një zgjidhje rajonale dhe do të ishte me e kapshme për buxhetet ushtarake të vendeve pjesëmarrëse

### ***Integrimi Euroatlantik***

Në vitin 1993, kuvendi maqedonas miratoi vendimin për të kërkuar integrimin euroatlantik të vendit dhe në vitin 1995 Maqedonia iu bashkua Programit të Partneritetit për Paqe (PfP). Një ekip i ekspertëve të NATO-s (NAT) është përherë i vendosur në MM-në maqedonase. Ky ekip është i përbërë nga këshilltarë ushtarak të shteteve të ndryshme anëtare të NATO-së dhe përcaktohen në NAT për periudha 3-6 mujore. Sidoqoftë, periudha e shkurtër e detyrës së oficerëve të NAT e bën të vështirë ndërtimin e marrëdhënieve të vazhdueshme dhe të besueshme me homologët e tyre në MM dhe FAM.

Tash së voni, përmes një marrëveshje dy paleshe, Franca, për shembull, ka mundur të sigurojë një përfaqësues të resurseve humane dhe të personelit për një periudhë dyvjeçare në kuadër të NAT. Kjo do të sigurojë vazhdimësi në këtë sektor të rëndësishëm për NATO-n. Qëllimi kryesor i NAT është të ofrojë mbështetje dhe ndihmë për FAM-in dhe shtabin e përgjithshëm në arritjen e standardeve të NATO-s. Detyra të ndryshme përbrenda Planit të Veprimit për Anëtarësim (MAP) dhe PfP janë marrë përsipër që të sigurojnë që Maqedonia do të plotësojë kërkesat për anëtarësimin e plotë në NATO. Anëtarët e ekipit japin këshilla dhe kanë aftësinë të ofrojnë informata shtesë apo trajnime sipas kërkesës<sup>164</sup>.

### ***NATO dhe KPU-të***

Programi maqedonas i partneritetit individual (IPP) përfshin pesë pjesë, duke mbuluar kushtet politike dhe ekonomike, preokupimet ushtarake dhe të mbrojtjes, çështjet e burimeve, statusin e sigurisë dhe çështjet ligjore. Përveç kësaj, Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit (PARP) siguron mjete për shtimin e interoperabilitetit në mes të Maqedonisë dhe NATO-s në zonat paqeruajtëse, misionet humanitare sikurse edhe në operacionet kërkuese dhe shpëtuese. Po ashtu kontribuon në transparencën e planifikimit të mbrojtjes. Për më tepër, MAP-i, që ka filluar në prill të vitit 1999, udhëheqë reformat e mbrojtjes në Maqedoni. Sikurse edhe aspiruesit e tjerë të NATO-s,

Maqedonia ka parashtruar Programin vjetor kombëtar (PVK) për përgatitjet në favor të anëtarësimit. Qëllimet e PVK-së dhe parashikimet e punës janë rifreskohen çdo vit.

Presioni ditor në arritjen e qëllimeve të transformimit dhe standardeve të NATO-s zbatohet nga firma amerikane Booz, Allen & Hamilton (BAH). Të dyja BAH-u dhe NAT luftojnë me burokracinë dhe me mentalitetin post-socialist në Maqedoni<sup>165</sup>. Të pyetur për raportin në mes të NATO-s dhe BAH-ut në Shkup, përfaqësuesit e NATO-s theksuan se ekipi i tyre këshillues luan rolin kryesor në procesin e ristrukturimit të FAM-it dhe përdorë një qasje të koordinuar me BAH-un, të cilët po ashtu përpiqen për të njëjtat qëllime<sup>166</sup>. Të pyetur për të njëjtën çështje përfaqësuesit e BAH-ut theksuan se ata e luajnë rolin kryesor në transformimin e MM-së dhe FAM-it, dhe se anëtarësimi në NATO është qëllimi kryesor në këtë proces. Është e qartë se ekziston pak rivalitet profesional. Rezultati përfundimtar është se të dyja entitetet përpiqen që MM-në dhe FAM-in t'i drejtojnë drejt një strukture mbrojtëse moderne.

Për shkak të karakterit të kufizuar të të gjitha dokumenteve dy palësh strategjik, nuk është e mundur të përcaktohet ndikimi real i strategjisë së integritit në NATO në transformimin e FAM-it. Vetëm PVK-ja shërben si burim kryesor i informacionit në ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Maqedonisë<sup>167</sup>. Konceptet e interoperabilitetit, stabilitetit, bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në operacionet e paqeruajtës janë përsëritur vazhdimisht për të përshkruar këtë proces të transformimit dhe qëllimet e tij<sup>168</sup>. Nganjëherë duket që ideja e anëtarësimit në NATO është shndërruar në një lloj dogme në Maqedoni, pa ndonjë alternative tjetër<sup>169</sup>. Sipas sondazhit të fundit të Institutit për Demokraci, Solidaritet dhe Shoqëria Civile në Maqedoni tregon se 68,89 % e njerëzve e mbështesin anëtarësimin në NATO, përderisa 13,97% u përgjigjën kundër, ndërsa 13,49% nuk kishin mendim dhe 2,67% nuk u përgjigjën fare<sup>170</sup>.

### *Bashkimi Evropian*

NATO-ja dhe BE-ja kanë një interes të përbashkët në Ballkanin Perëndimor, që është krijimi i demokracive stabile, të guximshme dhe paqësore. Që të arrihet kjo, aleanca dhe BE-ja kanë vu në përdorim mjete të ndryshme.

Mjeti kryesor nga ana e BE-së është Procesi i Stabilizim Asocimit (SAP) dhe për NATO-n mjetet kryesore janë PfP-ja dhe MAP. Marrëveshjet për Stabilizim Asocim (SAP) janë nënshkruar nga Maqedonia në prill të vitit 2001, përderisa me 9 nëntor të vitit 2005 Maqedonisë i

është pranuar statusi ‘kandidat’ për anëtarësimin në BE<sup>171</sup>. Sidoqoftë, statusi i kandidatit i është dhënë por pa perspektivë të qëndrueshme dhe pa afat kohorë për negociatat për anëtarësim<sup>172</sup>. Aktualisht BE-ja është fokusuar në mbështetjen e Maqedonisë në katër fushat thelbësore: demokraci dhe sundim të ligjit, zhvillim ekonomik dhe social, drejtësi dhe çështjet e brendshme dhe politikat e mjedisit<sup>173</sup>. Nëse Maqedonisë i lejohet të filloj bisedimet për hyrjen në BE, ajo do të mund të kërkoj financim për reformat institucionale si dhe reforma tjera në shuma më të mëdha sesa lejon marrëveshje e tanishme njohur si Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS)<sup>174</sup>. Sipas sondazheve më të fundit, maqedonasit fuqimisht mbështesin anëtarësimin në BE dhe ndjehen të sigurt se shteti është në rrugë drejt anëtarësimit. Të dhënat nga Sektori i Integritimit Evropian në maj të vitit 2004 treguan se 91,4% të maqedonasve u përgjigjen me “po” pyetjes për hyrje në BE<sup>175</sup>. Të gjitha partitë politike maqedonase e kanë përfshirë në prioritetet e tyre anëtarësimin në NATO dhe BE<sup>176</sup>. Si në shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, mundësia për anëtarësimin në NATO ka tërhequr veçanërisht interesimin e Maqedonisë në vitin 2002- 2003, pjesërisht sepse është konsideruar më e lehtë sesa plotësimi i kërkesave më të ndërlikuara të BE-së; dhe pjesërisht për shkak të simbolizmit për shtetet lokale të cilat po transformoheshin nga ‘konsumatorë’ në ‘prodhues’ të sigurisë. Shumë nga indikatorët e efikasitetit dëshmojnë përparimin e raportit të Maqedonisë me BE-në. Sidoqoftë, Maqedonia akoma ka mangësi në plotësimin e standardeve të BE-së<sup>177</sup>.

#### *Perceptimi i kërcënimit dhe bashkëpunimi rajonal*

Në të gjitha dokumentet strategjike theksohet që nuk ka rreziqe për luftë konvencionale në Maqedoni<sup>178</sup>. Sidoqoftë, perceptimi i kërcënimeve ndër maqedonasit etnik është statusi i pavarur i Kosovës fqinje. Shumë maqedonas etnik shpresojnë që Kosova kurrë nuk do të arrijë pavarësinë, pasi që kjo do të paraqiste precedent për komunitetin shqiptarë në Maqedoni, që do të ishte katastrofale për zhvillimin e shoqërisë shumë etnike në Maqedoni<sup>179</sup>. Në anën tjetër qeveria dhe kryetari i Maqedonisë kanë bërë deklarata diplomatike që mbështesin zgjidhjen e statusit të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare. Disa politikan maqedonas fuqimisht mbështesin një Kosovë të pavarur. Në mesin e tyre është edhe zëvendës ministri i mbrojtjes Talat Xhaferi, i cili e ka theksuar këtë si qëndrim të tij personal<sup>180</sup>. Komuniteti shqiptarë në Maqedoni nuk sheh ndonjë rrezik nëse Kosovës i epet pavarësia.

Procesi i Adriatikut, i cili përfshin Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë, në Maqedoni konsiderohet si mjet transportues regional që do t’i drejtojë këto shtete lehtëazi përgjatë procesit

të MAP-it në qëllimin përfundimtarë të anëtarësimit në NATO<sup>181</sup>. Ekzistojnë aktivitete në nivele të ndryshme të ekspertëve, sikurse edhe aktivitete trajnuese me qëllim të testimit dhe përmirësimit të kapaciteteve operative, gatishmërisë, efikasitetit dhe dislokimit të trupave të shteteve pjesëmarrëse. MM-i i Maqedonisë ka ofruar fushën stërvitore në Krivolak si qendër për trajnimin regjional për Forcat e Armatosura të shteteve të Kartës së Adriatikut<sup>182</sup>.

### *Udhëheqja politike e reformës së mbrojtjes*

Plotësimi i kriterëve të NATO-së dhe standardeve të aftësive mbrojtëse mund të jetë një shtytje për të dyja, reformën ushtarake dhe transformimin demokratik, por ajo po ashtu obligon Maqedoninë të përvetësojë kulturën politike dhe marrëdhëniet civile-ushtarake të shteteve anëtare të NATO-së. Kjo marrëdhënie është në proces të zhvillimit me përparimin e shfaqur në baza jo të rregullta.

Kuvendi i Maqedonisë mbikëqyrë qeverinë në çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë dhe miraton strategjitë kombëtare për siguri dhe mbrojtje<sup>183</sup>. Komisioni parlamentar për mbrojtje dhe siguri është përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. Përveç kësaj, aktivitetet e inteligjencës dhe sigurisë duhet të raportohen tek komisioni<sup>184</sup>. Pasi që tani buxheti i mbrojtjes paraqitet të komisioni në formën përfundimtare për miratim apo mos miratim, komisioni kohëve të fundit ka mundur të ndikojë në zbatimin e buxhetit duke kërkuar raport tremujorë të shpenzimeve. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që komisioni ka një numër të madh të kompetencave dhe çështjeve për të mbikëqyrur, disa ekspert maqedonas dyshojnë në aftësitë e komisionit që të kryej funksionet e tij me efikasitet. Teorikisht, kuvendi ka ndikim mbi buxhetin e mbrojtjes, por jo domosdoshmërisht kjo ndodh në praktikë. Buxheti i mbrojtjes vjen në kuvend në fazën përfundimtare të tij pa u shqyrtuar apo diskutuar<sup>185</sup>. Një situatë e tillë është dëshmi se kuvendi ka mbetur në margjinat e zhvillimit politik, duke luajtur rolin e “makines votuese” për vendimet marra nga kryetari dhe kryeministri<sup>186</sup>.

Këndvështrimi i ekspertëve lokal për rolin kritik të kuvendit maqedonas nuk ndryshon shumë. Disa janë të mendimit se situata me të vërtetë nuk është përmirësuar që nga viti 2002- 2003 dhe kuvendi i Maqedonisë kurrë nuk ka qenë më shumë “makinë votuese” se nën këtë qeveri<sup>187</sup>. Të tjerët shohin një përparim të vogël, veçanërisht në lidhje me MM-së për çështjet buxhetore; por

në përgjithësi ndikimi i kuvendit në qeveri dhe çështjet buxhetore mbetet i vogël. Kjo tregon dallimin në mes të dispozitave kushtetuese dhe rolit të kufizuar që në të vërtetë ka kuvendi në Maqedoni<sup>188</sup>.

Një institucion tjetër i rëndësishëm i kontrollit civil të ushtrisë, është kryetari i cili zgjidhet drejtpërsëdrejti nga qytetarët dhe si i tillë nuk ka përgjegjësi ndaj kuvendit. Për më tepër, sa i përket degës legislative, kryetari ka të drejtën e vetos në miratimin e ligjeve. Ai është komandant suprem i FAM-it dhe miraton dokumentet kryesore strategjike, siç janë Strategjia e Mbrojtjes dhe Plani i Mbrojtjes. Pjesa kryesore e përgjegjësive të kryetarit ushtrohen përmes dekreteve. Funkcionalizimi i tyre bëhet përmes MM-së dhe shtabit të përgjithshëm. Sipas kushtetutës, kryetari është drejtues i Këshillit Kombëtar për Siguri (KKS)<sup>189</sup>. KKS-ja mendohet të marrë në konsiderim çështjet që janë të rëndësishme për sigurinë kombëtare dhe të jap këshilla për kryetarin dhe rekomandime për kryeministrin. Sipas disave, këshilli më shumë ka qenë “institucion nën hije” duke funksionuar në mënyrë jo-transparente<sup>190</sup>. Kompetencat e qeverisë në çështjet e mbrojtjes i janë lënë MM-së; por ekzistojnë mangësi të qartësisë ligjore sa i përket pozitës dhe përgjegjësive të sakta të ministrit të mbrojtjes. Çështja me më rëndësi është nëse ministri është përgjegjës para kryeministrit apo drejtpërsëdrejti para kryetarit. Edhe pse paqartësitë e ligjit të mbrojtjes përcaktojnë një lidhje më të ngushtë me kryetarin kjo nuk ndodhë në praktikë. Vendimet e KKS-së mund të bllokohen nga qeveria dhe kryetari mund të bllokoj iniciativat e qeverisë në sferën e sigurisë dhe mbrojtjes<sup>191</sup>.

Ndarja e pushtetit në ekzekutiv nuk është e përcaktuar qartë me kushtetutë dhe varet nga këmbëngulësia e zyrtarëve sesa kryetari apo kryeministri. Sipas kushtetutës, ministri i mbrojtjes është përgjegjës vetëm para qeverisë. Po ashtu edhe llogaridhënia e shtabit të përgjithshëm dhe shefit të shtabit janë të paqarta. Kryetari emëron dhe shkarkon shefin e shtabit pa miratimin nga kuvendi, por ligji përcakton se shefi i shtabit është llogaridhënës te kryetari edhe ministri i mbrojtjes<sup>192</sup>. Mungesa e koordinimit në mes të kryetarit, kryeministrit dhe ministrit të mbrojtjes gjatë konfliktit etnik të vitit 2001 ishte shqetësuese, pasi që urdhra kontradiktore vinin nga të tria institucionet<sup>193</sup>. Ngjashëm me Shqipërinë, marrëdhënie kaq të komplikuara në mes të kryetarit dhe kryeministrit janë konsideruar nga NATO-ja si probleme tipike për rajonin<sup>194</sup>.



Përveç kësaj, ekziston një mungesë e përgjithshme në bashkëpunimin në mes të degës së ekzekutivit dhe legjislativit, si pasojë e pjesshme e trashëgimisë socialiste për rolin e ekzekutivit<sup>195</sup>. Faktori ndëretnik, i cili duhet të merret parasysh në procesin e vendimmarrjes, nuk e bën bashkëpunimin më të thjeshtë. Tri partitë politike të komunitetit shqiptarë janë të përfaqësuara në kuvend dhe njëra prej të cilave është gjithnjë në koalicionin qeverisës<sup>196</sup>.

#### *OJQ-të dhe Institutet kërkimore të përfshira*

Janë me qindra OJQ në Maqedoni, sidoqoftë, vetëm disa prej tyre janë të përfshira seriozisht në politikat e sigurisë dhe mbrojtjes. Ekspertiza është e kufizuar në aktorë lokal dhe ndërkombëtar apo në kompanitë private këshilluese siç janë NATO, DCAF, Pakti i Stabilitetit ose BAH<sup>197</sup>. Media ushtarake në Maqedoni mbulon çështjet ushtarake që kryesisht trajtojnë tema që mëtojnë të krijojnë përkrahje publike për anëtarësim në NATO<sup>198</sup>. Sidoqoftë, mbulimi medial mund të jetë qenësor, por si në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, gazetarët në Maqedoni akuzohen si të “pa kualifikuar të mbulojnë çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes”<sup>199</sup>. Gazetarët po ashtu shpesh fajësohen për paaftësinë e tyre për t’i bërë çështjet e sigurisë të kuptueshme për njerëzit e zakonshëm<sup>200</sup>. Në përgjithësi, çështjet ushtarake nuk janë gjerësisht të diskutuara në shoqëri dhe gazetarët pretendojnë që informatat e siguruar nga konferencat zyrtare për shtyp të MM-së nuk janë të mjaftueshme<sup>201</sup>.

Megjithatë, perceptimi i tanishëm i personave ushtarak në Maqedoni radhitet nga ajo neutrale në pozitive në përgjithësi. FAM ende po e shijon perceptimin pozitiv të Armatës Popullore Jugosllave (APJ). Ushtria dhe profesioni ushtarak kanë pasur një pozitë të respektuar në ish-Jugosllavi. Kjo është bazuar haptas në përvojën e përbashkët të republikave gjatë Luftës së Parë Botërore dhe kanë ndarë përvoja partizane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Sidoqoftë, ky perceptim ndërpritet në mes të vijave etnike, por mendimi i të rinjve maqedonas është i pa përkushtuar. Përgjithësisht, të jesh oficer ushtarak në një shtet me papunësi rreth 37,5%, perceptohet si punë e sigurt me banim dhe pushim të arsyeshëm në zonat ushtarake argëtuese. Po ashtu është burim i të ardhurave të qëndrueshme (Shih shtojcën, figura 2). Kështu ka shumë pak shembuj të oficerëve që e braktisin vullnetarisht shërbimin aktiv.

Ngjashëm me Shqipërinë, MM-së së Maqedonisë i duhet një strategji e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun për reformën e mbrojtjes. Është e rëndësishme të tejkalohet

përqendrimi vetëm në anëtarësimin në NATO, edhe pse nuk ka alternativë për të ardhmen euroatlantike. MM-ja e Maqedonisë ka një numër të tregimeve të suksesshme për të treguar dhe sfida që duhet t'i sqarohen publikut, sidoqoftë, sado e ndjeshme që mund të jetë kjo (për shembull, çështja e integritetit të minoriteteve në FAM). Kështu që një fushatë e re informuese e MM-së duhet të synoj jo vetëm që të fitoj mbështetjen e publikut, por po ashtu të shërbej si burim i informimit në sqarimin e asaj se çfarë është reforma, pse duhet bërë atë, çfarë përfitimesh mund t'i bie Maqedonisë në veçanti, bashkëpunimit rajonal dhe stabilitetit në tërësi. Si në rastin e Shqipërisë, media ushtarake është një mjet që pothuajse ekziston, sidoqoftë, edhe ajo ka nevojë për reformim.

Themelimi i një sistemi përkatës menaxhues të mbrojtjes dhe një burokracie ushtarake të mirëfilltë të ngjashëm me ato të shteteve tjera të NATO-së, mbetet një sfidë për Maqedoninë. Këto aspekte duhet të tërheqin vëmendje më të madhe nga, dhe mbështetje nga akterët ndërkombëtar të cilët e drejtojnë procesin e reformimit. Sidoqoftë, institucionet kombëtare duhet të jenë më të kujdesshme nga sfida e ardhshme e bërjes vetë të ristrukturimit të mbrojtjes dhe të pyesin veten, si mund të përforcohet ajo në Maqedoni, ku organizatat ndërkombëtare kanë luajtur rolin kryesor? Pasojat negative të reformës së mbrojtjes, siç është mbyllja e bazave dhe humbja e vendit të punës, po ashtu janë çështje të ndjeshme në Maqedoni.

Nga kjo pikëpamje, institucioneve përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes u duhet një strategji e re për marrëdhënie me publikun dhe komunikim, për të shpjeguar dhe promovuar më mirë përfitimet lokale nga procesi i reformës së mbrojtjes.

### ***Transformimi i mbrojtjes***

#### **Transformimi në Maqedoni: pensionet ushtarake dhe përgjegjësia individuale**

MM-ja zbaton masa të ndryshme për zvogëlim në numër<sup>202</sup> të FAM-it, duke përfshirë këtu edhe përfundimin e kontratave të punës, kontraktimin e funksioneve jo të rëndësishme dhe pensionimet e hershme. Prej vitit 2003 deri në mars të vitit 2005, reduktimi i përgjithshëm i personelit ushtarak arriti në 1.971. Në mesin e tyre, 222 ishin të punësuar në MM, përderisa 1.749 janë pushuar nga FAM-i<sup>203</sup>.

Figura 12: Reduktimi i personeli ushtarak (2003–03.2005)

	Pensionime	Me kërkesë personale	Masa disiplinore	Vdekje	Të dështuar në arritjen e kërkesave	Transferimi i kontraktuar	Totali
Oficerë	167	16	1	4	0	152	340
Nënoficerë	89	14	6	1	0	367	477
Ushtarë profesional	0	113	37	2	167	219	538
Civilë	278	23	4	4	0	85	394
Totali	534	166	48	11	167	823	1749

Burimi: MM-ja maqedonase, mars 2005

Pra, pensionimi i hershëm do të jetë zgjidhja kryesore për zbatimin e zvogëlimit të planifikuar. Numri total i ushtarëve që kërkojnë pensionim të parakohshëm do të arrij 892 deri më 2007 (255 oficerë, 172 nënoficerë dhe 465 civilë).

Figura 13: Personeli i pensionuar para kohe

Viti	Oficerë	Nënoficerë	Civilë	Totali
2003	107	54	195	356
2004	31	24	67	122
2005	48	31	50	129
2006	35	33	77	145
2007	34	30	76	140
Total	255	172	465	892

Burimi: MM-ja e maqedonase, mars 2005

Një masë tjetër që do të mundësoj zvogëlimin në numër, është transferimi i disa funksioneve nga MM-ja në agjencitë tjera shtetërore. Kah fundi i vitit 2005, përafërsisht 187 shërbyes do të jenë transferuar nga MM-ja në drejtorinë e mbrojtjes dhe shpëtimit, përderisa 270 njerëz do të zhvendosen nga MM-ja në qendrën për menaxhimin e krizave. Rreth 200 civilë tjerë që merren me shërbime të prodhimit përbrenda FAM-it (siç është furnizimi me ushqim dhe mirëmbajtja) do të kalojnë në kompanitë dhe agjencitë tjera shtetërore<sup>204</sup>. 823 oficer dhe nënoficerë kanë

përfunduar shërbimin në FAM në vitin 2004 dhe janë transferuar në Policinë Shtetërore Kufitare të Ministrisë së Brendshme. Kah fundi i 2005, 660 persona të tjerë kaluan nga FAM-i në Policinë Shtetërore Kufitare<sup>205</sup>. Kurset ri-trajnuese janë organizuar në FAM në vitin 2004 dhe 2005 vetëm për personelin e FAM-it që do të transferohen në Policinë Shtetërore Kufitare (MB)<sup>206</sup>

Deri tash së voni, nuk ka pasur masa tjera për demobilizimin e oficerëve dhe nënoficerëve në aspektin përkrahës për ri-trajnimin dhe ri-integrimin ndaras nga përfitimet e përgjithshme pensionale. Sidoqoftë, jo të gjithë ushtarakët e pensionuar të FAM-it kanë të drejtën për pension ushtarak<sup>207</sup>.

### *Pensionet dhe Përfitimet*

Me ligjin e Mbrojtjes dhe Shërbimit Ushtarak, për t'u kualifikuar për "pension të pleqërisë", anëtari i shërbimit duhet të jetë 64 vjeçar (62 për femra). Pensioni i pleqërisë është përcaktuar sipas viteve të shërbimit. Akti nën-ligjor qeveritar u garanton policëve të pensionuar dhe ish-oficerëve 30% shtesë të shumës së pensionit normal<sup>208</sup>. Kah fundi i vitit 2002, ishin 275.446 përfitues nga pensioni dhe sigurimi për paaftësi. Në atë kohë, numri i përgjithshëm i pensionistëve në Maqedoni ishte 249.421, prej të cilëve vetëm 3.083 ishin pensionist ushtarak<sup>209</sup>. Për të marrë pension ushtarak, personeli ushtarak duhet të kalojë 35 vjet në forcat e armatosura (30 vjet për ushtarët femra). "Ligji mbi Pensionimin e Hershëm" (i vlefshëm për periudhën 2003-2007) rregullon përfitimet e ish-ushtarëve të cilët janë të detyruar të largohen nga ushtria për shkak zvogëlimit në numër. Oficerët ushtarak të cilët në këtë pikë kanë marrë pensionim të parakohshëm janë duke marrë kompensim për deri në pesë vjet punë. Kjo është masa e vetme e Maqedonisë në përkrahjen e ri-integrimit të personelit të demobilizuar.

Kuvendi tash së voni i ka miratuar amendamentet e kërkuara nga MM-ja për ligjin për shërbimin ushtarak dhe ligjin e mbrojtjes në mënyrë që t'i sigurojë ministrit autoritet të shkarkojë anëtarët e shërbimit duke u bazuar në tepricë teknologjike, dhe po ashtu në përcaktimin e moshës së pensionimit të ushtarakëve në moshën 55 vjeçare me 25 vite shërbim. Ky amendament ka për qëllim që të vendos pensionimin dhe vitet e shërbimit në harmoni me konceptin e zhvillimit të karrierës së oficerëve, koncept ky i miratuar nga ministri i mbrojtjes. Parashikimi fillestar për pensionimin e anëtarëve të shërbimit ishte 607 persona deri në fund të vitit 2005. Në mesin e këtij numri 186 janë oficerë, 109 nënoficerë dhe 312 nëpunës civil. Fondet e planifikuara për

pensionim të hershëm arrijnë në një shumë prej 23.490.138 Euro (për periudhën 2003-2007) dhe këto fonde janë dhënë nga buxheti i shtetit<sup>210</sup>. Sipas rregullores së ashtuquajtur 55/25, shumë individë të rëndësishëm do të kenë të drejtë të largohen nga shërbimi. Kjo ka potencial të krijoj një “ikje të trurit” të menjëhershëm dhe të pengoj ashpër operacionet dhe procesin e transformimit. Si rezultat, aktualisht MM-ja po e zhvillon një sistem selektiv të mbajtjes për të lejuar individët kryesorë që të mbesin në shërbim edhe pas 25 vite shërbimi.

Koncepti fillestar për të mbështetur anëtarët e shërbimit të detyruar të largohen nga FAM-i si pjesë e procesit të zvogëlimit në numër, bën thirrje që t’u ofrohet atyre kompensim i vogël bazuar në gradat ushtarake të tyre, rrogën dhe kohën e kaluar në FAM. (Ata që nuk kanë kaluar 35 vite në FAM nuk kanë të drejtë për pensionim të parakohshëm apo në ndonjë përfitim tjetër pensional). Kompensimi i tyre nuk mund të jetë më i lartë se rroga për tetë muaj. Për shembull, një komandant 35 vjeçar që ka shërbyer në FAM për 17 vite dhe ka një rrogë mujore 300 Euro, nuk do të merrte më shumë se pesë rroga si kompensim (1.500 Euro). Nëse një ushtarak lëshon FAM-in vullnetarisht, pa shërbyer më së paku pesë vjet, për të nuk ka kompensim. Një grup i ushtarakëve të pensionuar para kohe pa i bërë 35 vjet shërbim—numri i të cilëve nuk dihet—nuk është i përfshirë në asnjë nga statistikat e MM-së. Këta individë nuk përfitojnë nga “ligji për pensionim të hershëm”.

Përveç këtyre pa përfitime nga pensionimi, është edhe një grup kritik që ka nevojë për vëmendje: ish guerilët e të ashtuquajturës Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Këta individë morën pjesë në konfliktin etnik të vitit 2001 dhe nuk ishin të inkuadruar në “ligjin për kompensim”, pasi që ata ende konsiderohen armiq të shtetit, pavarësisht asaj që atyre nuk u është dhënë amnisti e përgjithshme. Familjet e luftëtarëve të UÇK-së-së të vrarë në aksion nuk janë përfshirë në kompensim, përderisa të gjithë maqedonasit etnik janë përfshirë në këtë përkrahje<sup>211</sup>. Debatë publik mbi këtë çështje ka provokuar përgjigje negative nga komuniteti shqiptar. Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) po ashtu ka deklaruar se nëse “mbrojtësit e atdheut” maqedonas shpërblehen nga shteti për shërbimin e tyre, atëherë çështja e kompensimit social për familjet e luftëtarëve të UÇK-së, të vrarë apo të plagosur në aksione duhet të konsiderohet për kompensim<sup>212</sup>.

Vetëm disa pjesëmarrës të luftës civile të vitit 2001 nga ana e shqiptarëve janë punësuar në FAM dhe administratën civile<sup>213</sup>. Për dallim, shumë politikan shqiptarë që kanë marrë pjesë në konfliktin etnik të vitit 2001 janë integruar mirë në jetën qytetare. Janë tri parti politike shqiptare të përfaqësuara në kuvend. BDI-ja e njohur si krah politik i AKSH-së<sup>214</sup> është pjesë e koalicionit udhëheqës. Anëtari i saj, Talat Xhaferi, një ish-luftëtar i UÇK-së në Kosovë, tani është duke pretenduar pozitën e zëvendës ministrit të Mbrojtjes. Shefi i shtabit të ish UÇK-së, Gjen.Gëzim Ostreni, është nënkryetar i kuvendit maqedonas. Sidoqoftë, disa ekspertë e shohin me mjaft cinizëm shndërrimin e luftëtareve me përvojë në politikanë civil. Në të vërtetë, vetëm luftëtarët me përvojë arritën me sukses të shndërrohen në politikanë civil të kuvendit, kështu ata u “ri-integruan” në jetën qytetare në mënyrën më të mirë dhe më fitimprurëse.

#### *Risistemimi maqedonas: përgjegjësia individuale dhe pjesëmarrja*

Këndvështrimi i hershëm i MM-së ishte i hapur në lidhje me çështjen e rikualifikimit të personelit ushtarak në largim e sipër—ajo konsiderohej e *padobishme* duke marrë parasysh situatën ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë. Sipas disa të dhënave të zyrës maqedonase të regjistrimit, shkalla e papunësisë në Maqedoni është 37,5 %, që përfshin të gjitha profilet arsimore<sup>215</sup>. Si pasojë, Maqedonia deri vonë nuk ka pasur një program për risistemim. Ndonëse dy programet për integrimin e pakicave etnike kanë qenë të prezantuara gabimisht nga MM-ja e Maqedonisë përmes punëtorive të ndryshme, si programe për ri-integrim, këto programe faktikisht nuk kanë të bëjnë me risistemimin e personelit të demobilizuar.

Në fillim të viti 2006, MM-ja dhe ambasada norvegjeze në Shkup, nënshkruan kontratën për projektin LEPEZA (*spektra* në maqedonisht) për risistemim<sup>216</sup>. Qëllimi i projektit është të gjendet zgjidhja për karrierën e oficerëve tepricë dhe t’i pajis pjesëmarrësit me shkathtësi dhe njohuri në mënyrë që t’i bëj ata më konkurrues në tregun e punës<sup>217</sup>. Projekti i risistemimit do të ketë kapacitetin të pranojë 700 njerëz në vit. Pas kompletimit të periudhës transformuese të FAM-it, hyrjet vjetore dhe në të njëjtën kohë daljet e personelit ushtarak nga FAM-i, në total do të jenë rreth 700 njerëz për vit (Shih Aneksin, Figura 3). LEPEZA është projektuar për të ndihmuar oficerët ushtarak në largim, me këshillime tranzicionale dhe mundësi arsimore që do të përmirësojnë kualifikimin dhe nivelin konkurrues në tregun civil të punës. Ky objektivi është planifikuar të arrihet me një qasje e cila do të përbëhet nga dy faza.

Faza 1 është realizuar plotësisht me mjetet e MM-së dhe përbëhet nga këshillimi dhe asistenca tranzicionale në shkrimin e CV-së, mësimin e taktikave në intervistë, aftësitë e testimin, etj. Hapi i parë i projektit, i cili mund të përfshijë edhe mundësinë për të marrë kredi të vogla, është për të hapur "Qendrën Tranzicionale" në Shkup<sup>218</sup>. Qendra do të trajnoj personel për t'i dal në ndihmë personelit tepriçë në gjetjen e karrierës civile. Faza 2, e cila është ende në fazën e planifikimit, është komponentë edukative dhe mund të përmbajë kurse gjuhe, programe akademike dhe trajnime profesionale. Përveç Shkupit, ministria e mbrojtjes planifikon t'i hap edhe dy qendra regjionale në Stip dhe Kërçovë.

Qeveria e Norvegjisë ka dhuruar 200.000 euro për pajisjet e projektit të risistemimit. Anglia, Suedia dhe Danimarka po ashtu janë të përkushtuara për të ofruar ndihmë financiare. Për shembull, një fushatë për informimin publik në lidhje me programin maqedonas për risistemim është planifikuar dhe do të financohet në nivelin fillestar me 25.000 euro nga Britania e Madhe. Përqendrimi primar i fushatës do të jetë paraqitja e informacioneve për risistemimin para publikut maqedonas. Përprojekjet e brendshme për komunikimin do të realizohen përmes publikimeve të brendshme të MM-së dhe një serie të brifingjeve komanduese të informimit, të prezantuara të gjitha njësisive. Kjo fushatë pritet që të realizohet gjatë vitit 2006. LEPEZA planifikohet të vazhdojë përtej periudhës transformuese dhe është njohur si një element kritik në sistemin e ri profesional ushtarak. Pasi që të gjithë oficerët janë në një sistem kontraktues, do të ketë dalje përhershme të personelit nga shërbimi dhe LEPEZA do të ndihmojë këta individë në ri-integrimin e tyre në jetën civile. Planifikohet që pas vitit 2007 LEPEZA të financohet nga burimet kombëtare.

Perceptimi i MM-së maqedonase është se mbështetja për risistemim dhe ri-integrim është mirënjohje për mbarim të shërbimit ushtarak në mënyrë besnike. Sidoqoftë, MM-ja po ashtu ka nënvizuar përgjegjësinë individuale të pjesëmarrësve drejt këtij qëllimi, pasi që ata shpesh janë të pakualifikuar për jetë civile dhe u mungojnë disa kërkesa të domosdoshme. Për shembull, gjatë arsimimit të tyre në akademinë ushtarake, oficerët marrin diplomë universitare e cila nuk është e barasvlershme me një diplomë të marrë në sektorin edukativ civil. Një faktor tjetër që vështirëson ri-integrimin e personelit ushtarak është shkalla e lartë e papunësisë në Maqedoni. Ky faktor vetvetiu dëshmon mangësinë kritike të mundësive për punë në vend, gjë që e rëndon procesin e ri-integrimit në përgjithësi.

Edhe pse programi maqedonas për risistemim është duke marrë formë vetëm nga përqendrimi aktual në orientimet post-ushtarake, kjo mund të vlerësohet si modeste por një kontribut i pritur gjatë pas shumë presioneve të instituteve kërkimore ndërkombëtare duke ndihmuar një varg takimesh dhe grupe punuese mbi çështjen e ri-integrimit.

### **Transformimi i bazave: shitja dhe investimet nga jashtë**

Bazuar në një strategji për mbrojtje territoriale, Maqedonia ka trashëguar strukturën jugosllave të mbrojtjes<sup>219</sup>. FAM-i nuk posedon baza të mëdha ushtarake kështu që transformimi i pronës përqendrohet në objektet të madhësive të vogla. Në përgjithësi janë 112 objekte ushtarake të cilat duhet të shndërrohen apo të transferohen<sup>220</sup>. E tërë hapësira tokësore me infrastrukturë ushtarake është 28.562 hektarë. FAM-i duhet të heq dorë nga pronat të cila nuk kanë funksion direkt ushtarak, disa nga të cilat përfshijnë kazermat ushtarake, objektet komanduese, depot ushtarake, fushat stërvitore, rezidenca ushtarake, kantinat ushtarake, strehimoret ushtarake, pishinat dhe hotelet ushtarake.

Figura 14: Transformimi i objekteve

Patundshmëria	Numri i tanishëm	Të identifikuar për nevoja të MM-së	Për transformim
Kazermat	26	13	13
Objektet komanduese	9	5	4
Objektet për kujdes shëndetësor/mirëmbajtje	4	4	
Depo	43	24	19
Fusha stërvitore	16	13	3
Rezidenca ushtarake	12	3	9
Kantina ushtarake	19		19
Objektet e shërbimeve të kantinës	4		4
Pishinat	3	1	2



Strehimoret ushtarake	3	3	
Hotelet ushtarake	1	1	
Ekonomitë ushtarake	3		3
Reforma e tokës (parcela)	37	11	26
Ndërtesat biznesore	21	1	20
Sipërfaqet në m <sup>2</sup>	3458097	1783902	1674195

Burimi: MM-ja e Maqedonisë, mars 2005

Një plan për transformimin e pronës ushtarake është punuar nga MM-ja maqedonase në bashkëpunim me agjencitë tjera shtetërore dhe ka për qëllim të kompletoj transformimin dhe shitjen e vendqëndrimeve ushtarake deri më 2007. Transformimi i vendqëndrimeve ushtarake është rregulluar nga “Ligji mbi posedimin e patundshmërisë”, kështu që departamenti për patundshmëri i MM-së po e koordinon dhe po e vëzhgon zbatimin e këtij transferimi<sup>221</sup>. Sidoqoftë, MM-ja nuk është vendimmarrës ekskluziv në procesin e transformimit dhe është e obliguar të bashkëpunoj me agjencitë tjera shtetërore. Për shembull, Agjencia e Privatizimit është përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore, përderisa “Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Banimin dhe Ndërtesave të Biznesit” është përgjegjëse për përcaktimin e vlerës së pronës. Përfundimisht, “Autoriteti Shtetërorë për Punë Gjeodezike” është i përfshirë në regjistrimin e pronës<sup>222</sup>. Koordinimi në mes të këtyre njësive në lidhje me procedurën e privatizimit të pronës ushtarake është më se i paqartë.

Plani kombëtar për transformimin e pronës parasheh mënyra të ndryshme që mund të përdoren për transformimin e pronës ushtarake duke përfshirë edhe dhënien me qira apo shitjen, shkëmbimin për apartamente, koncesionin, transferimin e të drejtës për përdorim të dhe ri-zhvillim të pronës nga administratat lokale<sup>223</sup>.

MM-ja pohon që procesi i privatizimit të pronës ushtarake është një proces në vazhdim. Deri në prill të vitit 2005, 57 objekte ishin identifikuar nga ana e MM-së për transformim.

Figura 15: objektet e identifikuara nga ana e MM-së për transformim

Patundshmëria	Numri	Trajtimi
Rezidenca ushtarake	3	Shitur
	3	Koncesion
Depo	1	Shitur
	7	Me qira
Kantina ushtarake	17	Koncesion
Ekonomi ushtarake	2	Koncesion
Objektet e shërbimeve të kantinës	8	Koncesion
Kazerma	6	Transferim të Ministria e Punëve të Brendshme
Pikat kufitare ushtarake	10	Transferim të Ministria e Punëve të Brendshme
Totali	57	

Burimi: MM-ja e Maqedonisë, prill 2005

Në pranverë të vitit 2005, vendqëndrimet e shumta janë transferuar në mënyra të ndryshme, duke përfshirë<sup>224</sup>: 6 kazerma ushtarake në Shkup, Kriva, Koçan, Delqevë, Borovë, Strumicë; 6 shtëpi ushtarake rezidenca ushtarake në Tetovë, Velesh, Kërçovë, Manastir, Kriva, Stip; 17 kantina ushtarake (5000m<sup>2</sup>) në Kumanovë, Shkup, Tetovë, Petrovets, Dibër, Kërçovë, Velesh, Stip, Strumicë, Krivolak, Prilep, Ohër, Manastir; 2 ekonomi ushtarake<sup>225</sup> në Krivolak dhe Petrovets.

Brenda kornizës punuese të bashkëpunimit ushtarak, SHBA-ja po përgatitet të investoj në infrastrukturën e fushës stërvitore ushtarake në Krivolak<sup>226</sup>. MM-ja nuk pret ndonjë financim të jashtëm për transformim të bazave dhe po ashtu nuk ka aplikuar dhe as nuk ka provuar të josh ndonjë financim të jashtëm për këtë qëllim<sup>227</sup>. Duhet përmendur se nuk ka ndonjë pengesë ligjore për të huajt që të blejnë pronë në Maqedoni<sup>228</sup>. Sidoqoftë, ekziston një shpresë përbrenda MM-së, se transformimi apo transferimi i bazave ushtarake do të gjeneronte fonde dhe do të sillte përfitime shoqërore dhe financiare. Fondet e siguruar nga shitja e patundshmërisë dhe sipërfaqeve të tjera janë planifikuar të përdoren për përfitime të personelit ushtarak aktiv, veçanërisht duke u siguruar atyre apartamente për banim<sup>229</sup>. Kjo qasje nuk është e pazakonshme në një shoqëri ku ish-oficerët kanë të drejtën për strehim.

Në këmbim për pronën e privatizuar ushtarake, MM-ja tani më ka siguruar 22 apartamente për personelin ushtarak (Shkup-3, Koçani- 4, Kumanovë- 13, Veleshtë- 2). Në mesin e këtyre objekteve ishin: objekte biznesore “Kumanovo”, (vlera 330.658,13 Euro); objekte biznesore “11 Oktomvri”- Kumanovë, (119.605,89 euro); hapësira themelore aksesore Koçani, (vlera 76.213,60 euro); grupi i depove “Gorce Petrov” (objekt i MM-së)– (178.603,39 Euro); grupi i depove “Biqanovce” Kumanovë, (69.956,00 euro); strehimorja për qëllim të dyfishtë (rezidencë ushtarake)—Velesh, (71.764, 00 euro)<sup>230</sup>.

### *Organizimi institucional*

Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Banimet dhe Ndërtesave të Biznesit është përgjegjëse për përcaktimin e vlerës së pronës. Sidoqoftë, janë disa shqetësime madhore sa i përket transparencës së këtij procesi dhe të privatizimit të pronës ushtarake në përgjithësi. Për shembull, procesi i privatizimit të “Rezidenca ushtarake” në Veleshtë ishte hulumtuar nga mediet maqedonase dhe ishte zbuluar korrupsion dhe klientelizëm. Shumë gazetarë dhe anëtarë të partive opozitare ishin të bindur se çmimi për shkëmbim të rezidencës ushtarake në Veleshtë ishte artificialisht i ulët. Të ardhurat prej 71.764 euro mjaftuan vetëm për të marrë dy apartamente në shkëmbim për ndërtesën. Një akuzë tjetër në lidhje me “rastin e transformimit” ishte bazuar në lidhjet familjare ndërmjet pronarit të ri të ndërtesës dhe kryetarit të partisë qeverisëse lokale<sup>231</sup>. Pavarësisht nga akuzat e vazhdueshme, MM-ja insiston që procesi i transformimit dhe privatizimit është duke u bërë në pajtim me rregulloret ligjore bazuar në “ligjin mbi posedimin e patundshmërisë”. Përveç kësaj, një raport mbi progresin e transformimit të pronës, fondeve të gjeneruara nga ky transformim dhe investimet pasuese duhet të bëhet nga MM-ja për kuvendin një herë në vit me qëllim që të promovohet transparencë më e madhe<sup>232</sup>.

MM-ja nuk ofron informata në lidhje me problemet e ambientit në bazat ushtarake, duke theksuar se vendqëndrimet ushtarake plotësojnë kërkesat “ekologjike, gjeografike, hidrologjike, klimatike të përshkruara me legjislacion”<sup>233</sup>. Sidoqoftë, një përpjekje e përbashkët ndërmjet MM-së dhe Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Fizik do të siguroj që do të ndërmerren masa për mbrojtjen e ambientit<sup>234</sup>. Sa i përket ri-integrimit, MM-ja nuk mund të ofrojë shembuj pozitiv të kombinimit të transformimit të bazave me ri-integrimin dhe rikualifikimin e personelit tepriçë ushtarak<sup>235</sup>. Që nga viti 2003, të gjithë tenderët për koncesion të objekteve ushtarake siç janë kantinat dhe fermat janë subjekt i kushtëzimit që përdoruesit e rinj të mbajnë personelin e

mëparshëm në punë për së paku 10 vite<sup>236</sup>. Fatkeqësisht, kjo rregullore është mjaft zbrapse për pronarët e rinj.

Krahasuar me Shqipërinë, transformimi i vendqëndrimeve ushtarake në Maqedoni është proces relativisht transparent, me disa arritje të prezantuara në seminare dhe grupe punuese të ndryshme. Sidoqoftë, ngjashëm me Shqipërinë, MM-ja është institucion përgjegjës për zbatimin dhe kontrollimin e privatizimit të pronës ushtarake. Si pasojë, shitja apo dhënia me qira e pronës së tillë kryesisht përdoret si mjet i gjenerimit të të ardhurave për MM-në. Një agjenci tjetër shtetërore, akter jo qeveritar apo OJQ mund të jetë një institucion alternativ për mbikëqyrje të këtij procesi, që do të ndihmonte në tejkalimin e interesave të MM-së dhe të zbut akuzat e vazhdueshme për anim dhe korrupsion në këtë proces.

### ***Përfundimet***

Me miratimin e dokumenteve strategjike, kornizës ligjore dhe me zvogëlimin i cili tani më është në fazën përfundimtare, faza e parë e reformimit të mbrojtjes në Maqedoni është pothuajse e përfunduar. Rishikimi strategjisë mbrojtëse (RSM) pasqyron qëllimet e procesit të reformimit; sidoqoftë, edhe pse korniza ligjore dhe strategjike janë krijuar, kjo reformë në rend të parë udhëhiqet nga akterë të jashtëm, përkatësisht mekanizmi MAP-it. Si i tillë ai është më shumë projekt ndërkombëtarë sesa kombëtarë.

Gjerë më tani standardet e NATO-se kanë ndikuar pozitivisht në sistemin e menaxhimit të mbrojtjes kombëtare, kanë korrigjuar përfaqësimin e shpërpjesëtuara përbrenda radhitjes së korpusit të oficerëve dhe ka nxitur profesionalizëm në FAM. Përfshirja e pakicave kombëtare përbrenda këtyre gradimeve është perceptuar si element natyral i kulturës ushtarake të NATO-së. Pavarësisht nga krejt kjo, është vështirë të vlerësohet dhe të konstatohet progresi në fushën e transformimit dhe reformimit, përderisa në të shumtën e rasteve ngritet çështja e qëndrueshmërisë. A janë të aftë dhe në gjendje institucionet e mbrojtjes që janë transformuar të qëndrojnë vetë, të funksionojnë siç duhet, pa këshillimin dhe mbështetjen nga jashtë?

MM-ja maqedonase është lavdëruar nga NATO-ja për zbatimin e instrumenteve të efektshme planifikuese dhe buxhetore. Fatkeqësisht, sipas disa burimeve të brendshme, roli koherent i institucioneve shtetërore në drejtimin e reformave të mbrojtjes mbetet vetëm në letër. Kuvendi maqedonas ka qenë në margjinat e zhvillimeve ushtarake por gjithnjë e më shumë po e merr rolin e kontrolluesit të pjekurisë së procesit demokratik. Struktura e sigurisë dhe mbrojtjes siç është KKS-ja dhe MM-ja janë perceptuar nga disa ekspert kritikues si ‘institucione nën hije’ që funksionojnë në mënyrë jo transparente, edhe pse puna e ‘ndjeshme’ e KKS-së kërkon, së paku disa procedime me dyer të mbyllura. Llogaridhënia dhe marrëdhënia e liderëve kryesorë shtetërorë në sektorin e mbrojtjes, siç janë: Ministri i Mbrojtjes, Kryeministri dhe Kryetari nuk janë definuar qartë me Kushtetutë. Roli dhe marrëdhënia e tyre varet nga këmbëngulësia dhe personaliteti i individëve zyrtarë.

Të njëjtat dobësi institucionale mund t’i shohim në përgjithësi edhe në shoqëritë civile. Mentaliteti post-socialist në Maqedoni është depërtues dhe ende ekziston nostalgjia për ditët e Jugosllavisë së bashkuar dhe formalisht të begatshme. OJQ-të në Maqedoni nuk janë seriozisht të përfshira në formulimin e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes. Mediet janë viktimë e mungesës së interesimit të përgjithshëm në çështjet e mbrojtjes dhe po ashtu mungesë së ekspertizës së tyre në këtë fushë. Disa zëra kritik por kompetent që ia kanë dalë të diskutojnë mbi reformën e mbrojtjes kombëtare megjithatë kanë shkaktuar nervozë të MM-ja<sup>237</sup>.

Është vështirë të vlerësohet efikasiteti i institucioneve kombëtare të mbrojtjes. Në fakt, shumë funksione këshilluese janë marrë nga akterë të jashtëm si NATO dhe BAH. NAT-i zë vend të përhershëm përbrenda MM-së së Maqedonisë dhe vazhdon të bëjë presion mbi qeverinë për përmbushjen e kërkesave për anëtarësimin në NATO. Megjithatë, NATO-ja nuk mundet që e vetmuar ta tejkaloj mentalitetin post-socialist të burokracisë ushtarake të Maqedonisë. Si i tillë, roli “shtytës” i reformave të mbrojtjes është marrë përsipër nga firma private amerikane BAH. Përpjekjet e tyre të kombinuara duhet të ndihmojnë FAM-in të jetë më afër standardeve të NATO-s.

Suksesi i ri-integrimit varet nga kualifikimet individuale, mosha, ri-trajnimit e orientuara kah qëllimet dhe mbi të gjitha nga kapacitete e kufizuara të ekonomive rajonale dhe tregut të punës.

Kapacitetet e kufizuara absorbuese në Maqedoni janë arsyeja kryesore pse qeveria ende nuk ka krijuar ndonjë plan për ri-trajnimin e ish-ushtarakëve. Demobilizimi dhe ri-integrimi në Maqedoni nuk ka krijuar ende role të reja shoqërore dhe rrjete apo orientime të reja profesionale për ish-ushtarakët. Më saktë ndërrimi nga profesioni ushtarak në “karrierë” post-ushtarake ka quar në kuptimin e humbjes së sigurisë personale dhe prestigjit shoqërorë, i cili ndikon në humbjen e vetëvlerësimit dhe pozitës së mashkullit si udhëheqës i familjes. Oficerët e demobilizuar janë të detyruar t’i përshtaten modelit ekzistues të shoqërisë civile dhe ekonomisë së dobët kombëtare. Deri vonë, në Maqedoni nuk ka pas masa shtesë për ish-ushtarakët në aspekt të përkrahjes për ri-trajnim apo ri-integrim përveç përfitimeve të përgjithshme pensionale. Për më tepër, jo krejt personeli i ndarë më herët ka të drejtën për përfitime pensionale.

Ri-integrimi i ish personelit ushtarak mbetet pika më e dobët e procesit reformues të mbrojtjes maqedonase. Megjithëse planet maqedonase për risistemim po e marrin konturën e një programi të përqendruar aktualisht vetëm në orientimin post-ushtarak, ai mund të vlerësohet si gjest modest por pritur gjatë pas shumë presioneve intelektuale të instituteve kërkimore ndërkombëtare të cilët kanë lehtësuar një varg takimesh dhe grupe punuese mbi çështjet e ri-integrimit.

Mungesa e një kornize ligjore konceptuale, afatgjate dhe të qëndrueshme për integrim ka pasur një ndikim negativ në përkrahjen e popullatës. Opinioni publik, reformën e mbrojtjes e lidh jo vetëm me integrimin euroatlantik por po ashtu edhe me mbylljen e vendqëndrimeve ushtarake, humbjen e vendeve të punës, rënien e standardit të jetesës dhe po ashtu me integrimin e pakicave etnike. Kjo është një fushë ku ekspertiza e OJQ-ve ndërkombëtare do të mund më së miri të përdoret. Jo vetëm që ato do të mund të ndihmonin kuvendin maqedonas në krijimin e legjislacionit përkatës, por po ashtu do të mund të ndihmonin në sigurimin e fondeve fillestare për këshillim dhe programe të ri-trajnimit për ish-ushtarakët.

Transformimi i pronës ushtarake në Maqedoni përqendrohet në objektet me madhësi të vogla, pa ndonjë vlerë të drejtpërdrejt strategjike apo ushtarake. Ekziston një plan i transformimit për vendqëndrimet ushtarake dhe një kornizë ligjore për transformimin e pronës. MM-ja është institucioni që zbaton dhe kontrollon transformimin e pronës ushtarake. Si rjedhojë, shitja apo dhënia me qira e një prone të tillë përdoret si mjet gjenerues i të ardhurave për MM-në. Një

sistem i tillë i fitimit të të hollave, mund të shpjegoj akuzat e vazhdueshme për korrupsion ndaj ministrisë. Disa nga shembujt më të suksesshëm të shndërrimit të ish-bazave ushtarake dhe integritit të tyre në strukturat e ekonomisë lokale në Evropën Lindore ka qenë transformimi i tyre në hapësira banimi, për qëllime edukative apo në qendra shoqërore dhe kulturore. Autorët e këtij studimi nuk ishin në gjendje të gjenin tregime të tilla të suksesshme në Maqedoni. Në anën tjetër, cilado agjenci jo qeveritare apo transferim i drejtpërdrejt i ish bazave ushtarake tek administratat lokale dhe rajonale do të kishte nevojë për ndihmë financiare; por edhe me udhëheqjen e procesit nga MM-ja nuk ka mjete financiare në dispozicion. Në të njëjtën kohë ekziston një pritje se transformimi apo transferimi i bazave ushtarake në fakt do të nxjerr fonde dhe do të sjell përfitime shoqërore dhe financiare për personelin ushtarak. Deri tani shitja e pronës ushtarake nga MM-ja nuk ka ndikuar në standardin jetësor të personelit aktiv ushtarak, e lëre më të personelit të pensionuar. Është fatkeqësi që qeveria maqedonase nuk ka arritur të tërheq ndonjë fond të jashtëm për transformimin e vendqëndrimeve ushtarake.

## 4. Kroacia

### *Reforma e mbrojtjes*

Në krahasim me zhvillimet në vendet post-socialiste në mes të viteve të 1990-ta, për shkak të eksperiencës së saj në luftërat ballkanike, Kroacia si republikë e ish Jugosllavisë, i ruajti strukturat e saj tradicionale ushtarake, armët e rënda dhe strategjitë e mbrojtjes territoriale<sup>238</sup>. E njëjta gjë vlen edhe për reformën ushtarake, zvogëlimin në numër dhe ristrukturimin e ngadalshëm të forcave të armatosura për detyra të reja. Vetëm pas vdekjes së Franjo Tugjmanit në vitin 1999 dhe fitores së opozitës në zgjedhjet e vitit 2000, struktura, qëllimi dhe madhësia e Forcave të Armatosura Kroate (FAK) ngadalë ishin vënë nën shqyrtim.

Për shkak të konceptit të "mbrojtjes së përgjithshme" të ish-Jugosllavisë së Titos dhe rezervës së madhe të personelit në të ashtuquajturën Forcat e Mbrojtjes Territoriale (FMT) në të gjitha republikat jugosllave, më shumë civilë të rritur morën pjesë në trajnimet ushtarake para shpërthimit të luftës. Ky trajnim provoi të jetë thelbësorë kur Kroacisë ju deshtë të formonte forcat e armatosura nga fillimi në fillim dhe gjatë luftës 1991-95. Përderisa Armata Kombëtare Jugosllave (APJ), me dominim të oficerëve serbë, mund të mbështetej në ushtarë profesionist dhe pajisjet e saj ushtarake, Kroacia kishte vetëm disa oficerë apo ushtarë të trajnuar në ish APJ, shumica e të cilëve ishin civil që kishin marrë armët për të luftuar për pavarësi. E ashtuquajtura "Luftë për Atdhe" është parë nga shumica e kroatëve si një luftë komb krijuese për shoqërinë kroate për të ndarë vendin e tyre. FAK-i ka pasur gjithmonë një pozitë të veçantë në shoqëri, gjithashtu edhe për shkak të faktit se Tugjmani i përdori forcat e armatosura që ishin mjaft të polarizuara për ta stabilizuar regjimin e tij gjysmë autoritar dhe për ta përkrahur popullaritetin e tij si "mbrojtës i vendit". Prandaj, çfarëdo reforme që prek madhësinë dhe strukturën e FAK-it është akoma shumë e ndjeshme<sup>239</sup>. Në veçanti, detyrat e reja të Pfp-së dhe ndoshta anëtarësimi në NATO në të ardhmen janë shumë të vështira që të përmbushen nga FAK-u për shkak të së kaluarës unike dhe zhvillimeve vijuese. Arsimimi ushtarak i personelit të FAK-ut është akoma shumë i ulët. Ndonëse kapacitetet operuese dhe luftuese—veçanërisht për luftë klasike territoriale—janë të zhvilluara mirë, shumë oficerëve iu mungon edukimi përkatës. Shumë 'heronj të pa shkolluar'<sup>240</sup> ishin graduar gjatë luftës në pozitat ku ata tani ndeshin presionin e oficerëve të vjetër të shkolluar të APJ-së dhe oficerëve të rinj të cilët kanë marrë trajnime të



avancuara në akademitë ushtarake perëndimore<sup>241</sup>. Në lidhje me masat për zvogëlimin në numër dhe risistemim të MM-së, këto grupe pritet të garojnë për pozita dhe përfitime.

Deri në vitin 2000, qasja drejt reformës ushtarake nuk ka ndryshuar në favor të integritimeve euroatlantike. Nga viti 2000 deri 2003, reforma ushtarake ishte subjekt i lojërave politike të partive të ndryshme pa ndryshime thelbësore në ristrukturimin dhe modernizimin e FAK-ut, kështu që ajo të mund ballafaqohet me sfidat e ardhshme të interoperabilitetit me NATO-n. Sidoqoftë, Kroacia kishte zbatuar disa aktivitete para kthimit të strukturave të gjendjes së luftës në ato të paqes, të cilat ishin përkrahur kryesisht nga kompania ushtarake private amerikane Burimet Profesionale Ushtarake Inc. (MPRI), e cila ishte e angazhuar në trajnimin e FAK-ut gjatë luftës. Disa nga shërbimet e MPRI-së kanë qenë shumë të kritikuara si për kualitet të ulët ashtu edhe për mungesë të transparencës<sup>242</sup>. Kroacia ishte rasti i parë i konsultimeve gjithëpërfshirëse mbi reformën ushtarake dhe prodhimin e dokumenteve strategjike nga MPRI-ja<sup>243</sup>. Strategjia e parë Kombëtare e Sigurisë dhe Strategjia për Mbrojtje të Kroacisë e vitit 2002, ishin vënë së bashku nxitimthi dhe pa shumë angazhim të parlamentarëve apo ekspertëve civil<sup>244</sup>. Duket se presioni i jashtëm dy vite pas pranimit të Kroacisë në programin e NATO-s për Partneritet për Paqe (PfP) ndikoi në përshpejtimin e këtij procesi. Vetëm dy muaj pas Sabor-it, kuvendi kroat i pranoi të dy strategjitë dhe vendi hyri në Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) të NATO-s në takim ministror të Këshillit të Partneritetit Euroatlantik me 15 maj 2002 në Rejkjavik. Kjo do të ishte e pa mundshme pa miratimin e dokumenteve strategjike.

Pas përmbylljes së dy cikleve të para në pajtim me parakushtet e NATO-s, Kroacia aktualisht është në ciklin e tretë të MAP-it<sup>245</sup> por kishte shpresuar në anëtarësim të plotë në NATO në Samitin e Stambollit me 2004. Jo vetëm krimet e luftës të të dyshuarit Gotovina i cili nuk pajtohej me TNPKJ, por gjithashtu edhe niveli i pa mjaftueshëm i modernizimit të FAK-ut në atë kohë, shpjen në refuzimin e anëtarësimit të plotë të Kroacisë në NATO<sup>246</sup>. Megjithatë, Kroacia ka kontribuar në operacionet e NATO-s në Afganistan që nga viti 2002 dhe ka marrë pjesë në stërvitje të ndryshme me vendet anëtare të NATO-s në vitet e fundit. Ndonëse Bashkimi Evropian shtyu bisedat për pranim për shkak të rastit Gotovina, qëllimi i integritimit në strukturat euroatlantike mbetet lartë në agjendë të partive kryesore politike. Një sinjal i qartë për interesimin e qeverisë së Kroacisë në reformën ushtarake është Rishikimi i Strategjisë së re të Mbrojtjes (RSM), e cila përfundimisht është kompletuar dhe pret miratim nga kuvendi. Për MM-në kroate,

RSM-ja është “konceptuar si një inventar i tërësishëm i sistemit të mbrojtjes i cili do të [...] propozoj një koncept të ri të mbrojtjes”<sup>247</sup>. RSM-ja është bazë e pritur gjatë për Planin e Zhvillimit Afatgjatë (LTDP) të FAK-ut, i cili tani është duke u diskutuar dhe pritet të miratohet në pranverë të vitit 2006<sup>248</sup>. Puna mbi RSM-në filloi në tetor të vitit 2003 me themelimin e Këshillit të RSM-së dhe Komisionit Zhvillimor të RSM-së. Këshilli i RSM-së përfshiu jo vetëm zyrtarët kryesor të MM-së dhe FAK-ut por gjithashtu edhe përfaqësues nga zyra e kryetarit, qeverisë, ministrisë së punëve të jashtme dhe ministrisë së financave. Nuk ka pasur prani të ekspertëve të pavarur civil, por gjatë tërë procesit të RSM-së, Këshilli dhe Komisioni mbajtën konsultime të rregullta me Shtabin Qendror të NATO-s dhe ekipe të ekspertëve përkatës të saj vizituan vendin.

RSM-ja arrin në përfundim se ndryshime madhore kanë ndodhur në perceptimet e sigurisë së Kroacisë dhe rajonit si tërësi që nga përfundimi i luftës dhjetë vite më parë. Ai parashikon vetëm një mundësi të vogël të një “konflikti konvencional, në të cilin territori kroat do të ishte pjesë e një fushëbeteje më të madhe”<sup>249</sup>. Siguria kolektive dhe jo ajo individuale është parë si strategjia më fitimprurëse për Kroacinë, veçanërisht sa i përket ekonomisë. Ndonëse RSM-ja nuk mund ti zgjidhë të gjitha problemet e tanishme të FAK-ut, ajo është një kornizë e rëndësishme për LTDP dhe korrigjon ca të menduar naiv<sup>250</sup> dhe rezistencën ndaj ndryshimeve që është tejet e pranishme në sektorin e mbrojtjes, duke përfshirë si vijon:

- Shërbimi detyrues duhet të shfuqizohet brenda pesë viteve
- Forca fleksibile për operacione ndërkombëtare brenda misionëve të NATO-s, BE-së apo KB-së në vend të mbrojtjes së fuqishme territoriale
- Heqja e së ashtuquajturës rezervë “B” e cila përbëhet nga 76.000 rezervist me trajnime të rregullta dhe pajisje bazë
- Rezervat e mbetura do të formojnë një komponentë shtesë që do të mobilizohet në rast të mbrojtjes kombëtare (duke përfshirë një komponentë prej 8.000 anëtarësh të rezervës së kontraktuar)
- Zvogëlimi i personelit të ushtrisë aktive deri në 16.000, duke shtuar 2.000 të punësuar civil (zbritje nga numri i tanishëm përafërsisht 29.000).
- Furnizimi me pajisje të reja dhe modernizimi mund të shkonte deri në vitin 2015 për shkak të fondeve të kufizuara—apo edhe më gjatë.

Reforma e mbrojtjes në Kroaci akoma ka një rrugë të gjatë për të bërë dhe shumë nga përpjekjet për modernizim të përmendura më sipër do të mbesin vetëm në letër për vitet në vijim nëse fondet tashmë të kufizuara nuk materializohen. Mundësia e shtyrjes për disa nga masat tashmë është përmendur në RSM<sup>251</sup>. Doktrinat të cilat janë në pajtim me NATO-n janë marrë në konsideratë vetëm për 2007. Kur është në pyetje çështja e mbrojtjes dhe sigurisë në rajonin e brishtë më e rëndësishme është ndryshimi i ideve. Çështja politike kryesore për anëtarësim të plotë—bashkëpunimi me TNPKJ—duket të jetë zgjidhur me zënien e Gotovinës në Tenerife në dhjetor të vitit 2005. Prandaj, ftesa për anëtarësim ka të ngjarë të mbërrij në vitin 2006

### ***Integrimi euroatlantik***

Në mars të 2005, Bashkimi Evropian (BE) shtyri fillimin e bisedimeve për praninë të Kroacisë. “Jo Para për Hagë” ishte shkruar në disa mure, duke pasqyruar jo vetëm opinionin e gjerë por gjithashtu edhe vazhdimin e ngurrimit të klasës politike për të dorëzuar apo zbuluar vendndodhjen e Gjeneralit Gotovina<sup>252</sup> i cili është akuzuar për kryerjen e krimeve kundër serbëve gjatë luftës së Kroacisë në të vetëshpallurën Republika Serbe në rajonin e Krainës. Gati një vit pas Samitit të Stambollit në vitin 2004, ku NATO gjithashtu shtyri anëtarësimin e plotë të Kroacisë në aleancë, ky refuzim nga BE-ja ishte edhe një dështim për ambiciet euroatlantike kroate. Ndonëse bashkëpunimi me Hagën ishte përmirësuar gjatë dy viteve të fundit, rasti i Gotovinës në atë kohë tregonte akoma ekzistimin e trashëgimisë së regjimit të Tugjmanit, jo vetëm në HDZ, por gjithashtu brenda ministrisë së mbrojtjes e cila vetëm së voni ndaloi pagesën e kontributeve pensionale për Gotovinën<sup>253</sup>. Megjithatë, që nga tetori 2005, BE befasisht ndryshoi mendje dhe i dha Kroacisë statusin kandidat që e kishte dëshiruar atë gjatë. Ishte spekuluar se ky ndryshim ndodhi për shkak të ndryshimit të mendimit të Kryeprokurores së KB-së, Karla del Ponte, lidhur me bashkëpunimin e Kroacisë me TNPKJ, pasi që ajo ishte informuar tashmë për planin e arrestimit të Gotovinës disa javë më vonë. Por, më shumë ka të ngjarë se presioni i ushtruar nga Austria në tetor të vitit 2005 për një marrëveshje për të pranuar statusin kandidat të Turqisë, në shkëmbim me fillimin e bisedimeve për praninë me Kroacinë ishte më kuptimplotë. Megjithatë, me Gotovinën në Hagë që nga dhjetori 2005, çështjet politike të Kroacisë duken të jenë zgjidhur.

Për më tepër, Kroacia ka qenë tashmë thellë e angazhuar në bashkëpunim me NATO-n dhe me planifikimin e sigurisë të BE-së. Ndonëse akoma nuk është anëtare, Kroacia në RSM-në e saj të marsit të vitit 2005 llogaritet në kontributin e Grupit të Betejës së BE-së dhe struktura tjera të ardhshme të Politikës së Mbrojtjes dhe Sigurisë Evropiane (ESDP)<sup>254</sup>. Shumica e kontributeve të planifikuara, megjithatë do të jenë të njëjtat njësi të cilat Kroacia do të trajnoj dhe pajis për operacionet dhe strukturat e udhëhequra nga NATO.

#### *Programet e NATO-s me Kroacinë*

Perspektiva e anëtarësimit në NATO, në vitet e fundit, ka qenë forca shtytëse prapa reformave në sektorin e mbrojtjes së Kroacisë. Që nga pranimi në Programin e partneritetit për Paqe (PfP) në 2000, Kroacia ka shtuar aktivitetet dhe obligimet brenda këtij programi. Përmes Programit për Partneritet Individual (IPP), ajo ka marrë pjesë në 251 aktivitete<sup>255</sup> në vitin 2004 dhe ka synuar të marrë pjesë në 430 aktivitete IPP në 2005<sup>256</sup>. Përveç kësaj, Kroacia në vitin 2001 u pajtua të koordinoj Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit (PARP) me NATO-n, një cikël dyvjeçar për konsultime bilaterale dhe multilaterale në planifikimin e mbrojtjes. Përmes PARP, ana kroate çdo vit do të pajtohet mbi një pako të Qëllimeve të Partneritetit (PG) që ka si qëllim vendosjen e interoperabilitetit së FAK-ut me forcat e NATO-s dhe struktura moderne më ekonomike. PG-ja ofron jo vetëm udhëheqje të qartë për reformat në mbrojtjen kroate, por gjithashtu vendos afate për secilin qëllim. Pasi që Kroacia ka arritur statusin zyrtar të një anëtari të plotë aspirant, të gjitha masat e PARP-it dhe IPP-së, gjithashtu informojnë Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) të NATO-s. Veçmas kësaj, ekspertët e NATO-s, gjithashtu edhe misionet bilaterale nga Britania e Madhe, SHBA-ja dhe Gjermania kanë qenë të ftuar nga qeveria kroate për një numër konsultimesh tjera, misione dhe takime pune. Dy ekipe të ekspertëve të NATO-s, një në risistemim dhe ri-trajnim të personelit tepriçë dhe tjetri në transformim të bazës kanë komunikuar dhe takuar me anëtarët përkatës në anën kroate<sup>257</sup>. Ekspertët e NATO-s ishin gjithashtu të angazhuar në përgatitjen e Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes në 2005. Veç kësaj, MD-ja kroate ka nënshkruar për disa aktivitete nën Përkushtimin e Pragës për Aftësitë (PCC)<sup>258</sup>.

I tërë procesi i reformës së mbrojtjes duket të jetë orientuar përmes takimeve të punës, ushtrimeve të përbashkëta dhe konsultimeve me vendet e NATO-s në rrugë bilaterale dhe multilaterale. Edhe pse është e vështirë të maten ndikimi dhe influenca e NATO-s në secilin aktivitet në reformën e mbrojtjes kroate, përshpejtimi i këtyre reformave dhe ndryshimi i

strategjive të mbrojtjes, detyrat dhe aftësitë janë qartë të lidhura me obligimet dhe afatet e vendosura nga NATO. Pa opsionin e anëtarësimit në NATO dhe BE dhe përfitimet potenciale që ato mund të sjellin, qeveria kroate do të mund të mos fillonte procesin e reformave të mbrojtjes në këtë ritëm<sup>259</sup>.

### ***Udhëheqja politike e reformës së mbrojtjes***

Ushtria kroate, sikurse edhe forcat tjera të sigurisë shtetërore, ishin shumë të politizuara gjatë luftës dhe pas vitit 1995 nga regjimi i Franjo Tugjmanit. Regjimi i Tugjmanit, me vite i klasifikuar nga Freedom House si "Pjesërisht i lirë", u shkatërrua pas vdekjes së tij dhe ndryshimit të parë të qeverisë në zgjedhjet e vitit 2000. Tugjmani, heroi i luftës kroate kundër serbëve të Krainës, ishte gjithmonë në përkrahje të një FAK-u të fuqishëm, dhe kështu shtabi i përgjithshëm i FAK-ut me sukses refuzoi çfarëdo reforme për një kohë të gjatë<sup>260</sup>. Megjithatë, Kroacia ka paraqitur masa të ndryshme institucionale për të garantuar mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik të ushtrisë.

### ***Mbikëqyrja parlamentare dhe civile<sup>261</sup>***

Bazuar në Aktin e mbrojtjes dhe aktin e shërbimeve të sigurimit, kuvendi kroat ka autoritetin për të vepruar mbi çështjet kryesore të mbrojtjes, sikurse edhe mbikëqyrjen e përgjithshme të forcave të sigurisë duke përfshirë FAK-un<sup>262</sup>. Komisioni parlamentar për politikë të brendshme dhe siguri kombëtare mund të thërras zyrtarë nga FAK-u për dëgjim, sikurse edhe të vlerësoj të gjitha çështjet financiare dhe materiale të FAK-ut dhe shërbimeve tjera të sigurisë. Veç kësaj, themelimi i Këshillit për Mbikëqyrje të Shërbimit të Sigurisë (KMSHS) në vitin 2003 i përbërë nga shtatë ekspert të pavarur ishte vlerësuar lartë. Anëtarët e KMSH-së kanë të drejtën për t'iu qasur raporteve nga shërbimet e sigurimit dhe personelit të tij përkatës të cilin mund ta ftoj për dëgjim<sup>263</sup>. Ndonëse struktura duket të jetë e mjaftueshme dhe e ngjashme me masat tjera mbikëqyrëse të zbatuara në vendet evropiane, realiteti tregon të kundërtën. Ka një mungesë të përgjithshme të ekspertizës civile mbi çështjet e sigurisë dhe të ushtrisë në kuvendin kroat. Për shkak të kufizimeve të një mandati katër vjeçar, është e vështirë për parlamentarët në komision të ndërtojnë këto kapacitete në mënyrë adekuate të mjaftueshme për të kryer çfarëdo funksioni serioz të kontrollit dhe mbikëqyrjes<sup>264</sup>. Kjo gjithashtu është e vërtetë për OJQ-të dhe komunitetin hulumtues në Kroaci, ku aktualisht nuk ka ekspertizë të mjaftueshme mbi çështjet e sigurisë<sup>265</sup>.

Sa i përket KMSHS-së, jo vetëm që udhëheqësi i këtij këshilli, një ekspert akademik i mirënjohur i mbrojtës dhe çështjeve të sigurisë, së fundi ka dhënë dorëheqje nga posti i tij, por duket që ministria e mbrojtjes dhe shtabi i përgjithshëm nuk janë akoma të gatshëm ti ofrojnë këtij forumi dokumentet e kërkuara. Një skandal që përfshin akuza për përdhunim dhe ngacmim seksuale në FAK është një shembull i freskët për këtë problem, pasi rezultati i hetimeve ushtarake as nuk ishte bërë publik as nuk i ishte dhënë komisionit parlamentar përkatës apo KMSHS-së. Në nëntor të vitit 2004, MM-ja kishte urdhëruar një hetim mbi një deklaratë të bërë nga një grup për të drejtat e njeriut lidhur me ngacmimet seksuale në FAK. Që nga atëherë, ministria e ka minimizuar rëndësinë e deklaratave. Skandali ka shpërthyer kur një tjetër grup jo-qeveritar i bëri publike tregimet e ngacmimeve seksuale dhe dhunimeve të rekrutëve që datonin nga viti 2000. Informacioni erdhi nga tre oficerë dhe përfshinte dhjetëra raste<sup>266</sup>. Për më tepër, rasti Gotovina tregoi për një kohë të gjatë mungesën e kontrollit civil mbi të gjitha shërbimet e sigurimit në Kroaci, sikurse edhe vazhdimësinë e trashëgimisë së rrjeteve të regjimit të Tugjmanit<sup>267</sup>.

#### *Ndarja e kontrollit mbi FAK-un*

Akumuluar gjatë regjimit gjysmë autoritar të Tugjmanit, kryetari i Kroacisë mban një pozitë të fuqishme kushtetuese si komandant zyrtar i FAK-ut. Ai është kryesues i Komisionit të Përbashkët për Siguri Kombëtare (KPSK) i cili përfshinë, ndër të tjerë, kryeministrin dhe ministrin e mbrojtjes. Ndonëse fuqia e kryetarit është zvogëluar nga kryetari i tanishëm Mesiç, disa fusha me konflikt potencial në mes të zyrës së kryetarit dhe qeverisë apo MM-së mbesin<sup>268</sup>. Derisa ministri i mbrojtjes kontrollon institucionet ushtarake, buxheti dhe procesi i planifikimit, vendimet strategjike duhet të merren me konsensus nga kryetari dhe kryeministri në KPSK. Ndonëse organizimi i tanishëm duket të jetë i balancuar në mënyrë të arsyeshme, ai mund të shpie në konfuzion në rast sulmi apo raste të jashtëzakonshme<sup>269</sup>. Organizimi institucional me një kryetar të fortë shpesh shpie tek problemet me ndarjen e kontrollit mbi forcat e armatosura, i cili është një problem i ngjashëm në gati të gjitha ish republikat jugosllave. Derisa në Maqedoni kjo ka qenë një problem më i vogël, pasi që kryetari dhe kryeministri kanë ardhur nga e njëjta parti politike, në Shqipëri dhe Kroaci ajo shpesh ka penguar procesin e reformave në mbrojtje në një shkallë mjaft të lartë. Diskutimet e vazhdueshme lidhur me kompetencat e kryetarit dhe kryeministrit mbi sektorin e mbrojtjes, megjithatë kanë zvogëluar efikasitetin e kontrollit demokratik të FAK-it dhe agjencive tjera të sigurisë<sup>270</sup>.

Në përgjithësi, reformat ushtarake në Kroaci janë ngulitur tashmë në kulturën, strukturat zhvilluara e mirë dhe në ekonominë me rritje të shpejtë. Pas dy ndryshimeve demokratike përmes zgjedhjeve të rregullta, Freedom House e ka vlerësuar Kroacinë që nga viti 2000 si të "lirë". Për më tepër, Indeksi i Transformimit Bertelsmann e shikon vendin si një ekonomi tregu të konsoliduar dhe demokratike, që është domethënëse krahasuar me rastet e Shqipërisë dhe Maqedonisë<sup>271</sup>. Ndonëse demonstratat në përkrahje të Gotovinës në Zarë dhe qytetet tjera bregdetare në dhjetor të vitit 2005 treguan se akoma ka një pakicë nacionaliste në Kroaci, shumica e qeverisë e mbështeti transferimin e Gotovinës në Hagë. Denacionalizimi i politikës kroate që nga vdekja e Tugjmanit përfundimisht ka pasur një ndikim në denacionalizimin e FAK-ut dhe përmirësimin e kontrollit civil dhe demokratik.

### ***Transformimi i mbrojtjes***

#### **Zvogëlimi në numër dhe risistemimi në Kroaci: Programi SPECTRA**

Ngjashëm me situatën në Serbi dhe Mal të Zi, qeveria kroate duhet të vendoste – kryesisht për shkaqe buxhetore—të zvogëloj dhe ristrukturoj forcat e saj të armatosura pa ndonjë nga dokumentet strategjike për të përcaktuar detyrat e ardhshme, strukturën dhe forcën e FAK-ut. Përveç arsyeve buxhetore, vonesat në marrjen parasysh të nevojës së zvogëlimit të forcave të armatosura ishte shkaktuar po ashtu nga kundërshtimi i fortë dhe ngurrimi kundrejt procesit të zvogëlimit nga vet FAK-u, sikurse edhe nga shoqatat e veteranëve të luftës<sup>272</sup>.

Siç është përmendur më lartë, qeveria kroate për një kohë të gjatë nuk kishte strategji të qartë të zvogëlimit dhe ristrukturimit të FAK-ut. Nuk kishte interesa specifike për këtë çështje gjatë kohës së regjimit të Tugjmanit. FAK-u, së bashku me forcat tjera të sigurisë, formuan një bazë të rëndësishme të pushtetit për regjimin, dhe, edhe pas vitit 2000 zyrtarët mbetën jo të gatshëm ndaj zvogëlimit për shkak të presionit publik dhe të brendshëm<sup>273</sup>. Vonesa e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë së Mbrojtjes po ashtu ka kontribuar në atë trend.

Megjithatë, zhvillimi i programit të zvogëlimit, ri-trajnimin dhe ri-integrimit për personelin tepriçë të FAK-ut ishte nisur në fund të vitit 2001 bazuar në Programin e Aktivitetit të Qeverisë kroate për periudhën 2000-2004. Drafti i parë i projekt propozimit ishte publikuar në maj të vitit 2002, drafti final ishte miratuar nga qeveria kroate me 3 tetor 2002, Programi i Përkujdesit dhe

Tranzicionit për Personelin e Ndarë (SPECTRA) ishte publikuar në vitin 2003, me ekipin e parë operacional në maj dhe tri të tjera në shtator të vitit 2003<sup>274</sup>. Zyra e Tranzicionit, e cila është trup koordinues për programin, ishte vendosur si një njësi e ndarë në Ministrinë e Mbrojtjes në Zagreb.

#### *Grupi në shënjestër*

Objekti parësor i programit SPECTRA është përkrahja e personelit të shkarkuar të FAK-ut nga viti 2002 e tutje. Ndonëse qasja e tyre kryesore për zvogëlim është menduar të jetë një proces vullnetar, numri i madh i personelit të shkarkuar kërkonte që disa të largoheshin në mënyrë jo-vullnetare. Projekti SPECTRA në fillim ka paraparë 11.000 anëtarë tepriçë të FAK-ut deri në fund të vitit 2006<sup>275</sup>. Megjithatë, numri i planifikuar prej 3.286 personash për tu larguar në vitin 2002 u ngrit në mbi 8.000<sup>276</sup>. Zyra e Tranzicionit raportoi gjithsej 14.632 persona të larguar në fund të vitit 2005. Me vendimin e ri në Rishikimin e Strategjisë Mbrojtjes (RSM) për të zvogëluar deri në 16.000 personelin ushtarak, numri i individëve me të drejt për përkrahje përmes SPECTRA-s po ashtu do të rritet. Krahasuar me planifikimet e personelit në dokumentin fillestar të SPECTRA-s të vitit 2002, me numrin e tanishëm të ofruar nga Zyra e Tranzicionit, duket të ketë disa parregullsi. Madje edhe numri i forcës së tanishme të FAK-ut në vitin 2002 dhe 2003 kanë ndryshuar në dokumentet e tanishme. Kroacia tashmë ka arritur numrin e saktë të njëjtë prej 19.520 në fund të vitit 2005 i cili ka qenë parashikuar për vitin 2006.

Figura 16: Parashikimi forcës së personelit të FAK-ut dhe numri i personelit për tu shkarkuar nga viti 2002–2005

Viti	2002	2003	2004	2005
Forca fillestare	40.714	31.936	27.864	23.742
Ndarja organizative	2.117	0	0	0
Numri i të pensionuarve	2.998	490	615	790
Format tjera të zvogëlimit natyral	663	582	507	432
Ndarja e personelit tepriçë	3.000	3.000	3.000	3.000
Ndarja e përgjithshme vjetore	8.778	4.072	4.122	4.222
Fuqia përfundimtare	31.936	27.864	23.742	19.520



Burimi: Prezantimi i SPECTRA në Qendrën e Bonit mbi Konvertimin Ushtarak (BICC), dhjetor 2005

Nga këta 14.632<sup>277</sup>, mbi 9.000 persona kanë marrë një ftesë nga SPECTRA për të konfirmuar pranueshmërinë për përkrahje. Deri në fund të vitit 2005, 2.100 individë kanë marrë përkrahje nga SPECTRA<sup>278</sup>. Për shkak të kufizimeve strukturore dhe buxhetore, SPECTRA është në gjendje të përkrah 800–1.000 pjesëtar të personelit të shkarkuar për vit. Prandaj, përkrahja e planifikuar për disa nga veteranët e luftës dhe invalid brenda programit i është lënë iniciativave të tjera qeveritare dhe projekteve të shoqatave të veteranëve të luftës. Në përgjithësi, shumica e personelit të shkarkuar ose kanë pranuar opsionin e pensionimit të hershëm apo paga të shkurtuara, e cila ngrit pyetjen e përgjithshme nëse një program shumë i sofistikuar i risistemimit ishte vërtetë i nevojshëm në Kroaci<sup>279</sup>.

E drejta për përkrahje nga SPECTRA gati për të gjithë personat e shkarkuar, sikurse edhe mungesa e kriterëve për të përcaktuar se kush duhet të vazhdoj shërbimin me FAK-un, ka qenë i kritikuar. Një pjesë e personelit ushtarak nuk duhet të inkurajohet të lëshoj KAF-in përmes përfitimeve nga SPECTRA<sup>280</sup>. Veçanërisht gjatë viteve fillestare të zvogëlimit dhe zbatimit të SPECTRA-s, vlerësimet tregojnë përafërsisht 10–15 % të personelit të shkarkuar si personel me arsimim të lartë, disa prej tyre edhe me trajnime në institutet ushtarake të vendeve partnere të NATO-s. Rivaliteti i përmendur në mes të “heronjve të pa edukuar të luftës” dhe oficerëve të rinj me aftësi në gjuhë të huaja dhe trajnime me NATO-n ka shpjeguar në frustrim të këtyre të fundit, si oficer të rinj ata kanë pasur vështirësi në “ngjitjen e shkallëve” pavarësisht trajnimeve shtesë që kanë marrë për detyrat e ardhshme ndëroperacionalizuese të NATO-s<sup>281</sup>. Kjo thirrje është mohuar nga MM-ja, ndonëse rezultatet e një anketimi të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) duket ta përkrah këtë. Duket se anëtarët e arsimuar mirë të forcave të armatosura janë më të gatshëm në largimin vullnetarë dhe të marrin përkrahjen pasuese përmes SPECTRA-s pasi që shanset dhe mundësitë e tyre në tregun e tanishëm të punës të Kroacisë janë më të mëdha. Megjithatë, për detyrat e ardhshme të FAK-ut në strukturat euroatlantike, kjo ikje e burimeve mund jetë një mangësi në aspektin afatgjatë.

### *Organizimi institucional për ri-trajnim dhe risistemim*

Qasja kundrejt implementimit të SPECTRA është ndërministrore, kjo do të thotë se të gjitha ministritë relevante janë të angazhuara dhe kanë pranuar të zbatojnë pjesë të caktuara të programit SPECTRA<sup>282</sup>. Këshilli Mbikëqyrës Ndërministror ka përgjegjësinë e menaxhimit të tërë programit—ndonëse kjo është një detyrë më shumë simbolike dhe politike—derisa Këshilli Ndërministror Operacional takohet çdo tre muaj dhe rishqyrton statusin e zbatimit të programit<sup>283</sup>. Organi kryesor, megjithatë, është Zyra e cila vepron mjaft e pavarur, por mban kontakte të ngushta me partnerët tjerë. Dokumenti origjinal i projektit parashikonte bashkëpunim të ngushtë me OJQ-të në zbatimin dhe mbikëqyrjen e programit, por kjo nuk është konkretizuar<sup>284</sup>. Një bashkëpunim i tillë do të ishte një pasuri për programin. Nën definicionin e tyre të një OJQ-je, ekipi i SPECTRA-s aktualisht ka përfshirë në program shoqatat kroate të veteranëve të luftës si OJQ potenciale partnere. Në një takim me një përfaqësues të një shoqate të tillë<sup>285</sup> ishte bërë e qartë se ato shoqata janë akoma shumë të ndara nga SPECTRA, por se personeli i programit SPECTRA do të dëshironte të bashkëpunonte më ngushtë me ata duke pasur fondet përkatëse, por jo edhe kapacitetin e mjaftueshëm për të zbatuar projektet e veteranëve<sup>286</sup>. Deri tani, shoqata e sapo përmendur ka financuar trajnime për punëkërkes për të ndihmuar veteranët dhe klientët e SPECTRA-s.

Përveç Zyrës tranzitore të vendosur në MB, vet programi përbëhet nga katër të ashtuquajtura Ekipet tranzitore mobile (MTT) të vendosura në qytetet e Zagrebit, Rjekës, Osijekës, dhe Splitit. Të gjitha MTT kanë të punësuar këshilltarë, psikolog, sociolog, ekonomist dhe jurist. Aktualisht 19 njerëz punojnë në MTTs<sup>287</sup>.

Një komponentë shtesë unike e programit SPECTRA përfshin angazhimin e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Në kontrast me projektet e ngjashme në Bosnje e Hercegovinë<sup>288</sup>, IOM-i ishte kontaktuar nga Zyra e tranzicionit me kërkesën për të vendosur një program komplementar të aktiviteteve të SPECTRA-s. IOM-i, personeli nga SPECTRA dhe MM-ja pastaj zhvilluan një punëtor për të zhvilluar PRIOM apo RASDP— Ndhima për Ri-integrim të Personelit të Ndarë të Mbrojtjes. Në shkurt të vitit 2004, IOM-i dhe MM-ja nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Në vend të dyfishimit të zyrave dhe përpjekjeve siç edhe ndodh shpesh, ekspertët dhe udhëheqësit e IOM-it janë integruar në strukturat e SPECTRA-s ndërsa kanë mbetur të pavarur në drejtimin e aktiviteteve të tyre. IOM-i ka tri nën-zyre në

objektet e MM-së në Zagreb, Osijek dhe Split, të cilat mbulojnë katër rajone të Kroacisë. Shtatë këshilltarë me përvojë në trajnime, biznes, psikologji, e po ashtu edhe në ushtri (tre ish oficerë) janë duke punuar si ekipe mobile dhe duke vizituar përfituesit e tyre edhe në fshatrat më të thella<sup>289</sup>. Programi RASDP përkrah vetëm individët e zgjedhur tashmë nga SPECTRA të cilët kanë kompletuar punëtoritë orientuese për të shtuar në maksimum shanset e tyre për punësim. IOM-i ka zgjedhur që kryesisht të përkrah individ që jetojnë në të ashtuquajturat “Zona me Interes të Veçantë Shtetëror” (ZIVSH), të tilla si rajonet e prekura nga lufta. Para fillimit të programit IOM-i kreu një Studim mbi Tregun e Punës brenda ZIVSH-së për të arritur që aktivitetet nën RASDP të plotësojnë kërkesat lokale<sup>290</sup>. Përqendrimi i aktiviteteve kryesore nën RASDP është vetëpunësimi.

#### *Programet dhe aktivitetet*

Drafti i programit SPECTRA i vitit 2002 parashikonte një llojshmëri të aktiviteteve për personelin e tepër ushtarak, duke filluar me takime pune obliguese mbi tranzicionin dhe orientimin, deri te ofrimi i huave për punëdhënësit dhe fonde shtesë për vetëpunësim. Disa nga këto aktivitete përkrahëse, veçanërisht huat me kosto të larta, pagesat dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) nuk u konkretizuan për shkak të fondeve të pamjaftueshme<sup>291</sup>. Në vend të kësaj, ekipi i Zyrës tranzitore të SPECTRA-s vendosi të fokusohet mbi fushatën e përgjithshme të marrëdhënieve me publikun për të ngritur vetëdijen për SPECTRA-n brenda FAK-ut e po ashtu edhe në shoqërinë kroate, u ofruan takime pune tranzitore dhe përkrahje e përgjithshme si dhe shërbime këshilluese për personelin tepricë. Pas kompletimit të takimeve punuese, pjesëmarrësit mund të zgjedhin në mes të marrjes përkrahje për punësim, vetëpunësim apo trajnim profesional. Duke marrë parasysh numrin e profesionistëve ushtarak të shkarkuar, kjo përkrahje mundëson procesin e punësimit që të ecë përpara më shpejtë sesa të pritët për shtimin e fondeve adekuate për të zbatuar programe përkrahëse më të hollësishme.

Takimet tranzitore të punës ishin planifikuar të zgjasnin 4 ditë, por ishin shkurtuar në tri ditë me qëllim që të shtohet numri i përfituesve. Takimet e punës ishin mbajtur në të katër zyrat e SPECTRA-s në vend dhe përgjithësisht ishin përdorur të njëjtat metoda, me përjashtim të pak ndryshimeve të vogla (shiko shembullin e Osjekut më poshtë). Një grup i përzier i njerëzve sipas gradave dhe moshës është mbledhur në kursin transitor, dhe organizatorët gjithashtu përpiqen të përfshijnë personel të shkarkuar të gjinisë femërore në çdo grup, ndonëse kjo është e vështirë për

shkak të numrit të vogël të femrave ushtarake në FAK. Të tri ditët janë të strukturuar në këtë mënyrë:

Dita 1:

Pas një prezantimi të përgjithshëm dhe ushtrimeve relaksuese, pjesëmarrësit e plotësojnë një pyetësor dhe bëjnë një test të aftësive. Pas kësaj, të gjithë pjesëmarrësit marrin pjesë në një intervistë për punë e cila incizohet dhe analizohet në ditën e tretë. Temat tjera në ditën 1 përfshijnë ligjet dhe rregulloret, vlerën personale, teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe bërjen e një plani individual transitor për çdo pjesëmarrës.

Dita 2:

Në ditën e dytë, të gjithë pjesëmarrësit përgatisin planin e tyre tranzitor mbi të cilin ata duhet të vazhdonin të punonin në mbrëmjen e mëparshme si detyrë shtëpie. Përveç kësaj, dita 2 është “dita e karrierës” me ushtrime në shkrim për shkrimin e letrave përcjellëse, CV-ve, sikurse edhe ushtrime për kërkim të vendeve të punës si dhe qasjes ndaj një punëdhënësi potencial.

Dita 3:

Dita e tretë kryesisht kalohet me analiza të përbashkëta të intervistave të punës të incizuara në ditën 1. Përveç kësaj, përfituesit e suksesshëm të programit SPECTRA kthehen për të folur lidhur me punën apo biznesin e tyre të tanishëm. Përveç kësaj, IOM-i ofron një pasqyrë të aktiviteteve përkrahëse fakultative të RASDP. Në fund, të gjithë pjesëmarrësit i marrin certifikatat e tyre zyrtare.

Si vazhdimësi e takimeve punuese, këshilltarët i kontaktojnë pjesëmarrësit pas dy ditësh. Ka tri sesione këshilluese zyrtare (ndonëse disave iu nevojiten më shumë) për pjesëmarrësit për të definuar qëllimet e tyre të punësimit për të ardhmen dhe për të zgjedhur një nga programet përkrahëse. Ndonëse ishte planifikuar që nga fillimi që të monitorohet suksesi i pjesëmarrësve përgjatë dy viteve, kjo është zvogëluar në një periudhë kohore një vjeçare—përsëri, për shkak të kufizimeve strukturore dhe financiare të SPECTRA-s<sup>292</sup>.

Ndonëse nuk ka vlerësim të hollësishëm për ndikimin e deritanishëm të programit, shifrat fillestare të suksesit të SPECTRA-s tregojnë një efikasitet të suksesshëm, duke marrë parasysh gjendjen e përgjithshme ekonomike në Kroaci dhe tregun e punës në veçanti. Deri në tetor të vitit 2004, 1.100 përfitues kanë marrë pjesë në aktivitetet e SPECTRA-s, nga të cilët 40% ishin punësuar, 16 % ishin në gjendje të vetëpunësoheshin, deri sa 20 % ishin në proces të fillimit të

bizneseve të tyre. Një tjetër 12 % përfunduan trajnime shtesë profesionale<sup>293</sup>. Në intervistat në prill të vitit 2005, udhëheqësit e programit të SPECTRA-s zbuluan të dhëna pak me ndryshe, ku vetëm 30 % prej 1.600 kane gjetur punë, 23 % të vetëpunësuar dhe 15 % në trajnime profesionale. Në dhjetor të vitit 2005 këta numra kishin ndryshuar, përsëri, me 2.100 përfitues nga të cilët vetëm 20% të punësuar dhe 42% të vetëpunësuar. Ndonëse ndryshimet në numrat e të punësuarve dhe të vetë-punësuarve janë mjaft thelbësor, kjo më shumë flet për animin e konsulentëve biznesor në drejtim të vetëpunësimit, meqë mbetet e vështirë lokalizimi i mundësive të punësimit për ish-ushtarakë. Personeli i SPECTRA-s gjithashtu sqaroi se ata përfitues të cilët dështojnë të gjejnë punë, nuk kanë mungesë të aftësive dhe kualifikimeve, por me tepër nuk dëshirojnë të punësohen. Disa gjejnë punë në tregun e zi, çka iu mundëson atyre t'u shmangen 50% të ndalesave për pension të cilën ata duhet ta bëjnë normalisht nëse punësohen në tregun e rregullt<sup>294</sup>.

RASDP-ja e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim që nga fillimi kishte në fokus të përkrahte personelin e shkarkuar kryesisht për vetëpunësim. Fondet e saj janë përdorur për të bashkë financuar blerjen e pajisjeve, ofrimin e trajnimeve shtesë, të bashkë financoj adoptimin e objekteve të biznesit, të veprojnë si shtesë për fillimin e bizneseve dhe për të përkrahur përfituesit në marrjen e licencave dhe autorizimet ligjore për biznesin e tij/saj<sup>295</sup>. Personeli i IOM-it e paraqiti programin në takimet punuese tranzitore të SPECTRA-s, dhe kandidatët respektiv marrin një formë regjistrimi (2.800 tashmë janë lëshuar) të cilat ata duhet t'i dorëzojnë nëse ata janë të interesuar të marrin pjesë në RASDP. Deri tani, 1.445 persona të shkarkuar kanë kërkuar përkrahje nga IOM-i. Ekipi i ri-integrimit ka nënshkruar 667 kontrata ri-integruese deri në mars të vitit 2005, 222 nga të cilat janë në rajonin e Zagrebit dhe Rjekës, 263 në rajonin e Osjekut, dhe 182 në rajonin e Splitit<sup>296</sup>. Në fund të vitit 2005, numri i përgjithshëm i përfituesve është rritur në 1.002 me 852 të vetëpunësuar dhe 153 të punësuar në treg. Bashkëfinancimi i pajisjeve ishte lloji më i shpeshtë i ndihmës (76 %), që rezultojnë me rreth 82 % të të gjithë përfituesve të cilët ose e vazhdojnë apo e fillojnë aktivitetin e vetëpunësimit. Përafërsisht 73 % e kanë zgjedhur bujqësinë si vetëpunësim, si mbarështimin e gjedheve dhe mbajtjen e bletëve, etj. Duke marrë parasysh hyrjen potenciale të Kroacisë në BE, kjo zgjedhje mund të rezultojë e rrezikshme në një afat me të gjatë për disa klient, bujqësia me një shkallë të ulët mund të bjer nën presionin e tregut të fuqishëm. Të pyetur për këtë çështje, udhëheqësit e IOM-it sigurojnë se ata i informojnë klientët e tyre lidhur me kërcënimin e rrezikut dhe ata kanë lobuar me sukses për themelimin e

kooperativave dhe shoqatave; këshilltarët e IOM-it gjithashtu bashkëpunojnë me ministrinë e bujqësisë lidhur me këtë çështje<sup>297</sup>. Veç kësaj, pasi që shumë klientë posedojnë tokë, kanë përvojë në bujqësi dhe janë në favor të përkrahjes më të madhe, IOM-i sheh perspektivë të mjaftueshme në përkrahjen e qasjes së formimit të kooperativave dhe shoqatave ndonëse gara për tregun evropian mund ta bëj atë të vështirë.

Projekti planifikon të përfitojnë 650 individ në vitin 2005. Ndonëse monitorimi ka filluar herët në shtator të vitit 2004 me 65 raste, është shumë herët të gjykohet suksesi dhe qëndrueshmëria e asistencës ri-integruese e IOM-it. Megjithatë, fleksibiliteti i programit dhe motivimi i lartë i ekipit do të mund të tregonte një përpjekje prosperuese, duke mbajtur në mendje se IOM-i është duke iu shërbyer disa nga vendet me ekonomi më të dobëta në vend. Këshilltarët rregullisht i vizitojnë klientët e tyre në baza personale, duke udhëtuar edhe në fshatrat dhe fermat më të thella. Gjithashtu, planet e RASDP së IOM-it për zgjerimin e përkrahjes për grupe më të gjera të veteranëve të luftës të papunësuar të cilët marrin vetëm asistencë të vogël përmes të drejtave ligjore, aktiviteteve të Ministrisë së Veteranëve të Luftës së Atdheut. Nga përafërsisht 20% e të papunësuarve në Kroaci, 10% janë veteranë, të cilët përbëjnë përafërsisht 34.000 individ<sup>298</sup>. Vlerësimet nga lufta tregojnë se rreth 350.000 burra dhe gra kanë kaluar përmes FAK-ut nga viti 1991 deri 1995.

Përveç aktiviteteve të ndryshme të përbashkëta dhe strukturave të SPECTRA-s dhe IOM-it, RASDP gjithashtu kontribuoi me analizimin e parë të grupit cak/përfituesve në aspekt të kualifikimit shkollor, moshës dhe situatës ekonomike<sup>299</sup>. Moshë mesatare e përfituesve është 40 vjeç, por rreth 20 % e klientëve janë nën moshën 35 vjeçare gjë që është mjaft e pazakontë duke marrë parasysh problemin e plakjes së FAK-ut dhe sfidën e tij për të mbajtur dhe rekrutuar personel të ri. Përderisa vetëm 32 % e klientëve kanë pasur një edukim të specializuar ushtarak, afërsisht 6 % ishin të diplomuar në universitet dhe mbi 35 % deklaruan se njihnin gjuhën angleze, çka mund të ishte e dobishme për integrimin e FAK-ut në strukturat euroatlantike<sup>300</sup>. Studimi gjithashtu dëshmon se shumica e anëtarëve të FAK-ut ishin "civil që i kishin marrë armët": 63 % e personalit të ndarë ose ishin të punësuar (56 %) apo të vetëpunësuar (7 %) para shkuarjes në FAK, çka përbën një avantazh kryesor për çfarëdo lloj asistence ri-integruese. Siç është shpjeguar në intervista me personelin e IOM-it, shumica e "klientëve" janë të interesuar në vetëpunësim (80 %), nga të cilët 61 % favorizojnë blerjen e pajisjeve përmes programit të IOM.

Financat mbesin një nga problemet bazë për të dy projektet. Që nga fillimi, udhëheqësia e SPECTRA-s ka tej-parashikuar shumën e fondeve nga donatorët e jashtëm në rreth 54% të tërë buxhetit, një shumë tepër e lartë prej 120 milion dollarë amerikan<sup>301</sup>. Deri tani, zyra transitore duhej të financonte strukturat e saj, dhe shpenzimet e personelit ishin rreth 100.000 euro një shumë e cila ishte planifikuar të përmbushte nevojat për vetëm një vit, dhe jo tri<sup>302</sup>. Aktualisht, udhëheqësia e SPECTRA-s po përpiket për të bërë koordinimin bazë për projektin e transformimit të ardhshëm të bazave në mënyrë që marrë më shumë para për ri-integrimin përmes fondeve të pritura nga shitjet dhe qiratë e pasurive ushtarake.

Edhe SPECTRA dhe RASDP ballafaqohen me kërkesa më të mëdha sesa kapacitetet që ato kanë për plotësim. Vetëm në qendrën rajonale të Osijekut, ka 300 njerëz në listën pritëse sepse kurset e tranzicionit janë të plotësuara tërësisht deri në qershor të vitit 2006<sup>303</sup>.

#### *Rekomandimet*

Ndonëse SPECTRA dhe komponentët e IOM-it po përpiqen për gjetjen e mjeteve financiare, puna e tyre duket të ketë perspektivë pozitive për dy vitet e ardhshme. Organizimi institucional dhe aktivitetet e të dy organizatave kanë qenë të menduara dhe zbatuara mirë. Megjithatë, disa aspekte mbesin kritike:

- Ka nevojë që të zbatohen kritere të qarta, gjë që parandalon të rinjtë dhe/apo ushtarët e rinj të trajnuar nga NATO (për misionet e NATO-s dhe misione tjera ndërkombëtare) që të mos e lëshojnë FAK-un, por gjithashtu edhe të përfitojnë nga programi SPECTRA.
- Këtyre oficerëve iu nevojitet karrierë më e mirë dhe mundësi promovimi brenda FAK-ut.
- OJQ-të e shoqërisë civile dhe jo vetëm shoqatat e veteranëve duhet të jenë më të angazhuara në kurset orientuese, veçanërisht në rast të personelit tepricë me përvojë në luftë, për të ndihmuar integrimin në mjediset civile.
- Bashkëpunimi i shkëlqyer me IOM-in duhet të shërbej si bazë për bashkëpunim të mëtutjeshëm me programet tjera zhvilluese ndërkombëtare në Kroaci
- Ndonëse SPECTRA dhe IOM-i kanë ofruar të dhëna mbi programet dhe përfituesit e tyre, atyre akoma iu mungon një vlerësim i tërësishëm për situatën e tanishme të përfituesve të mëparshëm. Një analize e tillë mund të mundësoj programit SPECTRA që ti qaset donatorëve për fonde shtesë.

- IOM planifikon gjithashtu të përfshij në program edhe veteranët e luftës pa të drejta të rregullta në ushtri. Zyra tranzitore e SPECTRA-s duhet të parashikoj një zgjerim të tillë, gjithashtu, që do të mund të shpinte në një program të përbashkët me Ministrinë e Veteranëve të Luftës dhe shoqata të ndryshme të veteranëve.

### **Transformimi i bazave: përfitime për modernizim?**

Një numër i madh i reparteve të mbrojtjes kroate janë mbyllur në vitet e fundit dhe shumë të tjera do të mbyllen brenda një periudhe dhjetë vjeçare. Sipas vlerësimeve të fundit, autoritetet ushtarake do të kenë nevojë për vetëm 1/3 e numrit të tanishëm të reparteve ushtarake. Ato që mbesin nën autoritetin e tyre do të nevojitet të ripërtërihen me standarde moderne.

Ndonëse Forcat e Armatosura Kroate (FAK) ishin krijuar nga zeroja gjatë luftës së viteve 1991-1995, shteti i ri i pavarur trashëgoi shumë qendra dhe baza ushtarake në territorin e tij. Disa nga këto ishin qendra të APJ-së, Forcave të Mbrojtjes Territoriale, dhe të tjerat ishin mbajtur nga Ministria e Brendshme (MB) për forcat e saj paramilitare. Veç kësaj, disa nga qendrat ushtarake ishin vendosur nën përgjegjësinë e qyteteve dhe distrikteve në vitin 1992. Një klasifikim i pronës ushtarake në atë vit tregon një total prej 657 qendrash ushtarake, nga të cilat 511 ishin nën kontrollin e MM-së, 43 nën atë të MB-së, dhe 103 nën atë të qyteteve dhe distrikteve<sup>304</sup>. Ndryshimet në tipologji dhe pronësi (APJ/FMT) të qendrave ka shpjer në ca irritime sa i përket llogaritjeve të përgjithshme për qendrat që janë mbajtur dhe atyre që janë transferuar në agjencitë tjera shtetërore, komunitete apo Fondin e Privatizimit.<sup>305</sup> Kjo tregon nevojën për një kalkulim me sistematik për të paraqitur një pikëpamje më të përgjithshme mbi statusin e ndryshuar të bazave në Kroaci<sup>306</sup>. Kjo tregon nevojën për një llogaritje më sistematike për të paraqitur një pikëpamje më të përgjithshme mbi statusin bazave të transformuara në Kroaci.

Çështja e qendrave të fshehura dhe të braktitura të Forcave të Mbrojtjes Territoriale mund të paraqes ca vështirësi për Kroacinë<sup>307</sup>. Siç mund të shihet në Bosnje dhe Hercegovinë, depot e armeve të FMT dhe qendrat e fshehta përbëjnë një problem ekologjik dhe të sigurisë, prandaj edhe një kërcënim për komunitetin. Nuk është e qartë se sa i madh është ky problem në Kroaci dhe nëse është qasur deri me tani ky problem si është qasur.



Ndonëse transferi i bazave ushtarake ka filluar herët në vitin 1992—me 64 qendra tashmë të transferuara në vitin 1995 nga 511 sosh—nuk kishte procedurë sistematike për transformimin e bazave në vend. Duket se gjatë luftës, bazat jo të rëndësishme strategjike vetëm ishin braktisur për të liruar paratë dhe personel in e FAK-ut gjatë kohës së luftës<sup>308</sup>. Deri më tani, nuk ka analiza sistematike se çka ka ndodhur me këto qendra. Ngjashëm me çështjen e zvogëlimit të numrit, transferi i bazave— lere më transformimi në përgjithësi—nuk ishte lart në agjendën e qeverisë së Tugjmanit, i cili përpqej të mbante lartë fuqinë e tij për të ndalur një tjetër sulm të Republikës ish- jugosllave dhe për ta mbajtur pushtetin kundrejt opozitës vendase. Nga viti 1996 deri në vdekjen e Tugjmanit në vitin 2000, vetëm 22 qendra ishin transferuar, krahasuar me 25 dhe 41 në vitet 2002 dhe 2003 respektivisht<sup>309</sup>.

Mungesa e dokumenteve strategjike dhe planeve afatgjata për forcat e armatosura kanë pasur një ndikim të ngjashëm në procesin e transferimit dhe transformimit të qendrave sikurse në procesin e zvogëlimit të personelit ushtarak. Mbi të gjitha, ky ndikim ka rezultuar në mungesën e qasjeve sistematike; shitjen *ad hoc* të pronës; dhe mungesën e qartë të analizës për nevojat e ardhshme të integritimeve brenda strukturave euroatlantike të sigurisë. Tash së voni, MM-ja dhe qeveria kanë ardhur në përfundim se çështja e pajisjeve ushtarake është e kushtueshme, por edhe që mund të nxjerr përfitime nëse iniciohet një qasje strukturore për transferim dhe transformim. Megjithatë, ka akoma të meta për hapat e tjerë konkret dhe të suksesshëm në këtë proces. Në Programin Kombëtar Vjetor për ciklin e tretë të Planit të Veprimit për Anëtarësim (MAP) prezantuar NATO-s, MM-ja thekson nevojën për modernizim të qendrave të rëndësishme ushtarake, sikurse edhe shitja e disa objekteve për fitimin e parave për FAK-un dhe SPECTRA-n gjithashtu<sup>310</sup>. Ai vendosë një afat për bërjen e një plani konkret për transferim dhe transformim me një departament udhëheqës në MM dhe të gjitha çështjet ligjore (të drejtat e pronës, etj.) të zgjidhen deri në fund të 2004. Gjithashtu, presioni i jashtëm është shtuar mbi MB-në mbi këtë çështje. Zyra e kryetarit të Kroacisë bëri një kërkesë zyrtare për MM-në për të përpiluar një listë sistematike të të gjitha objekteve ushtarake dhe statusin e tyre<sup>311</sup>. MM-ja ka caktuar një grup punues me detyrë që të zhvillojnë një plan për transformimin e objekteve tepricë. Megjithatë, ende mbetet problemi i mungesës së një Plani Zhvillimor Afatgjatë për FAK-un, i cili të tregonte se cilat objekte ushtarake do të mund të nevojiteshin për detyrat e ardhshme. Ndonëse drafti i LTDP tani është duke qarkulluar, zyrtarët e NATO-s kanë treguar se ata nuk presin një miratim zyrtarë deri në pranverën e vonët të vitit 2006<sup>312</sup>. Ndonëse Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes

nga marsi 2005 ishte parë si një hap i rëndësishëm në drejtim të LTDP ai përsëri është duke i shtyrë vendimet e qarta. Për shembull, RSM-ja përmend barrën financiare për mbajtur dhe ruajtur numrin e madh të qendrave ushtarake, por ai ia lë LTDP-së për të “definuar qëllimet dhe dinamikat për zhvillimin e ndërtesave dhe infrastrukturës”<sup>313</sup>. Pa këto qëllime, duket të jetë e tepërt të transferohen objektet ushtarake, të cilat mund të nevojiten për interoperabiliteti me forcat e NATO-s.

Prapëseprapë, edhe pa caqe të qarta për strukturën e ardhshme të FAK-ut, MM-ja ka transferuar 124 qendra ushtarake ndërmjet viteve 2002-2004<sup>314</sup>. Nga 336 qendra që akoma mbahen nga MM-ja, vetëm 203 do të mbahen nga forcat e armatosura. 71 qendra janë të gatshme për transferim ndërsa 62 akoma duhet të lirohen nga forcat e armatosura<sup>315</sup>. Përveç çështjes së lirimit të objekteve potencialisht të rëndësishme për të ardhmen, kjo politikë ka kuptim nga perspektiva e MM-së kroate. Sa më shpejt që MM-ja transferon këto qendra, aq më shumë ata mund të rrisin buxhetin dhe personelin dhe t’i përdorin ato për qëllime tjera<sup>316</sup>. Megjithatë, interesi i përgjithshëm i qeverisë dhe shtetit kroat në një proces të transformimit të strukturuar dhe që sjell përfitime duhet të peshoj më rëndë sesa interesat afatshkurtra të ushtrisë në kërkimin e transfereve të shpejta dhe fitimprurëse.

Pavarësisht numrit, është e qartë se Kroacia ka pasur eksperiencë të konsiderueshme në mbylljen e bazave, transformimit apo ri-zhvillimit me 204<sup>317</sup> objekte të “transferuara”. Nëse një vlerësim i përgjithshëm i këtyre rasteve nuk ka ndodhur akoma, MM-ja kroate duhet ti konsideroj seriozisht një vlerësim të tillë para se të merr hapa me qëllim të vendosjes së një organizimi të ri institucional apo procedura të tjera. Një përmbledhje e praktikave më të mira (llojet e ndryshme të ripërdorimit të suksesshëm, struktura të efektshme për procesin e transformimit në nivel lokal, etj.) do të ishte një pasuri.

#### *Organizimi institucional për transfer dhe shitje*

Në vitin 2001, qeveria kroate themeloi një agjenci shtetërore për të udhëhequr shitjen apo transferimin e pasurive shtetërore: Fondin e Privatizimit (FP). Një kufizim për transferimin dhe transformimin e pasurive ushtarake është se agjencia shtetërore është përgjegjëse për sistemimin e ‘përkatësisë’ së pasurisë për të gjitha departamentet qeveritare, kështu që procesi mund të jetë mjaft i ngadalshëm. MM-ja tani është duke e sponsorizuar një projektligj në kuvend kështu që ajo

të mund t'i transferoj vetë objektet. Duket të mos ketë kundërshtim domethënës për këtë<sup>318</sup>, ndonëse MM-ja ishte e sinqertë në pohimin se kishte pak përkrahje jashtë MM-së. Propozimi ka përparësinë potenciale për përshpejtimin e transferimit të objekteve ushtarake, por edhe mangësinë potenciale për dhënien e një fokusi shumë të ngushtë për rezultatet e transformimit që duken të dobishme vetëm për MM-në. Duhet të bëhet një shembull, që një transfer i strukturuar dhe transformim i pasurive ushtarake duhet të jetë i dobishëm për vendin dhe ekonominë e vendit si tërësi, dhe jo vetëm për MM-në.

Kur është në pyetje transferi apo shitja e parë pronës shtetërore, ajo menaxhohet nga tri organe të ndryshme, varësisht nga shuma e llogaritur e instalimeve:

- Zyra qendrore e administratës shtetërore për menaxhimin e pronës së shtetit (deri në 100.000 kuna)
- Komisioni i aseteve i Qeverisë së Kroacisë (nga 100.000 deri 10 milion kuna)
- Qeveria e Kroacisë (mbi 10 milion kuna)

Procedurat punuese të të tri organeve janë të paqarta, siç është edhe lidhja e tyre me Fondin e Privatizimit. Gjatë dy viteve të fundit, shumica e transfereve ishin trajtuar nga Komisioni i aseteve, disa nga qeveria kroate dhe asnjë nga Zyra qendrore e administratës shtetërore<sup>319</sup>. Këto organe ose i transferojnë bazat direkt tek komunat lokale, qytezat apo qytetet, apo tek Fondi i Privatizimit. Nga 124 qendra të transferuara në mes të vitit 2002 dhe 2004, 54 u ishin dorëzuar Fondit të Privatizimit falas në vitin 2002 dhe 2003. Megjithatë, duket se tash së voni ka pasur një ndryshim të politikës pasi që asnjë qendër nuk iu është transferuar FP-së në vitin 2004, dhe vetëm një bazë i ishte dhënë falas ndonëse kjo politikë ishte praktikuar për dy vitet e fundit<sup>320</sup>.

Ndoshta modeli i një agjencioni të pavarur që trajton të gjitha çështjet e transformimit do të mund të ishte një opsion për Kroacinë. Në një takim me Grupin punues të NATO-s në Zagreb, përfaqësuesit e Fondit të Privatizimit përmenden Nën-grupin e agjencive për transformimin e fondeve, por nuk sqaruan organizimin e tij, pjesët përbërëse dhe procedurat vendimmarrëse<sup>321</sup>. Duket se akoma ka një mungesë të efikasitetit dhe të strukturave transparente me detyra dhe përgjegjësi të caktuara qartë, jo vetëm në transferimin e pasurive ushtarake, por gjithashtu edhe në transferimin e pasurisë së shtetit në përgjithësi.

### *Procedurat për transferim*

Ngjashëm me dykuptimësinë në organizimin institucional për transferin dhe transformimin e objekteve ushtarake, procedurat janë akoma në fazën përpunuese në Strategjinë e Mbrojtjes dhe në RSM. Objektet ushtarake megjithatë kanë qenë të organizuara në katër grupe:

- ato që kanë perspektivë ushtarake;
- ato që kanë perspektivë të përkohshme ushtarake;
- ato pa perspektivë ushtarake;;
- të tjerat plotësuese të mbahen për forcat e armatosura<sup>322</sup>.

Bazuar në këtë klasifikim të përgjithshëm, MM-ja ka vendosur të mbaj 203 nga 336 objektet e tanishme ushtarak<sup>323</sup>. Përsëri, duhet të theksohet se zgjedhja e bazave për mbyllje pa të gjitha dokumentet strategjike në vend mund të shpie në probleme në proceset e ardhshme ri-strukturuese dhe modernizuese.

Hapat tjerë për zgjedhjen e një qendre që të nxirret në shitje janë përmbledhje e informatave të numëruara më poshtë, e cila pastaj vendoset së bashku nga MM-ja në një shqyrtim për Zyra qendrore e administratës shtetërore për menaxhimin e pronës së shtetit. Hapat e ardhshëm për zgjedhjen e vendit për deponim janë përmbledhje e informatave të shënuara më poshtë, e të cilat më pas bëhen në një vend nga MM në një hulumtim që bëhet për Zyrën qendrore të administratës shtetërore për menaxhimin e pronës së shtetit:

- Kopja nga regjistri i tokës
- Certifikata mbi statusin dhe qëllimin e ngastrës sipas planit të qytetit
- Informacioni lidhur mbi statusin e ngastrës në datën e miratimit të ligjit mbi tokën bujqësore
- Informacioni mbi kërkesën për kompensim të bërë sipas ligjit për kompensimin e pronës së konfiskuar gjatë sistemit komunist jugosllav
- Deklarata e pylltarisë kroate për statusin e ngastrës
- Vlerësimi i vlerës së tregut nga Agjencia e Administratës Tatimore të Ministrisë së Financave
- Fotografimi i pronës
- Ekzaminimi i terrenit
- Opinioni i autoritetit të pronës publike<sup>324</sup>

Në mes të vitit 2001-2005, 262 hulumtimet kishin kaluar nga MM-ja tek Zyra Qendrore e Administratës Shtetërore për Menaxhimin e Pronës së shtetit, duke qar në 100 pasuri të

transferuara<sup>325</sup>. Përsëri, ky numër dhe procedura në përgjithësi ngre një numër pyetjesh. Nga 124 qendrat që aktualisht janë transferuar, asnjë nuk ishin dhënë te Zyra Qendrore e Administratës Shtetërore për Menaxhimin e Pronës së shtetit. Veç kësaj, vetëm pasuritë me vlerë të vogël duhej ti jepeshin atij autoriteti, por barakat dhe bazat duket të kenë një vlerë më të lartë se sa 100.000 kuna. Në mënyrë mjaft të qartë, kjo tregon mospërputhjen dhe natyrën jo-transparente të strukturave dhe procedurave të tanishme, sikurse edhe mungesën e njohurive institucionale dhe të centralizuara në MM dhe në agjencitë tjera shtetërore bashkëpunuese mbi proceset e kaluara dhe të tanishme në atë fushë.

Me e rëndësishme, mbetet pyetja se kush aktualisht i udhëheqë këto hulumtime. Nëse MM-ja është përgjegjëse për të tërë kontributin e atij procesi, aty do të mund të kishte një konflikt interesi. Qëllimi kryesor i MM-së është shitja e shpejtë dhe fitimprurëse e objekteve ushtarake. Ndonëse Agjencia për Administrimin e Taksave e Ministrisë së Financave është duke bërë vlerësimin e tregut, ka hapësirë për MM-në për tu përpjekur të ndikoj mbi procesin duke ofruar disa të dhëna elementare. Vlerësimet e tregut nga Agjencia e Administrimit të Taksave e Ministrisë së Financave nganjëherë janë më domethënëse sesa ato të bëra nga qytetet lokale të interesuara në blerjen apo marrjen me qira të bazave (shiko Kutinë 2 në Krizevci). Përveç kësaj, ka pasur ankesa nga komunat lokale se vlerësimi i vlerës së tregut merr kohë të gjatë<sup>326</sup>

### *Të drejtat e pronës dhe problemet ekologjike*

Një tjetër çështje e rëndësishme për procesin e transformimit është pronësia e qendrave. Kjo çështje jo vetëm që merret me pyetjen nëse këto baza dhe përfitimi i mundshëm i takojnë shtetit apo jo, por gjithashtu edhe sa i përket të drejtave të pronë të kohës para-socialiste apo nga pasardhësi APJ-së, Forcat e Armatosura Serbo-Malazeze. Në disa raste, mosmarrëveshjet mbi pronësinë e një qendre të veçantë mbetën një pengesë. Kroacia ka marrë një hua nga Banka Botërore për të krijuar një regjistër të tokës, pasi që regjistrat e tanishëm nuk janë të plotë.

Zyrtarët e intervistuar për këtë studim për disa herë e minimizuan çështjen e ndotjes së qendrave ushtarake<sup>327</sup>. Megjithatë, duke marrë parasysh përvojat me bazat tjera në Evropën Lindore, dikush mund të supozoj se probleme të ngjashme ekzistojnë edhe në Kroaci. Në veçanti, municioni i vjetër dhe materiet tjera eksplozive nga bazat e forcave mbrojtëse territoriale

paraqesin rrezikim të sigurisë dhe të popullatës lokale, siç paraqesin edhe në Bosnjë e Hercegovinë<sup>328</sup>. Nga takimet me zyrtarët e MM-së, nuk ishte e qartë nëse ndonjë specialist i ambientit ishte i angazhuar në përgatitjen e hulumtimit mbi qendrat ushtarake, apo nëse njësi dhe programe të specializuara ekzistojnë në FAK për të pastruar ndotjen e bazave. Një përgjigje zyrtare nga ambasadori kroat në NATO në tetor të vitit 2005 në fund tregoi se MM-ja e pranon problemin. Deklarata thekson se "Transformimi më i kushtueshëm do të jetë për ish-deponitë e karburanteve, pasi që ato nuk kanë pasur një mirëmbajtje të duhur, e as që janë përdorur. Këto do të sjellin probleme ambientale. Ndonëse, Republika e Kroacisë nuk ka pronë të kontaminuar me materiale radioaktive, ka një përqindje të caktuar të pronës të rrethuar nga fusha të minuara<sup>329</sup>.

### *Objektivat e MM-së*

Dy objektivat kryesore të MM-së për transferimin e bazave dhe pasurive janë:

- Të lirohen burimet për modernizimin e pronës së premtuar ushtarake apo konstruktimi i të reja
- Të lirohen burimet për realizimin e programit SPECTRA dhe riorganizimin i MM-së<sup>330</sup>

Përmes përballimit të paraparë të "programit të transformimit, MM-ja dëshiron të krijoj fonde për modernizimin e FAK-ut dhe të tërë sistemit të mbrojtjes, gjithashtu të përkrah personelin e tepërt. Ky plan duket të jetë mjaft i diskutueshëm. Buxheti ushtarak nuk duhet të varet në fitimin e pritur nga shitja e bazave ushtarake, pasi që këto janë mjaft të paparashikueshme. Në fakt, transformimi shpesh përfshinë më shumë shpenzime se sa përfitime në vitet fillestare të procesit.

Duke vështruar në vendimet e Komisionit të aseteve nga viti 2002 deri 2004, pritjet për gjenerimin e të ardhurave në MM dhe në agjencitë tjera respektive janë ngritur në vitet e fundit<sup>331</sup>. Deri sa në vitin 2002 dhe pjesën më të madhe të vitit 2003 shumica e bazave ishin lëshuar pa pagesë, në fund të vitit 2003 dhe veçanërisht në vitin 2004, numri i bazave të dhuruara falas ishte zvogëluar në 1 në 20. Pse ka ndryshuar politika? A dëshiron MM-ja t'i shtoj përfitimet? A tregon ky zhvillim një kërkesë në rritje dhe interes nga qytetet lokale në posedimin e qendrave ushtarake? Duke e gjykuar nga përvoja e transformimit në vendet tjera post-socialiste, MM-ja duhet ti zvogëloj të priturat: pjesa e fitimit rrallëherë është konkretizuar në këto vende dhe fitimi si rezultat i paqes rrallëherë është materializuar në këto vende. Megjithatë, transformimi

dhe ri-zhvillimi i bazave ofron mundësinë për përfitime të përgjithshme për shoqërinë dhe ekonominë lokale e cila nuk mund të matet nga përfitimet fiskale.

Shumica e objektivave të MM-së janë afatshkurtra, duke kërkuar zgjidhjen e shpejtë dhe shitjen me përfitime të larta. Më mirë se të ketë përgjegjës MM-në për procesin e transformimit, shteti kroat duhet të përpiket që të formuloj objektiva afatgjata dhe partneritet për procesin e transformimit ku do të mund të përfitonte shoqëria si e tërë. Pasi që shumë baza ushtarake gjithashtu gjenden në pjesët e pazhvilluara dhe të shkatërruara nga lufta, shteti kroat duhet të merr parasysh më shumë faktorë se sa vetëm ata ushtarak. Mbyllja e bazave mund të ketë disa pasoja në zona të tilla<sup>332</sup>. Ndoshta një partneritet i ngjashëm si ai me IOM-in në ri-integrim do të ishte fitimprurës. Lidhja e procesit të transformimit të bazave me asistencën e SPECTRA-s mund të jetë gjithashtu e dobishme. Udhëheqësit e SPECTRA-s tani janë duke kërkuar fonde për një aktivitet të quajtur "Transformimi i Bazave Ushtarake për Qëllime Bujqësore"<sup>333</sup> i cili do të përfshinte ri-zhvillimin ekologjik, furnizimin me bimë dhe fara, gjë që do të ndihmonte disa ish-ushtarak që të vetëpunësoheshin në bujqësi.

#### *Rekomandimet*

- Për të arritur "vlerën më të mirë për para", ripërdorimi i mundshëm i pajisjeve ushtarake nevojitet të jetë subjekt vlerësimeve investuese. Kjo do të përfshijë krahasimin sistematik të shpenzimeve dhe përfitimeve të opsioneve të ndryshme ripërdorimit për secilën bazë të dhënë. "Vlerësues" të pavarur duhet të bëjnë përcaktimin e vlerës së instalimeve të shitura. Problemet e mirëbesimit prandaj do të shmangeshin dhe diskutimet e çmimit do të bëheshin më të lehta. Natyrisht, kjo është kusht që në Kroaci të ketë një organ të pavarur vlerësuesish.
- Një mënyrë për të shpejtuar procesin e transformimit mund të jetë krijimi i një ekipi këshillues të pasurive të patundshme me njohuri të mira të tregut kroat të pasurive të patundshme, ekonomisë së pasurive të patundshme dhe financimit. Ky ekip ose mund të përbëj një pjesë të MM-së ose të jetë më i pavarur në mënyrë që të mos lejoj veten të ndikohet nga ata. Ky ekip do të mund të shërbente për dy qëllime kryesore:
- Të kontribuonte në dhënien e një pamjeje reale për kushtet e një shitjeje, për MM-në dhe autoritetet lokale.
- Të iu jap autoriteteve të prekura ndihmë profesionale kështu që procesi i transformimit fillon më shpejtë

- Një përmbledhje e praktikave më të mira (për shembull, mbi llojet e ndryshme të ripërdorimit të suksesshëm, strukturë efikase për procesin e transformimit në nivelin lokal, etj.) do të ishte një mjet i dobishëm. Informacione më të hollësishme mbi qendrat dhe pajisjet të cilat kanë qenë të transferuara gjithashtu janë të nevojshme.
- Komunitetet në Kroaci të cilat kanë pretenduar për pronë nevojitet të organizojnë një rrjet për të shkëmbyer përvojën dhe për të vepruar si një grup homogjen për të shtyrë përpara politikën dhe legjislacionin adekuat në këtë fushë.

### ***Përfundimet***

Përderisa reforma në mbrojtje në përgjithësi ka qenë shumë e ndikuar nga presioni i jashtëm dhe nxitja për perspektivën në BE apo anëtarësimin në NATO, masat konkrete të ndërmarra në të dy fushat për zvogëlimin dhe risistemimi dhe transformimin e bazave kanë qenë gjithashtu të shtyra nga faktorët financiarë. Duke e zvogëluar numrin e personelit dhe bazave ushtarake, MM-ja shpreson të zhbloktoj më shumë të holla për përfitime sociale për personelin tepriçë, sikurse edhe për modernizimin e FAK-ut siç kërkohet nga NATO përmes programeve të tyre të pranimit.

Megjithatë, politikat vendore për një kohë mjaft të gjatë kanë qenë pengesë kryesore për shumë masa të reformës në mbrojtje, veçanërisht gjatë kohës së regjimit të Tugjmanit kur mungonte kontrolli demokratik mbi ushtrinë. Marrëdhëniet civile-ushtarake në një masë akoma janë të mangëta në Kroaci, por vendi dhe ushtria e tij megjithatë janë denacionalizuar. Megjithatë, duket që akterët parlamentar apo ekspertët civil kanë pasur ndikim minimal mbi çështjet e tanishme të transformimit dhe procesit përkatëse të planifikimit.

Dy fushat kryesore të aktiviteteve të transformimit—programi SPECTRA dhe programi i organizuar rishtas i transformimit—janë të punuara mirë, në rastin e SPECTRA-s, janë zbatuar mirë duke konsideruar fondet e kufizuara dhe krahasuar me projektet e ngjashme në vendet fqinje. Megjithatë, procesi i transformimit dhe ri-zhvillimit të bazave ka nevojë për më shumë transparencë dhe analizë e pavarur. Një shqyrtim i qartë i të gjitha transfereve të bazave është i nevojshëm me qëllim të përmirësimit të rezultateve të programit dhe ndoshta edhe të gjeneroj të ardhura. Megjithatë, MM-ja duhet të ulë të priturat e saj në kërkimin e fondeve të jashtme për të



dy projektet, sikurse edhe në përfitimet potenciale që ai të mund të marr përmes shitjes së pronës ushtarake.

Megjithatë, reformat kroate në sektorin e mbrojtjes kanë një përparësi domethënëse: ato janë të futura në një ekonomi në rritje dhe një demokraci të konsoliduar. Që nga tetori i vitit 2005, perspektiva evropiane në Kroaci dhe aftësia e saj për të arritur standardet e mbrojtjes euroatlantike është më realiste dhe më pozitive sesa për cilindo vend tjetër të Ballkanit Perëndimor. Fondet evropiane për pastrimin ambiental të qendrave ushtarake, përkrahja për masat për punësimin e ish-ushtarakëve dhe shtimi i investimeve direkt nga jashtë në zonat turistike janë brenda horizontit dhe do të nënkuptojnë një ndryshim të madh për transformimin e ardhshëm të bazave kroate dhe programeve ri-integruese.

## 5. Përfundimet e përgjithshme

Tri vendet e analizuar në këtë studim dallojnë shumë sa i përket statusit të reformës, modernizimit dhe profesionalizimit të forcave të tyre të armatosura. Kjo po ashtu është e vërtetë për programet e iniciuara apo të zbatuara në transformimin e mbrojtjes, ku të tri vendet janë duke hasur probleme të ndryshme në faza të ndryshme të ciklit të projektit. Prandaj, më shumë ishte bërë një analizë e nivelit të reformës dhe planifikimit, identifikim i mësimave të mësuara dhe çështjet që duhet të konsiderohen në programet e ardhshme të transformimit, sesa një studim formal krahasues. Gjerësia e studimit ishte kufizuar nga një mungesë e përgjithshme e analizave sistematike në sektorët e mbrojtjes të vendeve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve, që është e përbashkët pothuajse për të gjitha programet e ekzaminuara. Prandaj, studimi ngre edhe këto pyetje: si mundet një institut hulumtues, por po ashtu edhe agjencitë zbatuese të masin suksesin e reformës së mbrojtjes nëse të dhënat nuk janë mjaft të sakta? Çka nëse indikatorët e qartë mungojnë, apo kur agjenda të ndryshme të akterëve të jashtëm dhe të brendshëm në një farë mënyre janë duke i mjegulluar informacionet?

Sidoqoftë, ekzistojnë disa ngjashmëri në mes tri rasteve që lejojnë për identifikim të disa të arriturave, mangësive dhe përcaktuesve për reformën e mbrojtjes në vendet post-socialiste në Evropën Juglindore<sup>334</sup>. Këto do të shqyrtohen një nga një.

### *Të arriturat*

Suksesi parësor i të gjitha reformave të mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor është zvogëlimi i konsiderueshëm i strukturave ushtarake, që garanton stabilizim të ardhshëm të këtij rajoni të prekur nga lufta. Në shumicën e rasteve, projektet e zvogëlimit në numër kanë dërguar në ndryshim jo vetëm të personelit ushtarak, por po ashtu edhe në edukim dhe trajnim për detyrat e reja. Edukim më i mirë ushtarak sikurse edhe programet për ri-integrim dhe trajnim profesional jo vetëm që dërgojnë në personel më të kualifikuar, por po ashtu edhe në ndryshimin mentalitetit socialist dhe paternalist. Përveç kësaj, forcat e reja të armatosura në të tri vendet kanë humbur iluzionet dhe pritjet jorealiste në lidhje me pajisjet, financat në dispozicion dhe perceptimet e kërcënimeve.

Një tjetër rezultat pozitiv është mungesa e përçarjeve apo trazirave shoqërore nga personeli ushtarak i shkarkuar apo nga veteranët e luftës në demokracitë e konsoliduara ngadalë të Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë. Sidoqoftë, veçanërisht në rastin e Kroacisë ku lufta ka traumatizuar një pjesë të madhe të popullatës, është me rëndësi që të ekzaminohen problemet psikologjike të ri-integrimit dhe ndikimit të saj në shoqëri, siç është krimi i organizuar, dhuna e brendshme apo shkalla e ngritur e vetëvrasjeve në mesin e personelit ish-ushtarak.

Përveç procesit të reformës, përvoja me trajnime dhe këshilla perëndimore ka ndihmuar denacionalizimin dhe ndërkombëtarizimin e forcave të armatosura në të tri vendet. Në rastin e Kroacisë, kapja dhe gjykimi i Gotovinës do të mund të zbulonte përfundimisht rolin e disa pjesëve të FAK-ut në luftën kundër serbëve të Krajnës dhe kështu të përkrah transformimin e saj.

Sa i përket programeve që aktualisht janë zbatuar në transformimin e mbrojtjes, vetëm SPECTRA mund të vlerësohet si e suksesshme, përderisa të gjitha programet tjera ose kanë mangësi ose vetëm sa kanë hyrë në fazën zbatuese me disa rezultate modeste (LEPEZA). Është e qartë se vetëm SPECTRA ka qenë në gjendje që të jap përkrahje me mjete financiare të kufizuara dhe me shkallë të lartë të punësimit për ish-ushtarakët.

### *Mangësitë*

Fillimi me vonesë i reformës së mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor dhe shtyrja e dokumenteve strategjik në shumicën e vendeve përbën faktorët kryesorë për problemet aktuale më të cilat përballen Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia. Akoma ka mungesa strukturore në sektorin e sigurisë, duke përfshirë mungesën e kontrollit civil të forcave të armatosura, shtyrjen për kompetenca ndërmjet strukturave të qeverisë për çështjet e mbrojtjes, si dhe mungesa e kontributit apo analizës së pavarur nga OJQ-të apo institutet kërkimore. Këto mangësi shpesh kanë qar në ndryshime të shpeshta, vonime dhe hartim mesatar të dokumenteve strategjike dhe të mbrojtjes, që kanë pasur një ndikim planifikimin afatgjatë të forcave të mbrojtjes, bazave dhe pajisjeve të tyre.

Pa strategji dhe plane afatgjate, zvogëlimi në numër, ri-sistemimi dhe transferi i bazave ushtarake do të mund të qonte në forca joefikase dhe të pajisura dobët. Mungesa e planeve dhe mbetja e problemeve strukturore në sektorin e mbrojtjes kanë pasur një ndikim në mënyrën se si ri-

sistemimi dhe ri-integrimi, sikurse edhe transformimi janë trajtuar deri tani në të tri vendet. Në të tri rastet, analizat e qarta dhe rishikimet e aktiviteteve të kaluara të reformimit si dhe vlerësimet e situatave aktuale të ish-ushtarakëve mungojnë. Rishikime të tilla kanë udhëhequr masat aktuale dhe ato të planifikuara rishtazi në transformimin e bazave dhe ri-sistemimin e personelit ushtarak. Kultura raportuese me të meta që është e pranishme në të tre sektorët e mbrojtjes pengon analizën dhe të dhënat e sakta aq të nevojshme nga do të përfitonin të gjitha projektet.

Përveç kësaj, të tria vendet për një kohë të gjatë kanë pasur pritje të gabuara në aspekte të financave nga jashtë ose përfitimet përmes shitjes apo transfereve e bazave ushtarake. Mungesa e financimit është një problem kryesor, madje edhe në Kroaci ku ekonomia është duke e rimarrë vetën në një shkallë më të madhe sesa dy vendet tjera.

### *Përcaktuesit*

Anëtarësimi i mundshëm në NATO dhe BE po ashtu duket të jetë forca shtytëse prapa masave reformuese në të tri vendet e analizuara në këtë studim. Sidoqoftë, presioni financiar në buxhetet e tyre të mbrojtjes po ashtu është duke luajtur një rol madhor, siç është edhe njohja e trashëgimisë ushtarake jofunksionale. Në mënyrë ironike presioni financiar është duke u ngritur për shkak të kërkesave për modernizim dhe ristrukturim të forcave të armatosura dhe pajisjeve të tyre përmes obligimeve të mbarështura në skemën e anëtarësimit në NATO. Një rast unik është Maqedonia, sepse ristrukturimi i forcave të armatosura ka qenë po ashtu i shtyrë nga agjenda politike në mënyrë që të arrihet baraspeshë etnike në ushtri. Përvoja me kulturën dhe trajnimet ushtarake perëndimore po ashtu është duke ndikuar shkallën e reformave, sikurse edhe ndërrimin e gjeneratave që është duke u bërë në të tri forcat e armatosura. Në të tri vendet, KPU-të janë duke luajtur një rol në shtyrjen përpara të reformave, edhe pse ndikimi i tyre nuk është i matshëm dhe është një pyetje e hapur nga ekspertët lokal dhe ndërkombëtar.

Shumë nga faktorët kryesorë që kanë penguar reformat e shpejta vinë nga zhdukja e ngadaltë e mentalitetit socialist dhe nacionalizimit të pas luftës që ka qenë vendimtar në krijimin e kombit në Kroaci dhe Maqedoni, por që tani përbën një barrë për këto vende. Për më tepër, trashëgimia institucionale ka pasur një ndikim negativ në gjerësinë dhe shpejtësinë e reformave, veçanërisht në tensionet në mes kryetarit dhe kryeministrit mbi kompetencat e mbrojtjes, por po ashtu edhe papërvoja e parlamentarëve me mbikëqyrjen dhe kontrollin ushtarak. Për dallim nga shtetet

perëndimore, parlamentarët në të tri vendet po ashtu nuk mund të mbështeten në analiza të pavarura dhe këshilla pasi që ka mungesë të përgjithshme të kapaciteteve civile në sektorin e mbrojtjes, siç janë institutet kërkimore dhe akademitë.

Rezultatet e ndryshme të proceseve reformuese në Kroaci, Shqipëri dhe Maqedoni janë kryesisht të ndikuara nga niveli i realizimit në aspekt të mundësisë së anëtarësimeve në NATO dhe BE. Në rastin e Maqedonisë, shumëllojshmëria etnike ka komplikuar procesin, veçanërisht me ndryshimet e domosdoshme që janë duke ndodhur tani. Për më tepër, gjerësia e problemeve në demobilizim dhe ri-integrim, sikurse edhe për transformimin, ndryshojnë dukshëm. Kroacia haptazi përfiton nga rritja e madhe e saj ekonomike dhe konsolidimi i strukturave të saj demokratike. Përveç kësaj, kapacitetet e përgjithshme të regjimit politik për të kontrolluar dhe qeverisur efektisht sektorin e mbrojtjes është më mirë i zhvilluar në Kroaci sesa në dy vendet tjera, sikurse është edhe shkalla e veprimit kundër korrupsionit. Përfshirja e organizatave ndërkombëtare siç është IOM në Kroaci po ashtu ka rritur efikasitetin e projekteve si SPECTRA. Kroacia dhe Maqedonia po ashtu kanë përfituar dhe do të vazhdojnë të bëjnë kështu nga mundësitë e rritura për anëtarësim në BE.

#### *Rekomandimet për programet e transformimit*

- Nevojitet më shumë transparencë në të gjitha aktivitetet e transformimit të planifikuara dhe të atyre që aktualisht janë në proces, por veçanërisht brenda procesit të transferim dhe shitjes së bazave ushtarake, pajisjeve dhe pasurive. Për të arritur një transparencë, komisionet parlamentare duhet të jenë të trajnuara dhe të fuqizuara më mirë. Përveç kësaj, ekspertizë me e pavarur në këshillim, zbatim dhe vlerësim është vendimtare.
- Ndoshta modeli i një agjencie të pavarur për transformim do të garantonte transparencë dhe procedura burokratike me efikase. Një vlerësim i pavarur i vlerës së tregut do të ishte veçanërisht i rëndësishëm për këtë qëllim. Organizimi institucional, që ishte krijuar në të tri vendet, jo vetëm që ishte i paqartë, por po ashtu dukej të ishte jo-praktik për zbatim.
- Planifikimi duhet të jetë i arsyeshëm dhe me orientim afatgjatë; dhe po ashtu paketat përfituese dhe të drejtat duhet të jenë të arsyeshme dhe të udhëhiqen nga kritere transparente.
- Shembulli i mirë i shmangies së dyfishimit nga integrimi i IOM-it në organizimin e SPECTRA-s mund të përdoret po ashtu edhe për aktivitetet tjera të transformimit të

mbrojtjes. Për më tepër, OJQ-të duhet të përdoren—sikurse dhe agjencitë kombëtare ekzistuese—për të bërë procesin më të lirë aspektin financiar, dhe, në rastin e ri-trajnitimit dhe risistemimit, të kenë partnerë civil të përfshirë në ri-integrimin e ish-ushtarakëve në shoqëri dhe ekonomi.

- Pritjet e larta për përfitime nga transferimet dhe shitjet duhet të reduktohen. Ato nuk kanë gjasa të konkretizohen. Çështjet e ambientit në veçanti mund të dështojnë në shitjet e planifikuara. Një mundësi tjetër për të tërhequr fonde të reja në kohëra të zvogëlimit të interesit të donatorëve për të përkrahur reformën ushtarake është të kërkohet përkrahje financiare për pastrimin e bazave të ndotura. Edhe pse kjo nuk ka ndikim të drejtpërdrejt në fitimet për MM-në, ajo do të kishte ndikim pozitiv në komunitetet fqinje.
- Shkëmbimi i përvojave në rajon në reformën e mbrojtjes dhe projektet reformuese konkrete duhet të rritet. Strukturat si Njësia e re e mbrojtjes në RACVIAC mund të ofrojnë përkrahje të rëndësishme për këtë qëllim dhe kontribuojnë për dokumentim dhe mekanizma të vlerësimit për programet në rajon.
- Programet e ri-integrimit duhet të marrin parasysh situatat e ndryshme, mjediset dhe mundësitë në secilin vend, dhe mos të miratojnë qasje “një madhësi për të gjithë”
- Në rastin e ri-trajnitimit dhe ri-integrimit, duhet të ekzistoj një mesazh i qartë se asnjë përfitim shoqëror nuk rezulton automatikisht nga karriera ushtarake, por përkundrazi çdo ushtar ka një identik shoqëror dhe është përgjegjës ndaj një shoqërie civile. Në aspektin afatgjatë, kjo do të ndihmonte konceptin që personeli ushtarak është po ashtu pjesë e shoqërisë dhe duhet të mbaj kapacitete dhe vlera civile.

Lidhjet në Internet:

Faqja jo zyrtare në internet e ushtrisë shqiptare

<http://www.stormloader.com/albanianarmy/army.htm>

Albanian Daily News

<http://www.albaniannews.com/>

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

<http://www.sobranie.mk/en/default.asp>

Brauchli, David. Crisis? What Crisis? A Photographer's Diary.

<http://www.digitaljournalist.org/issue9810/crisis1.htm>.

Chossudovsky, Michel. Washington Behind Terrorist Attacks in Macedonia. July 23, 2001

<http://www.antiwar.com/rep/chuss6.html>

Instituti për Raportimin e Luftës dhe Paqes

[http://www.iwpr.net/balkans\\_index1.html](http://www.iwpr.net/balkans_index1.html)

Ligji për pension dhe sigurim të paaftësisë në punë, 1993

<http://www.mlrc.org.mk/law/l018.htm>

MIA, Agjencia Informative e Maqedonisë.

<http://www.mia.com.mk/webang.asp>

Ushtria e Maqedonisë

[http://www.fact-index.com/m/mi/military\\_of\\_albania.html](http://www.fact-index.com/m/mi/military_of_albania.html)

NATO Handbook.

<http://www.nato.int/docu/handbook/2001/>

NATO Handbook.

<http://www.nato.int/docu/handbook/2001/>

Radio Evropa e Lirë, Evropa Juglindore

<http://www.rferl.org/newsline/4-see.asp>

Reality Macedonia

<http://www.realitymacedonia.org.mk/web/firstpage.asp>

Republika e Maqedonisë, Ministria e Mbrojtjes

<http://www.mod.gov.al/eng/default.asp>

Republika e Maqedonisë, Ministria e Mbrojtjes

<http://www.morm.gov.mk/index1en.htm>

Robertson, G. NATO-Albania Relations, Strong and Growing Stronger.

[http://www.usembassy.it/file2001\\_05/alia/a1051815.htm](http://www.usembassy.it/file2001_05/alia/a1051815.htm)

South East European Times

[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/homepage/default](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/homepage/default)

Karta e Adriatikut

<http://www.adriaticcharter.gov.mk/adriatictreaty.htm>

The Center for South East Studies

[http://www.csees.net/?page=news&news\\_id=39586&country\\_id=1](http://www.csees.net/?page=news&news_id=39586&country_id=1).

The Political and Economic Outlook for Albania.

<http://www.cespi.it/STOCCHIERO/Ascod-Albania/analytica3.PDF>

Transitions online

<http://www.tol.cz/look/TOL/home.tpl?IdLanguage=1&IdPublication=4&NrIssue=116>

Troubled September in Albania, SAT, 19 SEP 1998

<http://www.aimpress.ch/dyn/trae/archive/data/199809/80919-009-trae-tir.htm>

ZNet Balkan Watch

<http://www.zmag.org/balkanwatch/balkanwatch.htm>

## **7. Lista e personave të intervistuar**

Agolli, Ilirjan, Zëri i Amerikës, gazetar, Tiranë, Shqipëri, 2 mars 2005

Aleksoski, Mile, Shtabi i Përgjithshëm (J5), MM, Lt. Kol., Shkup, Maqedoni, 23 mars 2005

Atanasovski, Emil, NDI, zyrtar projekti, Shkup, Maqedoni, 21 mars 2005

Babiq, Tomislav, Menaxher Programi, IOM, Osjek, Kroaci, 14 prill 2005

Basiq, Ivan, Menaxher Programi, SPECTRA, Zagreb, Kroaci, 10 mars 2005, 12 prill, 12 dhjetor 2005.

Bega, Ermir, Forcat Speciale Shqiptare, Tiranë, Shqipëri, 28 shkurt, 3 mars 2005



Begalla, Engjell, Ministria e Punëve të Jashtme, Chief of Ceremonial, Tiranë, Shqipëri, 4 mars 2005

Bilandzija, Zeljka, Gazetarë, Agence France Press, Zagreb, Kroaci, 13 prill 2005.
